



Programi i Partisë Demokratike të Shqipërisë
Familja në zemër të së Ardhmes së Shqipërisë – Një Kontratë me Shqiptarët

Përmbajtja

Hyrje: Shqipëria në Udhëkryq – Rindërtimi përmes Vlerave Konservatore	2
Një Vizion Optimist, Shpresëdhënës dhe Realist për Shqipërinë e së Ardhmes	3
1. Mirëqeverisja.....	4
2. Modeli ekonomik – Mirëqenia e Familjeve, Forcimi i Individit dhe Rindërtimi Ekonomik.....	6
3. Sovraniteti ekonomik dhe Industrializimi: Bujqësia, Turizmi dhe Energjia si bazat tona të ekonomisë.....	19
4. Siguria, Antikorrupsioni dhe Lufta Kundër Krimit të Organizuar	23
5. Arsimi	27
6. Shëndetësia.....	37
7. Dekomunistizimi	46
8. Prona	54
9. Zhvillimi Territorial dhe Decentralizimi.....	61
10. Transporti	65
11. Familja	66
12. Rinia.....	68
13. Mjedisi.....	71
14. Marrëdhëniet me Jashtë.....	72
Një Horizont i Ri – Të Ndërtojmë Kontratën me Shqiptarët	80



Hyrje: Shqipëria në Udhëkryq – Rindërtimi përmes Vlerave Konservatore

Në prag të zgjedhjeve të vitit 2025, një grup profesionistësh, intelektualësh dhe qytetarësh të angazhuar, së bashku me propozime nga departamentet dhe strukturat e Partisë Demokratike, janë mbledhur për të kontribuar dhe për të ndërtuar një platformë që synon të përfaqësojë një vizion të ri, konservator dhe të qendrës së djathtë për të ardhmen e Shqipërisë. Ky grup ka hartuar bazën doktrinare dhe propozimet për programin elektorale të Partisë Demokratike, me theks të veçantë te ruajtja e vlerave të djathta që mbrojnë dhe fuqizojnë individin dhe familjen, promovojnë zhvillimin ekonomik dhe përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve.

Në këtë proces, synimi ynë është të ndërtojmë një platformë të qëndrueshme dhe realiste që i përgjigjet nevojave konkrete të shoqërisë shqiptare, të cilat më pas Partia Demokratike i bën pjesë të programit të saj përfundimtar dhe mandej të qeverisjes. Ky program përfshin politika të qarta dhe objektiva të matshëm që synojnë të adresojnë sfidat më kritike të vendit. Në thelb të këtyre propozimeve qëndron bindja jonë se Shqipëria mund të ndërtojë një të ardhme të sigurt dhe të begatë, bazuar në parimet e lirisë individuale, forcimit të familjes dhe zhvillimit të institucioneve të fuqishme.

Ky dokument reflekton kontributet nga një sërë ekspertësh dhe qytetarësh të angazhuar, nën koordinimin e Nikola Kedhi dhe me miratimin e Kryetarit të Partisë Demokratike Sali Berisha, të cilët vijnë nga disiplina të ndryshme, duke sjellë një perspektivë gjithëpërfshirëse dhe të menduar për të gjitha aspektet e zhvillimit të vendit. Këto propozime u bashkuan me punën e kryer nga departamentet e Partisë Demokratike, u konsultuan me grupet e interesit dhe prodhuan programin final të PD.

Vizioni ynë është të krijojmë një Shqipëri me një zhvillim të qëndrueshëm, ku liria ekonomike dhe përgjegjësi individuale janë në qendër të politikave ekonomike, duke inkurajuar rritjen ekonomike dhe përmirësimin e standardit të jetesës për të gjithë qytetarët, me ndërhyrje të kufizuara të qeverisë në ekonomi, përgjegjësi fiskale dhe një ulje të borxhit.

Shqipëria qëndron sot në një udhëkryq vendimtar për fatet e kombit. Gjatë dekadës së fundit nën qeverisjen socialiste, kombi ynë është përballur me shpopullim historik, përpjekje për të minuar integritetin territorial të vendit, keqqeverisje, korrupsion të paprecedentë në 30 vitet e fundit dhe një vrasje të shpresës për familjet shqiptare. Plagët nga e kaluara jonë komuniste mbeten ende të hapura, dhe për këtë edhe Partia Demokratike merr përsipër pjesën e vetë të përgjegjësisë.

Shteti vazhdon të zgjerojë kontrollin e tij mbi çdo individ dhe familje, duke mbytur potencialin e tyre ekonomik, liritë dhe të drejtat e tyre. Shumë shqiptarë ndihen të zhgënjyer, duke parë një qeveri që vendos politikën para njerëzve, burokracinë para zhvillimit dhe varësinë nga shteti para lirisë individuale. Sepse kur njerëzit lihen të lirë të vendosin, ata zgjedhin lirinë në çdo rast.

Një eksod masiv i mendjeve tona më të ndritura dhe qytetarëve tanë punëtorë, po dobëson strukturën sociale gati në mënyrë të pariparueshme dhe po lë të shpopulluara rajone të tëra. Familja, themeli i shoqërisë sonë, është goditur ekonomikisht dhe kulturisht, duke sjellë një krizë demografike që kërcënon ekzistencën tonë si komb.

Ne jemi të bindur se ka shpresë. Partia Demokratike, pas një agresioni të pashembullt në kontinentin European që vuri në pikëpyetje vetë ekzistencën e saj, tashmë është gati të qeverisë.

Ne besojmë se zgjidhjet për sfidat tona gjenden në rikthimin të vlerat që kanë mbajtur popullin tonë për shekuj me radhë—besimi të familja, puna e palodhur, sipërmarrja dhe shenjtëria e pronës private dhe liria personale. Këto vlera nuk janë relike të së shkuarës, por themelet e të ardhmes sonë.



Programi ynë është ndërtuar mbi politika që janë provuar vazhdimisht se funksionojnë, kudo ku janë zbatuar: ulja e taksave, reduktimi i burokracisë dhe ndërhyrjes arbitrare të shtetit te qytetari shqiptar, fuqizimi i familjeve dhe çlirimi i potencialit ekonomik të vendit tonë. Ne kemi nevojë për më pak varësi nga shteti dhe më shumë përqendrim te individit dhe familja. Ne besojmë se askush nuk është imun nga korrupsioni. Por duke vendosur mekanizmat dhe kontrollet e duhura, ne do i minimizojmë mundësitë e çdokujt për të dëmtuar interesat e shqiptarëve. Kjo kërkon një ndjenjë të fortë patriotizmi dhe atdhedashurie. Por, Partia Demokratike është grupimi i interesit kombëtar, dhe ne kemi vullnetin për të bërë çdo gjë që familja shqiptare të ketë besimin e mjaftueshëm për t'u rikthyer, jetuar, punuar, rritur dhe forcuar në vendin e vetë.

Duke vepruar kështu, ne do të kthejmë mbrapsht krizën e shpopullimit, do të krijojmë vende pune dhe do të ndërtojmë një të ardhme ku Shqipëria prodhon, eksporton dhe zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme. Ne do të ndërtojmë një ekonomi që është për të gjithë shqiptarët!

Ne sugjerojmë që këto propozime të shërbejnë si bazë për diskutimet me grupet e interesit, në çdo qark e bashki të Shqipërisë, në debate publike dhe tryeza të rrumbullakëta, për t'u pasuruar dhe finalizuar më tej. Ne propozojmë që për programin e Shëndetësisë, Arsimit, Pronës, Pensioneve dhe ndalimit të shpopullimit të hidhet ideja e një Pakti Kombëtar!

Një Vizion Optimist, Shpresëdhënës dhe Realist për Shqipërinë e së Ardhmes

Familja shqiptare është në qendër të programit të Partisë Demokratike. Pa familjen e shëndoshë, me mundësi ekonomike, arsimore, shëndetësore dhe sigurinë juridike, nuk mund të ketë një shoqëri shqiptare të fortë.

Ne nuk ofrojmë veç disa politika apo propozime. **Po i shtrijmë dorën çdo shqiptari për t'u bashkuar me një vizion afatgjatë, optimist, dhe tërësisht realist.** Ne shohim një Shqipëri ku familjet mbështeten, dhe jo rëndohen apo dhunohen; ku të rinjtë zgjedhin të qëndrojnë, të edukohen, të investojnë dhe të ndërtojnë të ardhmen e tyre; dhe ku një ekonomi dinamike krijon mundësi për të gjithë. Shqiptarët do të kthehen pa frikë në vendin e tyre, në vendin që u takon dhe të cilit i përkasin. Vendi ynë do të jetë një vend ku:

- Familjet janë në qendër të vendimeve politike, të mbështetura nga një ekonomi që vlerëson kontributin e tyre, me taksa të ulëta, incentivim të formimit të familjeve të reja, derregullim, eliminim të represionit qeveritar, tregje të lira e të drejta. Familje që marrin frymë lirisht sërish.
- Garantohet liria në treg dhe konkurrenca minimizon influencën e atyre që quhen oligarkë.
- Mbetjet e komunizmit, patronazhistët dhe servilizmi janë çrrënjësuar nga institucionet tona, të zëvendësuara me meritokraci, përgjegjshmëri dhe një kulturë sipërmarrjeje dhe përgjegjshmërie.
- Sistemi ynë arsimor patriotik përgatit brezin e ardhshëm me aftësi për të inovuar, krijuar dhe udhëhequr, duke nxitur një komb të prodhuesve, jo vetëm konsumatorëve.
- Sistemi shëndetësor i reformuar shkon te individit, me mjek të përgatitur, të paguar mirë dhe që ofrojnë shërbim dinjitoz.
- Sistemi i drejtësisë garanton barazinë përpara ligjit, dhe siguron drejtësi për çdo qytetar shqiptar.
- Çështjes së Pronës i jepet një zgjidhje përfundimtare me një Pakt të Madh Kombëtar.
- Bujqësia dhe turizmi lulëzojnë, të udhëhequra nga ferma dhe sipërmarrje që garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm, ndërsa pavarësia energjetike siguron të ardhmen tonë.
- Shqipëria qëndron e fortë, si në aspektin e sigurisë kombëtare, ashtu edhe në aleancat e saj strategjike, duke siguruar demokraci, ndarje të pushteteve, stabilitet dhe mirëqenie.

Kjo është Shqipëria që mund të ndërtojmë së bashku. Duke ruajtur vlerat tona shekullore, duke fuqizuar familjet dhe promovuar lirinë ekonomike, ne do të krijojmë një të ardhme të qëndrueshme dhe të begatë për brezat që vijnë. Partia Demokratike e ka vuajtur ashtu si çdo shqiptar arrogancën dhe autoritarizmin e qeverisë socialiste. Ne e dimë se çfarë duhet të bëjmë që kjo që ka ndodhur këto vite të mos përsëritet më, dhe liria e mirëqenia, së bashku me balancën e pushteteve të kthehet e përforcuar.



Tani është koha për ndryshim—një ndryshim të vërtetë dhe të qëndrueshëm që përqafon forcën e popullit tonë dhe potencialin e kombit tonë.

Së bashku, ne do ta transformojmë Shqipërinë në një burim shprese, në një vend ku familjet rriten të forta duke pasur mundësitë ekonomike, dhe kombi zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme.

1. Mirëqeverisja

Ne demokratët besojmë në një qeverisje të kufizuar e cila nënkupton një sistem në të cilin politika dhe qeveria kanë sa më pak fuqi mbi vendimet dhe ligjet që merren dhe ku këto ligje kufizojnë fuqitë e qeverisë për të shmangur abuzimin. Qeverisja e kufizuar siguron të drejtat e njeriut dhe është i vetmi sistem që krijon mundësinë ku njerëzit drejtojnë qeverinë dhe jo qeveria njerëzit. Për këtë arsye kushtetuta dhe ligjet e vendit kufizojnë veprimtarinë dhe prirjen për abuzim të qeverisë. Koncepti i qeverisjes së kufizuar nuk nënkupton thjesht një qeveri të vogël në numra por një qeveri me sa më pak pushtet dhe ndikim në jetën e qytetarit dhe familjes shqiptare.

Qeverisja e kufizuar ka lindur që në kohën e Magna Carta-s në vitet 1200 në Mbretërinë e Bashkuar dhe më pas u bë simbol i demokracisë amerikane me pamfletet Federale (the Federalist Papers) të cilat përcaktonin qartë rolin e qeverisë në një demokraci, ndarjen e pushteteve, kontrollin dhe balancën dhe federalizmin.

Në Shqipëri, ishte Partia Demokratike ajo e cila në vitin 2005 solli për herë të parë konceptin e pushtetit të kufizuar. Megjithatë Shqipëria vinte nga një e kaluar komuniste ku sistemi autoritar ishte ai që drejtonte me dorë të fortë dhe mungonin liritë dhe të drejtat elementare të njeriut, në vitet e para të demokracisë u punua në drejtim të ndarjes së pushteteve dhe miratimit të Kushtetutës së parë demokratike në vend. Pavarësisht punës së partisë Demokratike për të thyer sistemin etatist, që prej vitit 2013 Shqipëria drejtohet nga një qeveri krejtësisht etatiste ku fuqitë e qeverisë dhe pushteti i saj jo vetëm nuk janë të kufizuara, por kanë marrë nën kontroll të gjitha pushtetet e tjera.

Ne besojmë fort se vetëm me një sistem të fortë të kontrollit dhe balancës, ndarjes së pushteteve dhe përfaqësimit demokratik, vendi ynë mund të bëjë të mundur funksionimin e një shteti demokratik. Për të arritur këtë duhet:

- Të respektohet shteti i së drejtës;
- Të respektohet kushtetuta dhe ligjet e vendit;
- Vendi të ketë një korpus të vogël dhe të qartë ligjor;
- Ridimensionim të institucioneve të përfaqësimit (mundësisht edhe një kushtetute të re të pandikuar nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm politik; kushtetutë në kuadrin e qeverisjes së kufizuar)
- Vendorsje e një sistemi dy-dhomësh të përfaqësuesve të popullit për të parandaluar çdo lloj ngërçi politik dhe për të bërë një kontroll dhe balancë legjislative;
- Forcim i mekanizmave që mbrojnë opozitën në parlament dhe në jetën publike, duke e bërë një partnere të vendimmarrjes për çështje kombëtare.
- Rikthim i funksionimit me efikasitet të shërbimeve publike dhe të administratës, të cilat japin shërbime në kohë qytetarit.
- Të funksionojë, të depolitizohet dhe pavarësohet sistemi i drejtësisë;
- Të funksionojë transparenca publike në çdo sektor të vendit;
- Të zvogëlohet dhe depolitizohet administrata – Meritokracia dhe produkti i punës kriteret bazë;
- Të zvogëlohet kuadri rregullator;



- Të mos ketë ndërhyrje të shtetit në ekonomi dhe të sigurohet tregu i lirë dhe sipërmarrja e lirë;
- Të zvogëlohet niveli i taksave dhe kontrolli shtetëror në familjet dhe individin shqiptar;
- Të ç'ideologizohet administrata;
- Të depolitizohet arsimi dhe të kthehet autonomia në sistemin e arsimit dhe sektorë të tjerë që varen nga shteti;
- Të decentralizohet procesi i vendimmarrjes dhe të sanksionohet me ligj e drejta për referendum në nivel kombëtar dhe vendor;
- Të decentralizohet vendimmarrja territoriale;
- Të sigurohet përfaqësim i denjë demokratik dhe institucione të pavarura;

Për të arritur këtu, Shqipëria duhet të ketë një sistem drejtësie të pandikuar dhe transparent, të miratojë një ligj të ri për ndarjen territoriale dhe administrimin territorial, të kryejë një reformë të re administrative, reformë arsimore, dhe reformë për decentralizimin e pushtetit vendor. Për të gjithë këto, Partia Demokratike do të propozojë një Pakt Kombëtar, dhe do të nisë konsultime publike kombëtare sa më gjithëpërfshirëse, për të korrigjuar gabimet e dekadës së fundit.

Kryetarët e Bashkive, do të duhet të jenë të pavarur nga ndikimi i Ekzekutivit, dhe do të duhet të japin llogari vetëm përpara votuesit. Ky decentralizim dhe rikthim i vendimmarrjes në komunitetet sa më pranë individit dhe familjeve do të rikthejë jetën në qytetet e tjera përtej Tiranës, duke përfshirë aktivitetet kulturore, industriale, artistike dhe ekonomike. Teksa decentralizohet pushteti dhe zhvillimi ekonomik përkthehet të gjithë territorin e Republikës, niveli i mirëqenies do të sjellë një kërkesë më të madhe për kufizim të pushtetit në qendër.

Një vend me të kaluarën e Shqipërisë dhe me pasojat që ka sjellë shteti kriminal i kudondodhur i komunizmit ka nevojë të menjëhershme për liri individuale. Kjo liri nuk mund të vijë për sa kohë vendimmarrja përqendrohet në duart e një individi në zyrën e Kryeministrit.

Ne synojmë një kufizim të mekanizmave me të cilët qeveria mund të ndikojë dhe një shpërndarje të këtij pushteti të limituar mes institucionit të Presidentit, Kryeministrit, Legjislativit dhe Gjyqësorit, në mënyrë që pushtetet të kontrollojnë njëri tjetrin. Ne jemi të gatshëm të krijojmë të gjithë mekanizmat për të fuqizuar Legjislativin dhe për ta pavarësuar nga Ekzekutivi, përfshirë dhe krijimin e një dhome të dytë në Kuvend, që do të mund të shërbente si mekanizëm zgjidhjeje në raste krizash dhe kufizues i mëtejshëm i Ekzekutivit.

Ky limitim i fuqisë së qeverisë dhe shtetit administrativ ne mendojmë se do të duhet të jetë i sanksionuar në Kushtetutë, për të qenë garant sa më i madh për qytetarët shqiptarë. Ne si konservatorë besojmë se Kushtetuta jonë duhet të ketë një Deklaratë të Drejtave dhe Dinjitetit të Shqiptarëve për të siguruar përgjithmonë të gjithë kombin për liritë e të drejtat personale të dhëna nga Zoti dhe që asnjë qeveri nuk mund t'i prekë, duke përfshirë të drejtën e jetës, të fjalës, të pronës, të fesë, të shtypit, të protestës, gjykimit të drejtë dhe të sipërmarrjes së lirë, si dhe të vejë në dukje faktin që sovraniteti i përket popullit shqiptar, dhe vendimmarrja përfundimtare i takon vetëm atij.

Një parim tjetër shumë i rëndësishëm për ne është edhe 'fuqizimi i qytetarit' në proceset e hartimit të politikave qeverisëse. Kjo nënkupton përfshirjen, në kuvendimin mbi politikat qeverisëse të palëve të interesuara dhe të prekura nga politikat qeverisëse. Ky parim është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për tu zbatuar në të dyja nivelet e qeverisjes, por është vendimtar për nivelin vendor të qeverisjes. Çështjet qeverisëse të nivelit vendor prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë qytetarët, dhe kuvendimi i tyre për ne konservatorët është mënyra më efektive për të mbrojtur të drejtat natyrore të shtetasve (veçanërisht mbrojtjen e të drejtave pronësore, lirisë për të shprehur mendimin e lirë dhe ruajtjen e përmirësimin e cilësisë së jetesës). Për këtë arsye ne do të vazhdojmë të organizojmë debate publike në çdo cep të Shqipërisë, ku të dëgjohet fjala e qytetarit shqiptar dhe ai/ajo të jetë pjesëmarrës në çdo proces vendimmarrës.



Nga ana tjetër, qeveria e limituar shprehet nëpërmjet uljes së shpenzimeve qeveritare, taksimit të ulët, inkurajimit të sipërmarrjes së lirë dhe konkurrencës së drejtë, borxhit kombëtar të ulët si dhe tregut të lirë e pa ndërhyrje. Ky është një model i suksesshëm, që solli rritjen më të madhe në historinë e mirëqenies në botën e zhvilluar Perëndimore dhe forcoi individin dhe familjen. Ne jemi të bindur se ky model do të funksionojë edhe në Shqipëri.

Beteja për një qeverisje të kufizuar është një përpjekje e lirisë ndaj pushtetit. Kjo është beteja e çdo konservatori për të ruajtur liritë, të drejtat dhe dinjitetin e çdo qytetari dhe familjeje shqiptare dhe për t'u dhënë atyre të gjithë mekanizmat ligjore për t'u mbrojtur nga abuzimet e qeverive. Vetëm kështu Republika do të forcohet, institucionet do të ngrihen mbi baza të qëndrueshme dhe mirëqenia e shqiptarëve do të rritet, si në çdo vend kapitalist e demokratik në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

2. Modeli ekonomik – Mirëqenia e Familjeve, Forcimi i Individit dhe Rindërtimi Ekonomik

Vizioni ynë është të krijojmë një Shqipëri me një zhvillim të qëndrueshëm, ku liria ekonomike dhe përgjegjësia individuale janë në qendër të politikave ekonomike, duke inkurajuar rritjen ekonomike dhe përmirësimin e standardit të jetesës për të gjithë qytetarët, me ndërhyrje të kufizuara të qeverisë në ekonomi, përgjegjësi fiskale dhe një ulje të borxhit.

Liria individuale – Të djathtët shqiptare besojnë fort se çdo individ ka të drejtën e patjetërsueshme për të jetuar, për t'u edukuar, për të punuar, për të zgjedhur, për të krijuar një familje të fortë dhe të sigurtë, për të qenë i pavarur në vendimet mbi jetën e vet, për të ngjitur shkallët shoqërore mbi bazën e meritokracisë, për të pasur lirinë e nevojshme të nderojë historinë e vet, traditën dhe Zotin në të cilin beson. Ndaj, për të arritur të tërë këto elementë dhe për të mundur e respektuar këto të drejta që formojnë identitetin dhe dinjitetin e çdo individi, nevojitet një sistem ekonomik, i përputhshëm me këto vlera krejt natyrore, kulturore dhe njerëzore, krejt të natyrshme në qenien njerëzore. Ne besojmë se çdo individ ka aftësitë dhe mundësitë për të vendosur dhe zgjedhur i lirë për veten, familjen dhe komunitetin.

Inkurajimi i iniciativës private – Një sistem kapitalist, i tregut të lirë, me konkurrencë dhe i ndershëm, i cili është i rrënjësor në vlera dhe parime konservative dhe krejt njerëzore, i siguron individit, familjes dhe kombit shqiptar dinjitetin e munguar. Ne besojmë se i shërbejmë më mirë ekonomisë së Shqipërisë dhe mirëqenies së qytetarëve me një sistem të sipërmarrjes së lirë e te ndershme, me liri ekonomike, me të drejtat e pronës private dhe me sundimin e ligjit. **Ky sistem mbështetet më së miri nga politikat që nxisin tregtinë e lirë, konkurrencën e ndershme, lehtësimin e barrës rregullatorë dhe burokracive, si dhe duke pamundësuar ndërhyrjet klienteliste të qeverisë në ekonomi, për të shmangur shtrembërimin e tregjeve.** Në Shqipëri, ky sistem nuk ka mundur të zbatohet asnjëherë i plotë, duke u përzier me klientelizmin qeveritar, retoriken populiste dhe centralizimin socialist. Ne propozojmë një kapitalizëm patriotik, i cili do të mundësojë një ndërthurje të vlerave më të mira konservative me parimet e drejta të ekonomisë së lirë të tregut.

Një sistem meritokratik dhe patriotik – Ky sistem bazohet në një marrëdhënie të ngushtë simbiotike mes lirisë, konkurrencës, meritokracisë, solidaritetit dhe drejtësisë. Liria mund të shkatërrojë veten nëse nuk ushtrohet brenda një kornize morale, një grupi besimesh të përbashkëta, si dhe trashëgimisë shpirtërore të përcjellë përmes Patriotizmit, Familjes dhe Edukimit.

Ekonomia e tregut, edukimi dhe demokracia janë të lidhura ngushtë, sepse një ekonomi e tregut të lirë kërkon një popullsi më të arsimuar dhe kjo e fundit, nga ana tjetër, kërkon pjesëmarrje në politikë dhe vendimmarrje. Një individ me mjetet e duhura ekonomike dhe edukimin e nevojshëm arsimor dhe patriotik do të shkojë natyrshëm në mbrojtjen e vlerave familjare, kulturore dhe historike, por pa harruar të hedhë



sytë nga e ardhmja, risitë dhe përparimi i kujdesshëm i shoqërisë duke rritur mirëqenien mbi bazën e meritokracisë.

Ekonomia e tregut është një model i cili inkurajon shpirtin krijues të individëve, duke u përqëndruar tek meritokracia pa lënë mënjanë mbrojtjen e dinjitetit dhe lirisë njerëzore, kundër ndërhyrjeve dhe arbitraritetit të shtetit. Duke fuqizuar individin, familjen dhe komunitetin, ky sistem ndihmon në krijimin e një bashkimi dhe paqeje shoqërore, pasi e merr fuqinë dhe autoritetin e vet nga liria dhe përgjegjësia, konkurrenca dhe solidariteti. Individët bashkojnë forcat e tyre dhe bashkëpunojnë. Konkurrenca e lirë dhe e ndershme, sipërmarrja dhe ky sistem në tërësi do të mundësojë jo vetëm përmirësimin e ndjeshëm të jetës së qytetarëve, por dhe risi në fusha të ndryshme të shoqërisë – si dhe të bashkëshoqërojë Shqipërinë në shekullin e 21-të dhe ta ngrejë kombin në lartësinë e sfidave të kohës sonë.

Parimet, qëllimet dhe politikat e propozuara

A. Parimi 1: Mbrojtja e tregut të Lirë dhe Liria Ekonomike:

Qeveria është thjesht një monopol, dhe si e tillë ka një prirje të natyrshme për të shpërndarë në mënyrë të gabuar kapitalin dhe për të vepruar në një mënyrë të favorshme politikisht, që jo domosdoshmërisht ndikon për mirë te qytetarët. Tregu, nga ana tjetër, është institucioni më demokratik që ekziston. Një shumëllojshmëri individësh ndërveprojnë me njëri tjetrin në mënyrë të vazhdueshme edhe duke gabuar e më pas duke korrigjuar gabimin, deri në arritjen e një baraspeshe të kënaqshme për shoqërinë. Në rastet e ndërhyrjes qeveritare, kjo baraspeshë prishet.

Janë nevojat dhe dëshirat e individit që do të çojnë në një baraspeshë të përgjithshme dhe do të përcaktojnë se çfarë do të prodhohet, si dhe sasinë e çmimit e prodhimit, gjë që do të bëjë që ndërmarrjet e ndryshme të konkurrojnë me ide, produkte dhe shërbime, për të përdorur më së miri burimet dhe kapitalin e kufizuar. Kjo konkurrencë do të rezultojë në kosto më të ulëta dhe standard më të lartë jetese. Në asnjë rrethanë nuk mund t'i dijë qeveria këto nevoja dhe dëshira më mirë se vetë individit. Në këtë frymë, qëllimi ynë është heqja ose kufizimi i të gjithë subvencioneve dhe barrës së tepërt rregullatore, si dhe krijimi i një sistemi fiskal të drejtë dhe proporcional për të krijuar një mjedis sipërmarrës sa më konkurrent. Ne jemi të bindur se Shqipëria duhet shndërruar nga një vend me shoqëri të varur së tepërmi nga shteti dhe politika, për shkak të varfërisë së skajshme, në një vend që ja del vetë mbanë falë aftësive të secilit individ shqiptar.

1. Promovimi i të drejtave dhe dinjitetit individual si themelet e një shoqërie të lirë:

- E djathta thekson rëndësinë e të drejtave individuale si themelet e një shoqërie të lirë dhe të pasur. Këto të drejta përfshijnë të drejtën për të jetuar, punuar, zgjedhur, dhe krijuar një familje të fortë, të rrënjëzuara në vlerat dhe humanizmin konservator.
- Ne besojmë se këto të drejta janë rrënjëzuar në vlerat humane, të cilat janë të domosdoshme për të ruajtur dinjitetin e çdo individ.
- Në themel të një sistemi të drejtë ekonomik dhe shoqëror do të duhet të qëndrojnë meritokracia
- Ne besojmë se edukimi është i lidhur ngushtësisht me një sistem ekonomik të drejtë e të zhvilluar dhe me një demokraci funksionale.

2. Promovimi i kapitalizmit dhe tregut të lirë si motorët kryesore të rritjes ekonomike:

- E djathta dhe Partia Demokratike si grupimi më i madh i saj, mbështesin dhe promovojnë një sistem kapitalist bazuar në sipërmarrje të lirë, konkurrencë të ndershme, liri ekonomike, të drejtat e pronës private, dhe sundimin e ligjit. Një qeveri e djathtë që ka vullnetin të garantojë këto elementë arrin të zgjidhë problemet themelore të klientelizmit dhe oligarkisë.
- Ne besojmë se vendi ka nevojë për siguri juridike dhe një shtet të së drejtës për të pasur mandej një sistem ekonomik kapitalist, të tregut të lirë.



- PD beson se doktrina e kapitalizmit e bazuar ne tregun e lirë, konkurrencën e lirë e të ndershme në treg, u ofron individëve mundësinë për të çliruar potencialin e tyre maksimal, vënë në punë aftësitë që kanë dhe për të arritur prosperitet ekonomik përmes përpjekjeve të tyre.
- Nxitja e konkurrencës mund të kryhet nëpërmjet teknologjisë, inovacionit që sipërmarrjet kryejnë me paratë që kanë nga ulja e taksave dhe e burokracisë shtetërore, nga reduktimi i barrierave për hyrjen në treg të agjentëve ekonomike, nga lehtësimi i aksesit në financë.
- Vizioni i të djathtës dhe Partisë Demokratike nuk është thjesht për katër vitet e ardhshme në qeverisje, por duhet të krijojë kushtet për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm për tre dekadat e ardhshme. Në këtë aspekt, lehtësirat fiskale për sipërmarrjen, për hyrjen në treg të sipërmarrjeve të reja, për zhvillimin teknologjik duhet të fokusohen te industrializimi i vendit dhe shndërrimi i tij në një vend prodhues dhe eksportues, së bashku me një hov cilësor për shërbimet që vendi ynë ofron, duke krijuar kështu, nëpërmjet sektorit privat vende pune me paga të rritura e dinjitoze.

3. Kufizimi i ndërhyrjes së qeverisë në ekonomi për te maksimizuar lirinë individuale dhe te drejtat e sipërmarrësve:

- PD kundërshton ndërhyrjet e tepërta të qeverisë në ekonomi, favorizimin e aktorëve të ndryshëm në treg, dhe përkrah iniciativën dhe sipërmarrjen individuale.
- Roli i Qeverisë ne ekonomi duhet te kufizohet vetëm në shërbimet publike themelore si siguria, drejtësia, shëndetësia, diplomacia, arsimi, shkenca. Kjo do te realizohet paralelisht me inkurajimin e sipërmarrjes private në këto sektorë me qellim rritjen e efikasitetit, konkurrueshmerisë dhe cilësisë së ofruar për qytetarët.
- Ata që sot quhen rëndom oligarkë nuk kanë ardhur si rezultat i tregut të lirë apo kapitalizmit, as meritokracisë dhe konkurrencës së ndershme, por si rrjedhojë e ndërhyrjes së shtetit për t'i favorizuar, përkundrejt konkurrentëve të tyre në treg. Partia Demokratike do të ketë vullnetin e nevojshëm politik për të frenuar këto ndërhyrje në treg, dhe për të krijuar mekanizmat e duhur që të sigurojnë transparencë dhe llogaridhënie për çdo tender apo partneritet publik privat.
- PD propozon politika që promovojnë tregtinë e lirë, heqin barrën e tepërt rregullatore (procesi i deregullimit), reduktojnë burokratitë nëpërmjet digjitalizimit te shërbimeve publike dhe parandalojnë ndërhyrjen e qeverisë në ekonomi për të shmangur deformimin e tregut.
- PD do të nxisë digjitalizimin e shërbimeve publike me qëllim rritjen e efikasitetit por dhe reduktimin e shpenzimeve publike dhe reduktimin e deficitit/borxhit publik. Ky digjitalizim do të shoqërohet me një rritje të sigurisë kibernetike, në mënyrë që situata si rrjedhja e të dhënave në vitet e fundit të mos përsëriten më.
- Ne besojmë se duhet ndërruar filozofia e kontratave koncesionare dhe PPP, me qellim rritjen e transparencës financiare ndaj publikut, rritjen e përgjegjshmërisë (accountability) afrimin e investimeve si dhe rritjen e perfitueshmerisë për shtetin shqiptar.
- Përmirësimi i klimës ekonomike dhe një reformë e vërtetë gjyqësore, jo vetëm ndikojnë në zhvillimin e sipërmarrjeve vendase, por tërheqin investime të huaja të një madhësie të konsiderueshme. Duhet theksuar se, në këndvështrimin tonë, tema e investimeve në Shqipëri nuk është thjesht çështje e zbatimit të ligjeve të duhura, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Në thelb, ne si konservatorë jemi të vetëdijshëm se duhen gjetur dhe shqyrtuar në mënyrë përfundimtare e të drejtë shkaqet kryesore dhe zgjidhjet e çështjeve të pronës, transparencës, zbatimit të ligjit, stimujve fiskalë dhe ndërhyrjes së qeverisë.

B. Parimi 2: Një sistem tatimor i drejtë, i thjeshtë dhe proporcional dhe stabilitet fiskal:

1. Taksa e sheshtë proporcionale dhe e ulët:

- PD mbështet një sistem tatimor të thjeshtë, të ulët, dhe të drejtë, siç është taksa e sheshtë prej 10%, për të minimizuar barrën mbi qytetarët, rritur të ardhurat qeveritare dhe për të nxitur aktivitetin ekonomik. Ulja e barrës tatimore do te reduktojë evazionin fiskal, dhe zgjerimi i bazës tatimore i shoqëruar me rritjen e të ardhurave/mirëqenies se individit, do te kompensojnë ndryshimin e te



ardhurave ne Buxhetin e Shtetit. Kufizimi i ndërhyrjeve të tepërta fiskale në ekonomi dhe krijimi i një balancë fiskale që nuk rrezikon stabilitetin monetar dhe krijon një mjedis të qëndrueshëm për investime afatgjata.

- Ne propozojmë një taksë 10 përqind për fitimin e sipërmarrjeve, për dividendin, si dhe për të ardhurat personale nga paga.

Taksat e ulëta inkurajojnë akumulimin e kapitalit, meritokracinë, efikasitetin, punën, investimin, dhe inovacionin, duke çuar në rritje ekonomike dhe standarde më të larta jetese.

Taksat e ulëta minimizojnë prirjen për evazion fiskal, neutralizojnë tendencat për shmangie tatimore dhe ulin informalitetin duke zgjeruar bazën e tatimpaguesve.

Sistemi tatimor në Shqipëri **duhet të jetë i thjeshtë për t'u kuptuar nga të gjithë qytetarët e Republikës, të lehtësojë barrën fiskale në një nivel të ulët dhe të jetë i drejtë nga pikëpamja proporcionale**. Taksat nuk duhet të shërbejnë si një barrë për individët, por duhen perceptuar si të nevojshme për të kryer një sërë funksionesh në të mirë të shoqërisë, siç është siguria kombëtare, punët publike etj. Në këtë frymë, ne, si konservatorë, i qëndrojmë taksës së sheshtë proporcionale dhe te ulet, si mjeti më frytdhënës për të mbledhur të ardhurat e nevojshme dhe për të kryer detyrat më të rëndësishme të shtetit, pa ndikuar në aftësitë sipërmarrëse dhe punëtore të individit shqiptar, si dhe pa prekur negativisht prodhimtarinë e ekonomisë shqiptare.

Politikat e qeverisë do të duhet të sigurojnë stabilitet si për qytetarët shqiptarë dhe për investitorët e huaj. Në këtë aspekt, **taksat dhe tarifat e ndryshme të vendosura nga qeveria nuk do të jenë objekt ndryshimesh të shpeshta**.

Duke parë dhe vlerësuar suksesin e përdorimit të taksës së sheshtë në qeverinë e kaluar të Partisë Demokratike (2005 – 2013), si dhe ndikimin që kjo taksë ka pasur në rritjen e madhe ekonomike në vendet e tjera, ne besojmë se ripërdorimi i këtij sistemi do t'i jepte çdo familjeje mundësi më të mëdha për të kursyer, konsumuar dhe investuar më shumë. Ne jemi të bindur se taksa e sheshtë do të ishte më e thjeshtë dhe më e drejtë proporcionalisht se sistemi aktual i taksave dhe do të mundësonte rritje të ndjeshme në ekonominë shqiptare, duke i dhënë një frymë të re, pas gati një dhjetëvjeçari vështirësish ekonomike, familjeve shqiptare

Ne besojmë se lehtësimi i barrës tatimore dhe politikat kapitaliste patriotike, janë **një shtysë për krijimin e familjeve të reja dhe rritjen e lindjeve në vend**, për të frenuar dhe ndalur përfundimisht procesin e shpopullimit.

Ne i qëndrojmë parimit se individët duhet të taten proporcionalisht mbi të ardhurat e tyre, të fituara mbi parimin e meritokracisë, punës, edukimit e investimit tek kapitali njerëzor. **Një individ që fiton të ardhura më të larta për shkak të këtyre specifikave nuk ka përse të paguajë progresivisht më shumë, por proporcionalisht dhe me një normë të ulët, që të incentivohet puna, investimi dhe rritja e punësimit. Rritja e të ardhurave në mënyrë proporcionale rrit edhe vlerën e tatimit të paguar, në mënyrë të drejtë e jo progresive (agressive).**

Ne duhet të shpërblejmë punën, talentin, meritokracinë e jo t'i ndëshkojmë ato me taksa apo barrë të panevojshme rregullatore.

Bindja jonë është se nuk i takon burokracisë shtetërore të ndërhyjë në liritë e individit, duke i ndrydhur dhe kufizuar me pretekstin e ri-shpërndarjes arbitrare të të ardhurave në shoqëri. Sistemi tatimor do të duhet të reflektojë këtë filozofi tonën për nxitjen e meritokracisë, punës dhe talentit.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përbëjnë shtyllën kurrizore të ekonomisë shqiptare, me mbi 90% të ndërmarrjeve aktive dhe rreth 80% të të punësuarve. Forcimi dhe zhvillimi i këtyre ndërmarrjeve është i



lidhur pazgjidhshmërisht me rivendosjen e konkurrencës së drejtë në treg, duke i qëndruar filozofisë së mosndërhyrjes dhe distancës së barabartë mes të tërë aktorëve në treg dhe duke i dhënë fund një herë e mirë abuzimeve me tenderat, trajtimeve parapëlqyese dhe rregullave burokratike të dëmshme që qeveria krijon.

Për sipërmarrjet e vogla, dhe ato të reja ne propozojmë:

1. Biznesi i vogël (deri më 8,000,000 lekë) të tatohet 5%

2. Bizneset e të rinjve deri në 30 vjeç dhe grave mund të përfitojnë zero taksë për 3 vitet e para + 50% ulje tatimi për 2 vitet pasuese

3. Bizneset startup në fushën e teknologjisë, fintech apo agroturizëm do të kenë ulje të tatimit me 50% për 3 vitet e para. Për më tepër, norma tatimore e ulët dhe e sheshtë mbi të ardhurat e sipërmarrjeve, ashtu si për individët, ka një ndikim të ndjeshëm pozitiv ekonomik, sepse në radhë të parë shmang evazionin fiskal dhe parapëlqimet e pajustificuara tatimore.

Mandej, ulja e kostos së kapitalit rrit investimet dhe e kthen Shqipërinë në një vend tërheqës si për kompanitë e huaja dhe sidomos për ato vendase, duke e bërë ekonominë më produktive. Prodhimi për punëtor rritet, duke ndikuar dhe në rritjen e pagave reale. Taksat e ulëta dhe barra e zvogëluar rregullatore reduktojnë shtrembërimet në treg, duke i lejuar në veçanti kompanitë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të marrin vendimet më të mira për t'u zmadhuar, për të punësuar më shumë, për të investuar dhe për të përmirësuar kështu efikasitetin ekonomik.

2. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në funksion të uljes së barrës fiskale, stimulimin e aktivitetit ekonomik dhe thjeshtimin e sistemit të taksave.

- **Rishikimi i normës së TVSH-së:** Bazuar në një analizë të detajuar të treguesve makro-ekonomik, gjatë mandatit të parë të qeverisjes, PD do të vlerësojë propozimin për uljen e normës standarde të TVSH-së, në 17%, me qëllim për të nxitur konsumatorët të shpenzojnë më shumë, duke nxitur kështu rritjen ekonomike.
- **Reduktimi i normës së TVSH-së për sektorët kyç ose për produktet bazë:** Ne mbështesim uljen e normës së TVSH-së, në 7%, për sektorë specifikë si bujqësia, turizmi dhe produktet bazë të shportës, për të lehtësuar kostot për konsumatorët dhe për të mbështetur zhvillimin e sektorëve të rëndësishëm. Reduktimi i TVSH për produkte të domosdoshme si ushqimet dhe shërbimet bazë, do të propozohet me qëllim mbështetjen e grupeve me të ardhura të ulëta, duke ulur koston e jetesës për këto kategori. Pra reduktimi i TVSH do të realizohet për objektiva ngushtësisht të lidhur me sektorët prioritarë dhe mirëqenien e publikut. Ne asnjë rast nuk do të ndërhyhet në skemën e TVSH për të favorizuar investime të sipërmarrësve me lidhje me politiken.
- **Thjeshtimi i strukturës së TVSH-së:** Në parim ne mbështesim thjeshtimin e kategorive të TVSH-së, me qëllim uljen e kostove administrative për bizneset dhe reduktimin e gabimeve dhe të evazionit fiskal. Një strukturë më e thjeshtë mund të përfshijë, për shembull, uljen e numrit të normave të diferencuara të TVSH-së, vetëm në dy nivele, **17% dhe 7%**, duke pamundësuar ndërhyrjet që janë bërë në skemën ekzistuese të TVSH për të favorizuar individë apo investime me mbështetje politike.
- **Masa për të përmirësuar mbledhjen e TVSH-së dhe luftën kundër evazionit fiskal:** Përmirësimi i administrimit fiskal dhe implementimi i teknologjive të reja për monitorimin e transaksioneve mund të rrisin të ardhurat nga TVSH, për të netuar efektet e reduktimit të normës së TVSH, pa krijuar efekte negative në buxhet.

C. Parimi 3: Deregullimi - Heqja e Barrës së tepërt Rregullatore për të Rritur Sipërmarrjen:

- PD synon të ulë barrën burokratike dhe rregullatore për të krijuar një mjedis konkurrues biznesi, ku shteti nuk është pengesë, por partner i biznesit dhe qytetarit. Burokracia e tepërt dëmton



sipërmarrjen e lirë dhe pengon rritjen ekonomike, veçanërisht për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme.

- Duhet rritur niveli i digjitalizimit, shoqëruar me rritjen e sigurisë, për shërbimet publike, nën shembullin e vendeve të tjera post-komuniste, si Estonia.
- Ne propozojmë lehtësimin e procedurave të hapjes dhe mbylljes së bizneseve, pajisjes së tyre me identifikim fiskal dhe regjistrimin me organet tatimore e të sigurimeve shoqërore/shëndetësore. Duhet incentivuar përdorimi i firmës digjitale.
- Reduktimi i kërkesave për licensë apo heqja e licensave për aktivitete të caktuara me qëllim nxitjen e sipërmarrjes
- Lehtësimi i procedurave të inspektimit dhe reduktim në maksimum i kontaktit të punonjësve shtetëror me biznesin. Ne propozojmë nxitjen e vetërregullimit apo vetëkrijimit të standardeve të caktuara në segmente të biznesit si një mënyrë e mirë për të rritur profesionalizmin (të ngjashme me urdhrin e mjekut, farmacistit, dhomën e avokatisë etj.)
- Lehtësimi i procedurave të arbitrazhit dhe apo atyre gjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes bizneseve me njeri tjetrin apo me shtetin dhe biznesin.
- Një problem të rëndësishëm për të vetëpunësuarit dhe bizneset e vogla, është përballja me sfidën e mosmarrjes së pagesave për faturat e lëshuara ndaj bizneseve më të mëdha. Aktualisht, në Shqipëri, fatura e tyre nuk njihet si titull ekzekutiv, që do të thotë se nuk kanë një mjet të drejtpërdrejtë për të kërkuar pagesën në mënyrë ligjore dhe efektive. Kjo krijon vështirësi të konsiderueshme për likuiditetin dhe qëndrueshmërinë e këtyre bizneseve të vogla.

Ne sugjerojmë dy masa për të përmirësuar situatën:

- Ndryshime ligjore për njohjen e faturës si titull ekzekutiv – Kjo do t'u siguronte bizneseve të vogla një mekanizëm të fuqishëm për të kërkuar pagesën e detyrimeve në mënyrë të menjëhershme dhe do të ulte pasigurinë që ata kanë në arkëtimin e tyre.
- Mbështetje nga shteti për të vetëpunësuarit dhe bizneset e vogla – Në rastet kur faturat e tyre nuk shlyhen nga bizneset e mëdha, shteti mund të ndërhyjë për t'i mbrojtur. Kjo mund të realizohet duke adoptuar praktika si ato të Spanjës, ku shteti publikon listat e bizneseve të mëdha që nuk kanë paguar detyrimet ndaj bizneseve të vogla. Si masë më e rreptë, bizneset e mëdha që kanë detyrime të papaguara mund të jenë objekt kontrolli deri në shlyerjen e borxhit.

Këto masa do të nxisnin transparencën dhe përgjegjshmërinë e bizneseve të mëdha ndaj të vegjëlve, duke forcuar ekosistemin e biznesit dhe duke siguruar një mjedis më të drejtë dhe të qëndrueshëm për bizneset e vogla dhe të vetëpunësuarit.

Qëllimi ynë është të krijojmë infrastrukturën e duhur ligjore dhe sigurinë e nevojshme për investitorët vendas dhe të huaj, sipërmarrësit e vegjël, të mesëm dhe të mëdhenj. Ne besojmë në zvogëlimin e kufijve të burokracisë dhe hapësirave ku mund të ndikojë shteti dhe kufizimin e ndjeshëm të ndikimit dhe ndërhyrjes qeveritare në sektorin privat, për t'u krijuar qytetarëve të gjithë mundësitë për të shpalosur aftësitë sipërmarrëse dhe punëtore.

Me një sistem tatimor të drejtë dhe proporcional, me një burokraci shumë më të zvogëluar, me një konkurrencë më të madhe, qytetari shqiptar do të ketë produkte më të shumta, me kosto më të ulët, dhe me paga më të larta.

D. Parimi 4: Politika fiskale të përgjegjshme – Ulja e Shpenzimeve të panevojshme të qeverisë, kufizim i borxhit dhe koordinim me politikat monetare

1. Kufizimi i borxhit publik dhe shmangia e financimit monetar të deficiteve buxhetore:

PD thekson rëndësinë e përgjegjësisë fiskale dhe uljes së borxhit publik për të parandaluar paaftësinë ekonomike.



Si një qeveri konservatore, PD do të ndjekë **një politikë fiskale të përgjegjshme, me deficite të ulëta dhe një balancë buxhetore afatgjatë**. Shpenzimet publike duhet të jenë të targetuara dhe të shoqërohen me një përkushtim për të mbajtur borxhin publik nën kontroll. Ulja e borxhit publik nuk duhet të rezultojë nga faktorë të jashtëm, siç është nënvlerësimi i vazhdueshëm i monedhave të huaja, siç po ndodh në dy vitet e fundit, por një ulje reale bazuar në mirëmenaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve publike nga ana e qeverisë.

Si një forcë konservatore e qendrës së djathtë, **PD beson se nivelet e larta të borxhit, jo vetëm pengojnë zhvillim aktual të ekonomisë, por dhe ngarkojnë brezat e ardhshëm dhe kufizojnë aftësinë e qeverisë për të investuar në fushat kritike si infrastruktura, arsimi apo shëndetësia**.

2. Ulje e shpenzimeve publike të paqëndrueshme dhe reformim i sektorit publik:

Taksat e sheshta dhe të ulëta nuk funksionojnë nëse, nga ana tjetër, qeveria rrit ndërhyrjet e veta në treg, zmadhon ndikimin e vet në jetën e qytetarëve dhe shpenzon pa fre në programe dhe sektorë joproduktivë. Nëse nuk mund të shpenzojmë më shumë se të ardhurat që mbledhim nga qytetarët, dhe duhet të kemi konsideratën më të lartë për të ardhurat që qytetari shqiptar i heq nga vetja dhe ja jep shtetit.

Përgjegjësi fiskale do të thotë reduktim maksimal i shpenzimeve operative dhe eliminim i plotë i tenderave korruptivë, keqpërdorimit të aseteve dhe financave publike si dhe trajtimit parapëlqyes të klientëve qeveritarë. Ulja e nivelit të borxhit në minimumin historik, konsolidimi i financave të shtetit shqiptar, rikthimi i shpenzimeve qeveritare në normalitet, eliminimi i shpërdorimeve burokratike dhe korrupsionit qeveritar, për të shpëtuar Shqipërinë nga katastrofa ekonomike e krijuar nga qeverisja socialiste dhe politikat e majta klienteliste, me pasojë të pritshme tepër të rënda për dekadat e ardhshme, është detyrë morale dhe patriotike e çdo konservatori.

Ne propozojmë:

- konsolidimin fiskal **duke reduktuar nivelin e evazionit apo maksimizuar nivelin e vjeljes së të ardhurave tatimore, një administrim më efikas, nxitjen e investimeve të huaja direkte si dhe nxitje të eksporteve**. Inkurajimi i Shqipërisë, që me siguri juridike dhe fiskale, me sistem tatimor të drejtë dhe proporcional, prodhon dhe eksporton do të çojë në rritjen e vendeve të punës, forcimin e sipërmarrjeve, rritjen e të ardhurave qeveritare, dhe uljen e borxhit.
- reduktimin e shpenzimeve publike duke administruar me mire koncesionet dhe PPP-të si dhe administruar shpenzimet publike (reduktim të administratës, duke vendosur si kusht, ashtu si në çdo sipërmarrje private produktin final të secilit punonjës aftësinë e tij/saj, dhe rendimentin, ulje të subvencioneve jo efikase dhe të përdorura në mënyrë abuzive, efikasitet në ndihmën sociale, reformë në pensione për reduktimin e detyrimit buxhetor, priorizim bazuar në efikasitetin e investimeve publike). Ne premtojmë llogaridhënie për koncesionet dhe PPP-të, **duke nisur me një audit të thelluar të kontratave aktuale, për të parë nëse termat kanë qenë në interes të taksapaguesve shqiptarë, nëse ka pasur dëme për ekonominë shqiptare dhe për të verifikuar respektimin e termave**.
- ulje të shpenzimeve të panevojshme të qeverisë, shpenzimeve operative të ministrive dhe dikastereve të ndryshme, dhe **luftë në mënyrë të pakompromis korrupsionin. Reformimi i sektorit publik**, duke ndryshuar mentalitetin dhe funksionimin, duke e orientuar drejt produktivitetit dhe konkurrencës, do të bëjë administratën më efikase, të përqëndruar në funksionet dhe shërbimet kryesore, e duke e sjellë më pranë qytetarit.
- disiplinim të deficitit buxhetor vjetor, i cili në mënyrë të akumuluar krijon borxhin publik
- administrim më efikas të borxhit publik nëpërmjet zgjatjes së maturimit dhe shtimit të instrumenteve të menaxhimit të borxhit publik.
- vendosjen e kufijve për nivelin e borxhit publik dhe përqendrimi në mbajtjen e një buxheti të ekuilibruar në afatin e mesëm. Shmangia e financimit monetar të borxhit, ku qeveria do të përpiquej



të mbulonte deficitin duke u mbështetur te Banka Qendrore. Krijimi i parasë thjesht për të mbuluar deficitin do të çonte në inflacion të lartë.

- Si pjesë e reformimit të programeve qeveritare, ne premtojmë reformën në pensione duke futur Kolonën 2 te pensioneve, e cila i jep zgjidhje përfundimtare kësaj plaje brenda 3 dekadave.

Rezultati i pritshëm i këtyre masave do të jetë një stabilitet më i madh ekonomik, shmangia e krizave të borxhit, si dhe mbrojtja e fuqisë blerëse të qytetarëve.

Për të minimizuar korrupsionin qeveritar ne propozojmë:

- Digjitalizim të shërbimeve publike, me një vëmendje të veçantë në rritjen e sigurisë kibernetike
- Reformim të inspektoriateve për t'i bërë më efikase dhe të bazuara në analiza risku, duke shmangur kontaktin njerëzor me sipërmarrjen.
- Transparencë maksimale në prokurimet publike
- Autonomi dhe vetëfinancim të institucioneve shtetërore
- Filozofia e qeverisë socialiste, e rrënjosur në korrupsion dhe shpërdorim të fondeve publike, duket se e ka gjetur shpëtimin në rritjen masive të borxhit (dhe përmirësimi i treguesve të borxhit publik në vitet e fundit nuk është rrjedhojë e menaxhimit të kujdesshëm të politikave fiskale nga ana e qeverisë por ndikim i drejtpërdrejtë i mbivlerësimit masiv të lekut ndaj valutave të huaja), për të financuar shpenzimet qeveritare gjithmonë e më në rritje dhe partneritetet publike private.

- Dëmi ekonomik në dekadën e fundit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) në disa raporte të viteve të fundit ka evidentuar probleme të theksuara në projektet e PPP-ve, ku një pjesë e mirë e tyre janë konsideruar si të rrezikshme për financat publike. Sipas Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga viti 2013 në vitin 2022, ka rreth 805 miliardë lekë dëm ekonomik. KLSH ka evidentuar mbi 72.3 miliardë lekë dëm ekonomik gjatë vitit 2023, 138 miliardë lekë dëm ekonomik gjatë vitit 2022 dhe 159 milionë euro dëm ekonomik gjatë vitit 2021.

Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit nga Transparency International, Shqipëria renditet mes vendeve më të korruptuara në Evropë, duke u përballur me probleme serioze në efektivitetin e qeverisjes dhe sundimin e ligjit. Vetëm 8% e shqiptarëve besojnë që qeveria e tyre është e përkushtuar në luftën kundër korrupsionit.

Problemi me rritjen e borxhi është se në dekadën e fundit nuk është shoqëruar me rritje ekonomike reale për qytetarin dhe familjet shqiptare. Borxhi publik lëshohet për të paguar shpenzimet e borxheve të mëparshëm, investime shpeshherë korruptive me kthim të ulët dhe për të mbajtur administratën që zgjerohet vazhdimisht. E vetmja arsye për zvogëlimin e borxhit në tre vitet e fundit, ka qenë nënvlerësimi i monedhës Euro, dhe jo reformat qeveritare apo rritja e mirëqenies.

Në mendimin tonë mirëqenia e individit shqiptar nuk rritet duke marrë borxh dhe duke shpërdoruar paratë e taksapaguesve. Për ne është e qartë dhe nga studimet e ekspertëve më të mëdhenj ekonomikë se rritja e borxhit dhe e shpenzimeve qeveritare nëpërmjet deficitit buxhetor ka impakt tejet të papërfillshëm në ekonominë reale. Varësia ndaj shpenzimeve deficitare rrit nepotizmin, rrit abuzimin dhe çon në rritje ekonomike mediokre (fiktive), papunësi të lartë ose punësim fiktiv e aspak efikas dhe ulje të konkurrueshmërisë. Studime të fundit tregojnë se një borxh publik që arrin dhe kalon 100% të PBB-së, redukton rritjen reale të ekonomisë në vit me 1.6%, ul investimet dhe dobëson punësimin me 0.6% në vit. Nëse do të vazhdojë të ndiqet kjo rrugë, vendi mund të përballë me krizë të rëndë borxhi dhe shkatërrim të ekonomisë shqiptare.

Pra, është një nevojë e menjëhershme të ulët sasia e borxhit, të ndërpriten shpenzimet qeveritare të panevojshme, të shqyrtohen dëmet nga humbjet në arbitrazh, të frenohet korrupsioni, dhe të stimulohet sektori privat. Reduktimi i borxhit publik amortizon shkon në të njëjtën linjë edhe me reduktimin e shpenzimeve publike të panevojshme dhe reduktimin e të ardhurave fiskale që vjen nga politika e uljes së



taksave. Në vizionin tonë, kjo bëhet përmes politikave të anës së ofertës që stimulojnë ndërmarrjet private, rrisin investimet, ndihmojnë prodhimin, dhe rrisin punësimin. Kjo shkon në të njëjtin drejtim me filozofinë tonë konservatore të qeverisë së limituar, decentralizimit dhe përgjegjësisë fiskale.

3. Reforma ne Sistemin e Pensioneve dhe Sigurimeve Shëndetësore

Skemat e Pensioneve

Sistemi i pensioneve në vendin tonë ngelet një ndër plagët më të mëdha shoqërore të vendit. Kjo ka ardhur:

- a. Për shkak të rritjes së jetëgjatësisë së popullsisë, që ka çuar në rritjen e kostove të skemës
- b. Për shkak të reduktimit të kontributeve si pasojë e emigracionit masiv dhe informalitetit, që ka çuar në pakësimin e të ardhurave të skemës.

Duke filluar që nga viti 2011, me asistencën e Bankës Botërore, në Shqipëri kane filluar të krijohen skemat e para të pensioneve suplementare private, të cilat njihen si Kolona III, për shkak të kontributit të pjesëmarrjeve mbi baza vullnetare. Pavarësisht zhvillimit të tregut, këto skema janë rritur gradualisht dhe me një ritëm jo fort të kënaqshëm, kryesisht për shkak të nivelit modest të edukimit financiar, mungesave të mënyrave alternative të investimit, por edhe të mbështetjes së ulët fiskale.

Në këto kushte, kur deficit i skemës aktuale të pensioneve shtetërore ISSH (Kolona 1 ose pay-as-you-go) sa vjen e rritet, ndërkohë që niveli i kontributeve është në trend rritës, mendojmë se skema e pensioneve në Shqipëri ka nevojë të menjëhershme për një reformë strukturore thelbësore e cila të mundësojë shëndetin financiar të sistemit të pensioneve në vend, por edhe një të ardhur dinjitoze për shtresat më delikate, të moshës së tretë.

Për këtë qëllim, në ndryshim nga vendimet korrigjuese me efekt afatshkurtër që janë bërë deri më sot, ne shohim si zgjidhje përfundimtare të problemit të stabilitetit të skemave të pensionit, futjen në zbatim të Kolonës së II-të të pensioneve të cilat nga pikëpamja operacionale janë efikase (me vetëfinancim) njësoj si Kolona III, por nga ana tjetër, janë të detyrueshme për një pjesë të rëndësishme të popullsisë, sidomos për brezat e rinj.

Për shkak të kostos mjaft të madhe që ka kjo reformë strukturore, si dhe bazuar në modelet ndërkombëtare, jemi të mendimit që zgjidhja më e përshtatshme për Shqipërinë do të jete “modeli gradual”, sipas të cilit kontribuuesit aktualë në skemat e pensionit do të ndajnë vlerën e kontributit pjesërisht në Kolonën I (ISSH) dhe pjesërisht në Kolonat e Dytë që do të krijohen. Kështu do të mundësohet një kalim gradual i brezave nga një skemë pensioni problematike e deficitare (Kolona I), drejt një skeme efikase dhe operacionale (Kolona II), ndërkohë që Kolona III do të vijojë të jetë vullnetare pasi edhe qëllimi i saj është suplementar, për të mundësuar një të ardhur shtesë për ata që kanë një nivel të mjaftueshëm të ardhurash.

Reforma e pensioneve është një reformë strukturore mjaft e rëndësishme dhe ka një kosto financiare të jashtëzakonshme, të shtrirë në breza, duke tejkaluar kufijtë kohorë të 3-4 mandateve politike të një Qeverie. Për këtë arsye, aprovimi i kësaj reforme duhet të ketë një angazhim të fortë politik të të gjithë kaheve për të mirën e vendit.

Në angazhohemi që përgjatë mandatit të parë qeverisës të studiojmë profesionalisht, së bashku me Bankën Botërore dhe ekspertët ndërkombëtarë të gjithë modelet e mundshme dhe të përlllogarisim kostot e kësaj reforme, me qëllim që mandatin e dytë të fillojë zbatimi i menjëhershëm i saj duke i dhënë një zgjidhje përfundimtare problemit të skemave të pensioneve në vend në përputhje plotë me standardet me të mira ndërkombëtare bashkëkohore.



Konsolidimi dhe Liberalizimi i Skemës së Sigurimeve Shëndetësore

Edhe skema e sigurimeve shëndetësore është një skemë jo shumë efikase, duke pasur nga njëra anë shpenzime të konsiderueshme për rimbursimin e skemës së barnave, dhe nga ana tjetër një përfitim të prekshëm mjaft të papërfillshëm tek qytetarët e moshave të reja e të mesme. Kjo pandjeshmëri dekuron kontribuuesit për t'u përfshirë dhe kontribuar në skemë duke e bërë këtë të fundit jo-efikase dhe të paqëndrueshme financiarisht.

Mungesa e perceptimit të përfitimeve reale që sjell kjo skemë sipas standardeve ndërkombëtare, vjen për shkak të mos liberalizimit të përdorimit të shërbimeve. Kontribuuesit në skemën e sigurimeve shëndetësore mund të përfitojnë vetëm në sistemin shëndetësor shtetëror, ndërkohë që është e pamundur që qytetarët të cilët zgjedhin të marrin shërbim nga sistemi jo-publik (privat) të përfitojnë nga kontributet e skemës së sigurimeve shëndetësore.

Për këtë arsye lind nevoja për një reformim radikal të skemës së sigurimeve shëndetësore sipas praktikave më të mira ndërkombëtare nëpërmjet liberalizimit të përdorimit të kontributeve duke i dhënë mundësinë përfituesve që t'i përdorin këto përfitime si në skemën e shëndetësisë publike ashtu edhe atë private. Liberalizimi i përdorimit të këtyre shërbimeve do kishte një shpërndarje më të drejtë dhe efikase të përdorimit të këtyre fondeve për çdo kontribuues duke zhdukur deformimin aktual, si dhe do të shtynte operatorët e shërbimit shëndetësor të përmirësonin cilësinë dhe të tërhiqnin sa më shumë fonde. Kjo reformë do të kërkonte edhe një rishikim të nivelit të kontributeve në përputhje me nivelin e të ardhurave dhe moshën e kontribuuesit.

Ashtu si reforma në pensione edhe kjo strukturë duhet të analizohet me mbështetjen e donatoreve serioze që kanë ekspertizën e plotë ndërkombëtare për reforma të tilla, bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare. Reforma për liberalizimin e skemës së sigurimeve shëndetësore do të shkojë paralel me reformën e skemave të pensioneve, me synimin për të qenë gati për ta zbatuar në mandatin e dytë qeverisës.

4. Pavarësia e Bankës Qendrore dhe mbajtja nën kontroll të inflacionit dhe tregut valutor

Pavarësia e bankës qendrore është themelore për të siguruar që politika monetare mos të përdoret për qëllime politike afatshkurtra, por për të ruajtur stabilitetin afatgjatë ekonomik. Stabiliteti monetar është i rëndësishëm për konservatorët, të cilët e konsiderojnë inflacionin një formë të fshehur të taksimit që dëmton fuqinë blerëse të qytetarëve. Në vend që qeveria të rrisë shpenzimet publike në mënyrë agresive gjatë krizave ekonomike, siç ka ndodhur në 4 vjeçarët e fundit, doktrina konservatore sugjeron që të përdoren stimuj të kufizuar fiskalë për të ndihmuar rimëkëmbjen, ndërkohë që ruhet stabiliteti i çmimeve përmes politikave monetare të kujdesshme.

Politikat monetare dhe fiskale duhet të koordinohen në mënyrë të tillë që të shmangjet mbështetja e tepruar në masat stimuluese afatshkurtra dhe të fokusohet në krijimin e një mjedisi që nxit rritjen e qëndrueshme dhe konkurrencën afatgjatë. Disa nga masat që ne propozojmë janë:

- Sigurimi de facto i pavarësisë së bankës qendrore për të ndjekur një politikë monetare të orientuar nga ruajtja e stabilitetit të çmimeve dhe inflacionit të ulët, pa ndërhyrje nga politikat fiskale të qeverisë. PD garanton shmangien e çdo lloji ndikimi direkt apo indirekt nga ana e qeverisë që mund të rezultojë në politika monetare që përdoren për qëllime afatshkurtra politike, duke ruajtur besimin e tregjeve dhe stabilitetin e monedhës.
- Koordinimi midis politikës monetare dhe fiskale do të synojë shmangien e masave stimuluese të papërbalueshme që krijojnë presion mbi çmimet, si dhe shmangien e fenomenit të vënë re vitet e fundit, ku rritja ekonomike krijohet përmes inflacionit të lartë, duke renduar direkt në buxhetet e familjeve dhe bizneseve.



- Sigurimi që politikat fiskale dhe monetare të jenë të kontrolluara dhe transparente, duke rritur besimin në qeverisje dhe duke siguruar përfitime afatgjata për qytetarët.
- Vendosja e mekanizmave për llogaridhënie dhe transparencë më të madhe në menaxhimin e financave publike, për të siguruar që qeveria dhe institucionet monetare të veprojnë në interesin më të mirë të qytetarëve dhe të tregjeve.
- Balancimi i politikave afatshkurtra me objektivat afatgjata të zhvillimit dhe stabilitetit makroekonomik, për të shmangur ciklet e krizave të nxitura nga masa të përkohshme ekonomike.

Parimi 5: Shndërrimi i Ekonomisë Shqiptare në Prodhuese dhe Eksportuese – Industrializimi, Prodhimtaria dhe Sovraniteti Ekonomik:

1. Ndryshimi i modelit ekonomik:

- PD propozon një ndryshim të modelit ekonomik të vendit, dhe një fokus drejt prodhimit për të transformuar Shqipërinë në një prodhues dhe eksportues të produkteve vendore, me cilësi të pranueshme për tregun vendas dhe European.
- Industrializimi, nëpërmjet fabrikave, agrobiznesit, teknologjisë së re, për të mos ngelur thjesht te fazat e para të prodhimit, por dhe të përpunimit të atyre që ekonomia jonë prodhon, është i domosdoshëm për të vendosur një disiplinim dhe një kulturë të tregut, norma të punës, respektit, meritokracisë dhe konkurrueshmërisë në shoqëri.

2. Mbështetja për Sektorët Kyçe:

- PD identifikon bujqësinë, agro-industrinë, turizmin, energjinë, shërbimet në fushën e teknologjisë dhe informacionit si sektorët kyçe për zhvillimin ekonomik, duke theksuar nevojën për politika të qëndrueshme dhe avantazhe konkurruese në krahasim me tregjet e tjera. Koordinimi i këtyre sektorëve prioritarë me njeri-tjetrin krijon efektin e shumëfishimit të efekteve pozitive duke rritur vlerën e shtuar në ekonominë e vendit (për shembull bujqësia dhe agro-industria mund t'i shërbejnë mjaft mirë turizmit, duke reduktuar varësinë nga importi për ushqime dhe mallra konsumi).
- Politikat e PD duhet të mbështesin modernizimin dhe zgjerimin e këtyre sektorëve, duke përfshirë investime në infrastrukturë, teknologji, dhe kapital njerëzor.

Për një detajim të këtij seksioni, ju lutem referojuni seksionit të programit të Partisë Demokratike për Industrializimin, Bujqësinë dhe Turizmin.

F. Parimi 6: Një ekonomi e fortë ka nevojë për tregje financiare të qëndrueshme – Zhvillimi i Tregut Financiar, Aksesit në Financa dhe Përfshirja Financiare:

1. Edukimi dhe Përfshirja Financiare:

- PD synon të promovojë edukimin dhe përfshirjen financiare për të lejuar individët dhe bizneset të kenë qasje në produkte dhe shërbime financiare në mënyrë të përgjegjshme.
- Ne besojmë se rritja e njohurive financiare e fuqizon individin për të marrë vendime të informuara për kursimin, investimin dhe menaxhimin e financave të tyre.

2. Zhvillimi i Tregut:

- PD propozon zhvillimin e tregjeve financiare, duke përfshirë financimin e grupit (crowdfunding) dhe krijimin e një bursë aksionesh, për të lehtësuar qasjen në kapital për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Politikat e PD do duhet që të promovojnë sipërmarrjen, inovacionin, dhe investimet, duke krijuar një ekosistem të përshtatshëm për rritje ekonomike dhe zhvillim.

Ndaj, ne mendojmë se zhvillimi i tregut financiar duhet të mbështetet në dy shtylla kryesore:



- Konsolidim të sektorit bankar dhe shërbimeve financiare të kreditimit
- Mbështetje të fuqishme për zhvillimin e tregut të kapitaleve në të gjitha hallkat e zhvillimit të financimit të kapitalit si engjëjt e biznesit, startupet, venture capital, private equity, skemat e investimeve alternative e deri tek zhvillimi i shpejtë i bursës së aksioneve.

Shqipëria është një ndër vendet me njohuritë më të ulëta financiare në Europë. Gjithashtu, nuk jemi një vend me një të kaluar të pasur financiare. Gati gjysmë shekulli në një regjim të egër komunist zhdukën çdo mundësi për një zhvillim financiar në vend, pasi nuk ekzistonte asnjë liri, përveç jetesës në një burg të madh.

Nga ana tjetër, duhet të jemi të vetëdijshëm, që ndryshe nga vende të tjera të lindjes nën regjimin diktatorial, të cilat e kishin një zhvillim financiar sado të vogël para pushtimit komunist, në Shqipëri nuk kanë qenë asnjëherë rrethanat për përfshirje apo tregje financiare. Shqipërisë i është dashur përherë gjatë shekujve të luftonte për mbijetesë. Kjo e kaluar shekullore nën kërcënim nga fqinjët, dhe rreth pesë dekada nën një sundim terrorist kanë pamundësuar fokusin në zhvillimin financiar të vendit. Në Indeksin e Zhvillimit Financiar vendi ynë qëndron ndër vendet e fundit, pasi ka vetëm sektorin bankar dhe deri diku dhe sektorin e sigurimeve.

Natyrisht, njëfarë stepje ekziston në shoqërinë shqiptare dhe për shkak të ngjarjeve të vitit 1997, me krizën e piramidave. Gjithsesi, ne besojmë se edukimi financiar, përfshirja financiare dhe zhvillimi i këtyre tregjeve duhet të ecin së bashku në mënyrë të pazgjidhshme.

Përfshirje financiare nënkupton që individët, familjet dhe bizneset shqiptare të kenë mundësi të përdorin produkte dhe shërbime financiare të dobishme dhe të përballueshme për plotësimin e nevojave të tyre, në mënyrë të përgjegjshme, të qëndrueshme dhe me njohuritë e duhura.

Mësimi i individëve me mekanizmat dhe mjetet financiare që përdoren në botën perëndimore dhe që kanë ndikuar në rritjen e mirëqenies së atyre kombeve, lehtëson jetën e përditshme dhe ndihmon familjet dhe bizneset të planifikojnë për gjithçka, nga qëllimet afatgjata deri te urgjencat e papritura. Kjo nuk përfshin vetëm zhvillimin e sektorit bankar, por edhe atë të aksioneve, të sigurimeve dhe të derivateve financiarë.

Ne jemi të vetëdijshëm se Shqipëria tashmë ka një sektor të maturuar financiar si në indikatorët kryesore që kanë të bëjnë me kapitalin, asetet, financimin e ekonomisë, nivelin e shërbimeve financiare për banor etj. Megjithatë, sektori financiar në Shqipëri ka një zhvillim jo të njëtrajtshëm, me një sektor bankar dominues dhe relativisht të mirë zhvilluar, sipas standardeve ndërkombëtare i cili karakterizohet nga një nivel mjaft i lartë likuiditeti dhe depozitash (mbi 15 miliardë euro depozita me afat në vitin 2023), me një sistem të pagesave bashkëkohor i cili po zhvillohet me shpejtësi dhe me një trend rritës.

Në anën tjetër, kemi një treg kapitalesh në nivele krejt modeste, i cili ka institucione aktive por që administrojnë nivele relativisht të vogla fondesh pensioni dhe investimesh. Bursa Shqiptare është funksionale operacionalisht sipas praktikave me të mira ndërkombëtare, por jashtë mase jo-likuide dhe ende pa përfshirjen e biznesit që të rrisë kapital nëpërmjet emetimit të titujve.

Një tjetër element që i mungon tregut të kapitaleve janë skemat e financimit privat të cilat mundësojnë financimin e startupeve në fazën fillestare apo kompanive në rritje (kryesisht Ndërmarrje të Vogla e të Mesme) në formën e financimit të kapitalit (private-equity) apo financimit me risk (venture capital).

Duke vlerësuar ecurinë dhe zhvillimin jo të njëtrajtshëm të sistemit financiar në vend, ne besojmë se **duhet gjetur rruga e duhur për çlirimin e potencialit të kapitaleve të fjetura ekzistuese në tregun bankar dhe jashtë sistemit dhe orientimin e tij drejt tregut të kapitaleve dhe financimit të biznesit duke rritur efikasitetin e financimit të sipërmarrjes private.**

Duke u nisur nga kjo qasje, ne synojmë të nxisim zhvillimin e tregut të kapitaleve nëpërmjet nxitjes së investimit kolektiv në tregun e financimit të biznesit privat. Në këtë format synohet nxitja e zhvillimit të



Bursës Shqiptare duke incentivuar fiskalisht dhe ligjërisht bizneset shqiptare që ta shikojnë si një dritare për rritjen e kapitalit. Kjo do të nxiste gjenerimin e fondeve të mjaftueshme për financimin me sasi të konsiderueshme dhe ritme të shpejta të biznesit vendas duke ndikuar pozitivisht edhe në rritjen e transparencës fiskale dhe reduktimin e informalitetit në ekonominë shqiptare.

Në këtë skenar ne do të përfshijmë edhe procesin e privatizimit të paketave të vogla (deri në 30%) të aksioneve apo listimin e obligacioneve korporative të Ndërmarrjeve Shtetërore, duke dhënë jo vetëm shembullin e parë për sipërmarrjet private, por edhe duke nxitur zhvillimin e transparencës financiare në ndërmarrjet publike. Zhvillimi i bursës do t'u jepte mundësinë e gjenerimit të normave relativisht më të larta të kthimit për kursimet e fjetura si dhe do krijonte shume mundësi për investitorët individuale apo ata institucionale (skema pensionesh dhe investimesh) që të diversifikonin fondet e tyre dhe administruar me mirë rrezikun me norma më të larta kthimi.

Një tjetër element që duhet nxitur me tej është ajo pjesë e tregut të kapitaleve që u jep mundësi financimi të ndryshme nga huamarrja NMV-ve ose siç njihen ndryshe Investime Alternative. Alokimi i fondeve të fjetura në drejtim të tregut të kapitaleve në formën e financimeve kolektive në vlera të vogla (crowdfunding), apo në mekanizma më me risk si private-equity apo venture-capital, do t'u japë mundësinë bizneseve të vogla e të mesme në vend të rriten me shpejtësi të lartë e të përgatiten për kuotime të mëtejshme në Bursën Shqiptare.

Studimet e ndryshme të ekspertëve financiarë dhe ekonomikë, si dhe vetë historia e pesëdhjetë viteve të fundit në shoqëritë Perëndimore, tregojnë se zhvillimi i përfshirjes financiare, dhe krijimi i një sistemi financiar të plotë dhe të qëndrueshëm inkurajojnë investimin dhe kursimin, flukset e kapitalit të huaj në formën e IHD-ve, rrisin transparencën e kompanive, përmirësojnë likuiditetin e tyre, ndihmojnë konkurrencën e drejtë, rrisin besimin në ekonominë dhe sistemin financiar të një vendi si nga të huajt dhe nga qytetarët.

Për ne si mbështetës të ekonomisë së tregut është i nevojshëm krijimi i një plani afatmesëm dhe afatgjatë në lidhje me zhvillimin e tregut të kapitalit dhe të sigurimeve. Më pas, këto tregje duhet të forcohen dhe stabilizohen, dhe të pasohen me zhvillimin e të tjerë tregjeve më komplekse. Në mënyrë paralele, duhet të vijohet me forcimin, qëndrueshmërinë, transparencën dhe konkurrueshmërinë e sektorit bankar si dhe me liberalizimin e shpejtë të pagesave elektronike e digjitale dhe i dhënë një prioritet shumë të madh procesit të bankut të hapur (open-banking).

Revolucionarizimi dhe liberalizimi i shërbimeve të pagesave digjitale do ketë një efekt bumerang shumë pozitiv në ekonominë e vendit pasi ul kostot e tregtisë online duke rritur me tej potencialet e zhvillimit sidomos të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme (NMV) të cilat konsiderohen edhe si shtylla kurrizore e çdo ekonomie.

Ekonomia e tregut nuk do të jetë asnjëherë e plotë nëse nuk zhvillojmë një sistem financiar të plotë, të fortë, të sigurt dhe të qëndrueshëm, duke zhvilluar edukimin financiar dhe duke rritur përfshirjen në tregje të qytetarëve shqiptarë.



3. Sovraniteti ekonomik dhe Industrializimi: Bujqësia, Turizmi dhe Energjia si bazat tona të ekonomisë

Ekonomia shqiptare duhet të ndryshojë patjetër model, nga thjesht një importuese neto, konsumatore dhe e shërbimeve, në prodhuese dhe eksportuese të prodhimeve vendase. Kjo kryhet fillimisht nëpërmjet industrializimit të vendit (industrisë përpunuese), i cili është një prej aspekteve kryesore që rregullon hierarkinë dhe rendin shoqëror të një vendi, duke vendosur në shoqëri disa norma të punës, respektit, meritokracisë dhe konkurrueshmërisë. Të gjithë vendet perëndimore kanë udhëtuar drejt zhvillimit të tyre nëpërmjet dy proceseve të pazgjidhshme me njëri tjetrin: demokratizim dhe industrializim. Shqipëria fatkeqësisht ka bërë hapa prapa në të dy proceset, përgjatë dhjetëvjeçarit të fundit.

Në funksion të kësaj, ne shikojmë në sektorin e bujqësisë, industrisë e turizmit dhe energjisë pika të forta të ekonomisë shqiptare, të mbështetura nga tradita, njohuritë dhe aftësitë tona në dhjetëvjeçarë e shekuj, burimet natyrore dhe njerëzore dhe përparësia konkurruese e mundshme me vendet e rajonit. Prodhimi kombëtar po përjeton çaste kritike në Shqipëri për shkak të një politike shpopullimi, korrupsioni masiv, ndërhyrjeje qeveritare, konkurrence të pandershme dhe moszbatimit të ligjit. Qeveria socialiste mbështet vazhdimisht nisma të ndryshme strategjike, që synojnë t'i mbysin prodhuesit tanë me burokraci dhe politika rregullatore të papërballueshme, të cilat përfundojnë duke shkatërruar detin, fshatin dhe industrinë tonë.

Bujqësia nuk shihet si një industri e mirëfilltë dhe motor zhvillimi. Ne mendojmë se një përjasje e re ndaj fermave bujqësore dhe blegtorale, si ndërmarrje të vërteta rurale, një zhvillim i industrisë së agro-përpunimit, agroturizmit, përdorimi i teknologjive të kohës që sjell prodhimin me kosto të ulët dhe përballjen me konkurrentët në rajon, qëndrojnë në themel të zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë rurale.

Patjetër që ulja e kostove dhe rritja e mbështetjeve për zhvillimin e sektorit bujqësor do të rrisë konkurrueshmërinë e produktit prodhimit vendas në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Në vijim të këtij procesi, ne mendojmë se është thelbësore që prodhimet e huaja t'i nënshtrohen të njëjtave rregulla, detyrime dhe standarde që kompanitë dhe prodhimet shqiptare duhet të kenë.

Gjithashtu, Shqipëria duhet të mbrojë interesat e saj kombëtare në kuadër të sovranitetit të saj energjetik. Me burimet natyrore të vendit tonë, kjo arrihet nëpërmjet një energjie të lirë, të qëndrueshme, efikase dhe të pastër, që siguron çmime të përballueshme për familjet dhe sipërmarrjet shqiptare. Shqipëria i ka të tëra mundësitë për të realizuar diçka të tillë për sa i përket burimeve natyrore dhe duke shmangur keqpërdorimin e ndërmarrjeve publike të energjisë dhe me burime hidrike të mjaftueshme, Shqipëria mund të bëhet e pavarur nga ana energjike. Furnizimi me energji i të gjithë shqiptarëve nuk ka përse të varet nga krizat dhe/apo lëkundjet e çmimeve të vendeve të tjera.

Konkurrenca e lirë, heqja e taksave të shumta mbi energjinë dhe liberalizimi i sektorit çojnë në ulje të çmimit të energjisë për familjet shqiptare.

Padyshim, nxitja e turizmit në Shqipëri, për shkak të pasurive të ndryshme natyrore, si në pak vende të tjera, të vijës bregdetare dhe të kapitalit njerëzor është përparësi e jona për të ndikuar në zhvillimin e avantazhit konkurrues të Shqipërisë, jo vetëm në rajon, por duke menduar dhe për integrimin në Bashkimin Europian. Ne do të duhet të kemi sektorët tanë strategjikë për t'ia ofruar një bashkësi vendesh që fillimisht ka lindur si bashkim ekonomik.

Gjithashtu, turizmi duhet parë si një industri e rëndësishme dhe një krijues i konsiderueshëm i vendeve të punës përgjatë gjithë vitit, nëpërmjet afrimit të kapitalit vendas dhe të huaj, duke ruajtur pasuritë tona natyrore, duke forcuar turizmin rural, malor, detar, kulturor dhe historik, si dhe duke ndihmuar në ruajtjen dhe përhapjen e trashëgimisë sonë natyrore dhe artistike, sipas frymës konservatore të mbrojtjes së pasurive kombëtare.

Propozimet konkrete për bujqësinë:



1. Ndihmë e Drejtpërdrejtë dhe të Drejta për Fermerët

- a. Dyfishimi i fondeve për mbështetje të drejtpërdrejtë për fermerët, duke përfshirë inputet bujqësore (farëra, fidanë, kafshë race) dhe teknologjitë moderne, të lidhura me një strategji të mirëpërcaktuar të zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë, dhe industrisë përpunuese.
- b. Eliminimi i burokracisë: Procedura të thjeshtuara burokratike për fermerët, duke eliminuar korrupsionin dhe klientelizmin. Financim direkt në bazë të prodhimit të dokumentuar.

2. Zhvillimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Mekanizimit

- a. Rritja e kapacitetit ujëtës: Investime për rehabilitimin dhe modernizimin e rrjetit të kanaleve të ujitjes dhe kullimit, duke sjellë nën ujë të gjithë sipërfaqet e tokës së kultivueshme brenda mandatit.
- b. Ulje të kostove për blerjen e pajisjeve moderne bujqësore përmes granteve dhe kredi të buta pa interes.

3. Bashkëpunim mes Fermave dhe Marketingu

- a. Promovimi i bashkëpunimit mes fermerëve: Stimulimi i krijimit të bashkëpunimeve mes fermave të ndryshme që mundësojnë uljen e kostove dhe sigurimin e kontratave me tregtarët dhe eksportuesit.
- b. Marketingu i prodhimeve shqiptare: Krijimi i një agjencie kombëtare për marketingun e produkteve bujqësore vendase, me fokus në markën “Made in Albania” dhe eksportet. Përmirësimi i lidhjeve me tregjet e huaja dhe promovimi i produkteve shqiptare në Evropë.

4. Fokus në Prodhime Organike dhe Cilësore

- a. Politika për produkte cilësore dhe organike: Promovimi i prodhimit organik dhe mbështetje për fermerët që orientohen drejt standardeve evropiane, duke përmirësuar kështu mundësitë për eksport.
- b. Certifikime për eksport: Rritje e kapaciteteve të certifikimit për produkte që plotësojnë standardet ndërkombëtare, duke siguruar qasje në tregjet evropiane.

5. Incentivat për Agroturizëm dhe Zhvillimin Rural

- a. Mbështetje për agroturizëm: Grante dhe kredi të buta për krijimin e bizneseve në fushën e agroturizmit, artizanatit dhe përpunimit të produkteve lokale, duke krijuar vende pune dhe përmirësuar të ardhurat në zonat rurale.
- b. Infrastrukturë e mirë për zonat rurale: Investime në rrugë, ujësjellës dhe infrastrukturë energjetike për të përmirësuar jetesën dhe produktivitetin në fshat.

6. Reformimi i Skemave të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare

- a. Siguria ushqimore: Përmirësimi i standardeve të sigurisë ushqimore, duke garantuar mbrojtjen e konsumatorit dhe rritjen e besimit në produktet shqiptare.
- b. Shërbime veterinarie të zhvilluara: Mbështetje për modernizimin e shërbimeve veterinarie dhe fitosanitare, duke i integruar me standardet evropiane.

7. TVSH e drejtë: Rregullim i skemës së TVSH-së për bujqësinë për të barazuar nivelin e TVSH në shitje dhe blerje.

Propozime konkrete për turizmin:

1. Zhvillimi i Infrastrukturës dhe Lehtësimi i Aksesit

- Investime në infrastrukturë: Përmirësimi i rrugëve dhe infrastrukturës energjetike në zonat turistike, veçanërisht ato rurale dhe bregdetare, duke siguruar akses të lehtë dhe të sigurt për



vizitorët. Shqipëria ka treguar në vitet e fundit që, me rritjen e numrit të turistëve, nuk i ka kapacitetet e shërbimit dhe infrastrukture, duke bërë që turistët që vijnë të mos rikthehen.

- Përmirësimi i transportit urban dhe ndërrurban të cilin sot vendi nuk e ka në nivelin që do të duhej.
- Zhvillimi i porteve turistike dhe aeroporteve: Modernizimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të porteve turistike dhe aeroporteve lokale për të përballuar rritjen e numrit të turistëve ndërkombëtarë.

2. Politikat Fiskale dhe Mbështetja për Sipërmarrjet Lokale

- Barazi nga ana fiskale për sipërmarrjet në këtë sektor, duke hequr çdo favorizim klientelist, dhe duke siguruar konkurrencë të drejtë dhe të ndershme.
- Lehtësime për start-up-et në turizëm: Mbështetje për ndërmarrjet e reja që ofrojnë shërbime turistike, duke ofruar grante dhe kredi me kushte të buta për zhvillimin e aktiviteteve të reja në zonat e pazhvilluara.
- Formalizim i të gjithë hallkave të furnizimit dhe shërbimeve për aktorët që operojnë në sektorin e turizmit.
- Rishikim i të gjithë strukturës ligjore të bërë për të favorizuar klientët e qeverisë, dhe për kriteret e zbatuara për investitorët strategjikë.

3. Promovimi i Turizmit Rural dhe Agroturizmit

- Mbështetje për agroturizmin: Grante dhe kredi të buta për të inkurajuar krijimin e fermave agroturistike që integrojnë turizmin me prodhimin lokal të ushqimeve organike, artizanatit dhe aktiviteteve tradicionale.

4. Ruajtja dhe Promovimi i Trashëgimisë Kulturore

- Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë kulturore: Investime në restaurimin e objekteve historike dhe kulturore, duke krijuar itinerare turistike të fokusuara në historinë dhe kulturën shqiptare.
- Festalet kulturore dhe ngjarjet tradicionale: Grante për organizimin e festivaleve që promovojnë trashëgiminë dhe traditat vendase, duke tërhequr turistë të huaj dhe vendas.
- Zhvillimi i muzeve dhe qendrave kulturore: Ndërtimi dhe modernizimi i muzeve të rinj dhe qendrave kulturore në qytete dhe fshatra me potencial turistik.

5. Promovimi Ndërkombëtar dhe Marketingu i Qëndrueshëm

- Strategji marketingu ndërkombëtar: Krijimi i një agjencie për marketingun ndërkombëtar të turizmit shqiptar, duke u fokusuar në promovimin e destinacioneve që ofrojnë përvoja të qëndrueshme dhe autentike.
- Rritja e vizibilitetit online: Iniciativa për zhvillimin e platformave digjitale që promovojnë destinacionet shqiptare dhe u ofrojnë turistëve informacione të detajuara dhe mundësi rezervimi për akomodim dhe aktivitete.
- Krijimi i markave kombëtare: Markat “Made in Albania” për produktet dhe shërbimet turistike, duke kombinuar cilësinë e shërbimit me promovimin e identitetit kombëtar.

6. Standardizimi i Shërbimeve

- Certifikimi i cilësisë së shërbimeve turistike: Vendosja e standardeve dhe certifikimeve të detyrueshme për hotelet dhe restorantet për të garantuar cilësinë dhe sigurinë në shërbim.
- Trajnimi i forcës së punës në turizëm: Programet e trajnimit për punonjësit e turizmit, duke ofruar certifikime profesionale për të përmirësuar shërbimet dhe për të ngritur nivelin e profesionalizmit në sektor.

7. Politikat e Qëndrueshme Mjedisore

- Ruajtja e zonave natyrore: Krijimi i planeve afatgjata për mbrojtjen e zonave të mbrojtura dhe pyjeve, duke siguruar që zhvillimi turistik të mos dëmtojë mjedisin dhe biodiversitetin.
- Turizmi detar dhe ruajtja e bregdetit: Program për mbrojtjen e bregdetit shqiptar nga ndotja dhe erozioni, si dhe nga ndërtimet pa kriter që dëmtojnë bregdetin apo malet shqiptare.

8. Turizmi i Specializuar dhe Sezonal



- Zhvillimi i turizmit sportiv dhe të aventurës: Mbështetje për ndërtimin e infrastrukturës për aktivitete sportive, si alpinizëm, rafting, dhe sporte ujore, duke diversifikuar ofertën turistike.
- Turizmi shëndetësor dhe wellness: Krijimi i resorteve të specializuara për wellness dhe turizëm shëndetësor, duke promovuar Shqipërinë si destinacion për pushime të shëndetshme dhe trajtime alternative.

Propozimet konkrete për Energjinë

Qëllimi i propozimeve për energjinë është krijimi i një Shqipërie të pavarur energjetikisht, me kosto të ulët dhe të pastër

1. Diversifikimi i Burimeve të Energjisë

Inkurajimi i investimeve në energjinë diellore dhe të erës: Lehtësira fiskale për ndërtimin e paneleve diellore dhe parqeve eolike në të gjithë vendin. Krijimi i një programi kombëtar për tërheqjen e investimeve private dhe të huaja në këto sektorë.

Krijimi i kuadrit ligjor për energjinë e rinovueshme: Modernizimi i ligjeve dhe rregullave për të nxitur më shumë investime në energjinë e rinovueshme, duke siguruar garanci për investitorët dhe procedura të shpejta të licencimit.

2. Liberalizimi i Tregut të Energjisë për Uljen e Çmimeve

Liberalizimi i tregut të energjisë: Hapja e tregut për konkurrencë më të madhe mes prodhuesve dhe furnizuesve të energjisë, duke siguruar çmime më të ulëta për konsumatorët dhe duke larguar monopolin shtetëror.

Incentiva për përdorimin e energjisë së pastër: Përfitime fiskale për familjet dhe bizneset që instalojnë panele diellore ose përdorin energji të gjelbër, duke ulur varësinë nga rrjeti dhe duke krijuar një bazë të gjerë të konsumatorëve energjikisht të pavarur.

3. Zhvillimi i Infrastrukturës për Ruajtjen e Energjisë

Investime në teknologji për ruajtjen e energjisë: Subvencione për ndërtimin e impianteve të ruajtjes së energjisë, veçanërisht për energjinë diellore dhe të erës, për të garantuar furnizim të vazhdueshëm edhe gjatë periudhave pa diell ose erë.

Krijimi i rrjeteve të mençura (smart grids): Investime në infrastrukturën e rrjeteve të mençura për të optimizuar përdorimin e energjisë dhe për të balancuar furnizimin dhe kërkesën në mënyrë efikase.

4. Politika për Uljen e Kostove të Energjisë për Konsumatorët

Grante për energjinë diellore në banesa: Program kombëtar për instalimin e paneleve diellore në banesa, duke synuar të mbështesë familjet me të ardhura të ulëta për të prodhuar vetë energjinë e tyre dhe për të ulur faturat mujore.

Rishikimi i tarifave energjetike: Zbatimi i një reforme tarifore për të ulur çmimet për konsumatorët e zakonshëm dhe bizneset e vogla, duke siguruar një tarifë më të drejtë dhe të arsyeshme për energjinë.

5. Zhvillimi i Infrastrukturës për Energjitë e Ripërtëritshme

Investime në rrjetet e shpërndarjes së energjisë: Modernizimi i rrjetit kombëtar të shpërndarjes për të integruar më mirë energjinë e erës dhe diellit, duke ndërtuar kapacitete të reja dhe përmirësuar eficiencën.

6. Zhvillimi i Energjisë Hidrogjenike dhe Inovacionet e Reja



Fokus në teknologjinë e hidrogjenit: Zhvillimi i impianteve pilot për prodhimin e energjisë nga hidrogjeni, me synimin për të diversifikuar burimet dhe për të qenë një nga vendet e para në rajon që investon në këtë burim të pastër energjie.

Incentivat për kërkim dhe zhvillim në teknologjitë e gjelbra: Mbështetje për start-up-et dhe projektet kërkimore që angazhohen në teknologjitë inovative të energjisë së pastër, duke krijuar mundësi për zbulime të reja që do të forcojnë pavarësinë energjetike të Shqipërisë.

7. Ruajtja dhe Zgjerimi i Burimeve Hidroenergjetike

Menaxhimi efikas i hidrocentraleve: Modernizimi i hidrocentraleve ekzistuese dhe garantimi i mirëmbajtjes së tyre, duke përmirësuar eficiencën dhe minimizuar humbjet në rrjet.

Zhvillimi i projekteve të reja hidroenergjetike të qëndrueshme: Vlerësimi i mundësive për ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël, që kanë ndikim të ulët në mjedis, për të plotësuar kërkesat vendase.

8. Përmirësimi i Eficiencës Energjetike në Ndërtesa dhe Industri

Program kombëtar për eficiencën energjetike: Krijimi i një programi për përmirësimin e eficiencës energjetike në ndërtesat publike dhe private, për rinovimin dhe izolimin e ndërtesave për të ulur konsumimin e energjisë.

Kursimi i energjisë në industri: Lehtësi fiskale për industritë që adoptojnë teknologji të reja për eficiencën energjetike, duke stimuluar rritjen e produktivitetit dhe uljen e kostove.

9. Përfshirja e Komuniteteve Lokale në Zhvillimin e Energjive të Reja

Fuqizimi i komuniteteve për të prodhuar energji të pastër: Mbështetje për komunitetet lokale që duan të ndërtojnë projekte të vogla energjie diellore ose të erës për përdorim lokal, duke i ndihmuar ata të bëhen energjetikisht të pavarur.

Fokus në zonat rurale: Inkurajimi i projekteve energjetike që përfshijnë bujqësinë dhe turizmin rural, duke integruar energjitë e rinovueshme me zhvillimin ekonomik lokal.

4. Siguria, Antikorrupsioni dhe Lufta Kundër Krimit të Organizuar

Hyrje

Gjatë gjithë historisë së saj, momentet më të vështira të Shqipërisë dhe shqiptarëve kanë qenë kohët ku ka dominuar pasiguria dhe luftërat. Paqja dhe siguria në një kontekst afatgjatë për shqiptarët është çështje e sigurisë dhe ekzistencës kombëtare dhe interesave të tyre. Duke qenë se shqiptarët ndodhen në 5 shtetet ballkanike, shtrirja konceptuale e sigurisë merr një dimension Ballkanik, gjë e cila e bën më komplekse dhe të domosdoshme pasjen e një qasjeje rajonale, dhe kjo vetëm.

Për shqiptarët një Ballkan i sigurtë është një Europë e sigurtë, dhe mandej është një botë e sigurtë.

Siguria rajonale varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Shqipëria dhe faktori shqiptar. Partia Demokratike ka qenë një faktor stabilizues sa i përket rajonit e jo vetëm, duke u mbështetur gjithmonë në mjetet diplomatike publike dhe në marrëdhëniet e vazhdueshme e të patundura me partnerët tanë strategjikë, në identitetin kombëtar e harmoninë fetare, duke kundërshtuar me çdo mjet ligjor influencat keqdashëse që kërkojnë



destabilizimin rajonal e kështu do vazhdojë të jetë. Integrimi në Aleancën Atlantike të Veriut, përveçse një moment historik për popullin shqiptar dhe në veçanti triumf i qeverisjes sonë, ngelet dhe përgjegjshmëri e madhe nga e cila lindin dhe detyrimet

Ne jemi të angazhuar të vazhdojmë bashkëpunimin në misionet e mbrojtjes kolektive dhe ato paqeruajtëse së bashku me aleatët e tjerë, rritjen e fokusimit në fushën dhe industrinë e mbrojtjes dhe diversifikimin me qëllim rritjen e efikasitetit në përballjen e sfidave aktuale të sigurisë.

Krimi kibernetik dhe shfrytëzimi i lëvizjeve migratore si armë demografike nga ana e shteteve jo dashamirëse, për shkak të ndikimit gjithëpërfshirës ndaj një hapësire të madhe dhe numri të lartë të shoqërive, na dikton të kemi një qasje minimalisht rajonale në përballjen me këto rreziqe.

Rritja e bashkëpunimit në parandalimin e krimeve ndërkombëtare, terrorizmit, sulmeve kibernetike dhe migracionit të paligjshëm janë përparësi për filozofinë tonë politike në shërbim të interesit më të lartë kombëtar: sovranitetit. Ne, ndryshe nga të majtët, besojmë se siguria energjetike e një shteti duhet të jetë pasqyrim i objektivave strategjike dhe i parimeve themelore të politikës së jashtme, duke qenë të hapur pro çdo bashkëpunimi që bazohet në interesat më të larta të kombit.

Vendosja në hartën ndërkombëtare e vendit tonë për sa i përket drogës dhe trafikeve të paligjshme, krimit të organizuar dhe terrorizmit, përbëjnë një shqetësim të madh për shqiptarët, aleatët tanë strategjike dhe ne demokratët në veçanti, për shkak se gjatë qeverisjes të së djathtës, Shqipëria doli nga listat dhe hartat famëkeqe të trafikeve botërore. Fatkeqësisht kjo hartë u zhbë në momentin që PD kaloi në opozitë. Aktualisht, përhapja e shpejtë e mbjelljes së drogës në të gjithë territorin e vendit, e mbështetur nga politikanë dhe qeveritarë me pushtet, ashtu siç edhe është folur nga institucione ndërkombëtare dhe të vendeve fqinje me ne, e ka vendosur Shqipërinë në një pozicion shumë të vështirë ndërkombëtar, pasi ka prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë sigurinë kombëtare, imazhin e vendit dhe po cënon edhe sigurinë e vendeve të tjera pranë nesh.

Inkriminimi i pushtetit me anë të mbështetjes që i ka dhënë trafikut të drogës nga vende në kontinentin Amerikan, dhe deri në Azi, na ka vendosur ne si vend në listën e vendeve më të inkriminuara në botë sipas raporteve ndërkombëtare dhe ka sjellë në Shqipëri agjenci ligjzbatuese të Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të tjera perëndimore për t'u marrë drejtpërdrejtë me situatën alarmuese të drogës dhe krimit të organizuar në Shqipëri dhe të drejtuar nga shqiptarë të inkriminuar dhe mbështetës të qeverisë. Kjo është edhe arsyeja se pse agjencitë më të mëdha të sigurisë dhe më serioze në luftën kundër drogës, terrorizmit dhe kontrabandës e kanë parë të udhës të dislokohen në Shqipëri.

Përballë kësaj gjendje tejet shqetësuese, si çdo parti e djathtë në perëndim, Partia Demokratike do të vazhdojë të qëndrojë fuqishëm në kundërshtim të çdo projektligji apo nisme legislative që ka si synim legalizimin e drogave për qëllime gjoja mjekësore apo edhe amnistie apo përdorimi të pasaportave të arta që synojnë pastrimin e parave të fituara nga trafiket e drogës dhe të mbështetur nga politikanë dhe qeveritarë me pushtet. Është tashmë e provuar edhe shkencërisht se të gjitha shtetet të cilat kanë pasur dhe kanë miratuar një qasje liberale ndaj këtyre çështjeve, janë në kërkim të një rruge të kthimi pas. Për ne si konservatorë, siguria kombëtare është parësore pasi aty nis dhe mbaron çdo lloj kontrolli mbi shëndetin e qytetarëve, dhe territorit. Kombi dhe territori janë elementët bazë që ne mbrojmë fuqimisht.

Siguria kombëtare është cënuar në këto vitet e fundit nga brenda dhe jashtë vendit, jo vetëm me vendime absurde të qeverisë aktuale të mbështetura disa herë edhe nga aleatët tanë dhe rryma globaliste, por edhe



nga justifikime dhe angazhime ndërkombëtare që ka ndërmarrë qeveria shqiptare për të rritur vlerësimin e saj ndërkombëtar gjatë krizave humanitare të viteve të fundit. Shpeshherë këto angazhime ndërkombëtare, pa respektuar masën dhe standardet, kanë rezultuar kundër produktive, kanë cenuar sigurinë kombëtare të vendit dhe janë kthyer në barrë për taksapaguesit shqiptarë.

Aktualisht ndodhemi në një gjendje ku interesat partiake dhe ato të pushtetit vihen në plan të parë qoftë edhe duke dëmtuar rëndë në mënyrë të parikuperueshme sigurinë kombëtare. Rrezikimi i sigurisë kombëtare për interesa partiake dhe të individëve në pushtet, më shumë sesa një tendencë, po kthehet në një model të pandryshueshëm.

Hakerimi i të dhënave personale të shqiptarëve nga portali zyrtar e-Albania, së bashku me hakerimin dhe nxjerrjen në publik të të dhënave të ndjeshme për disa agjenci ligjzbatuese në Shqipëri, apo të dhëna bankare dhe numrat personal të shtetasve shqiptarë të nxjerra qëllimisht, kanë rrezikuar në maksimum sigurinë kombëtare dhe sigurinë personale të shtetasve shqiptarë. Nxjerrja e të dhënave nëpërmjet sistemeve dhe aplikacioneve Patronazhist dhe Aktivist nga Qeveria e Shqipërisë dhe veçanërisht nga Partia Socialiste në pushtet, me qëllim kontrollin e votës nëpërmjet presionit qeveritar, përbën një shkelje flagrante të të drejtave të njeriut dhe cënim të sigurisë kombëtare të vendit dhe qytetarëve.

Në të djathtë duke pasur të shenjtë lirinë e individit, ruajtjen dhe sigurinë e shtetasve shqiptarë si dhe sigurinë kombëtare të vendit do të marrim masa të menjëhershme që të vendoset në vend dinjiteti i qytetarëve dhe të ruhen nga çdo lloj rreziku i brendshëm apo i jashtëm qytetarët dhe territori. Megjithatë ndëshkimi nuk është praktikë e konservatorëve, kur cenohet siguria kombëtare dhe ajo e qytetarëve të vendit, cënuesit duhet të shkojnë para drejtësisë dhe masat shtrënguese për të mos lejuar më abuzimin e sigurisë kombëtare duhet të jenë të tilla që të vendosen në përputhje me të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e shtetasve shqiptarë.

Programi i djathtë për sigurinë dhe luftën kundër krimit të organizuar duhet të synojë rikthimin e rendit dhe të sigurisë publike në çdo cep të Shqipërisë. Duke u bazuar në suksesin e Partisë Demokratike në vitet 2005-2006, kur u bë një luftë efikase kundër krimit të organizuar dhe bandave, ky program do të fokusohet në zbatimin e ligjit me rreptësi dhe vendosjen e rendit publik si prioritet kombëtar:

Propozimet konkrete për Sigurinë dhe Luftën kundër Korrupsionit:

1. Lufta ndaj krimit të organizuar dhe bandave

- **Rikthimi i aksioneve intensive kundër krimit të organizuar, bazuar në sukseset e PD-së të viteve 2005-2006**, me operacione të koordinuara nga shteti për të çrrënjësuar bandat dhe organizatat kriminale. Do të krijohet një njësi e posaçme për të luftuar krimin e organizuar, që do të punojë ngushtë me partnerët ndërkombëtarë si FBI, Europol dhe Interpol.
- Forcimi i ligjit për konfiskimin e pasurive të paligjshme dhe pasurive të fituara nga krimi i organizuar, duke rritur përpjekjet për të identifikuar dhe sekuestruar asetet e paligjshme që mbështesin aktivitetet kriminale.
- Forcimi i kufijve dhe lufta kundër trafikeve ndërkombëtare, veçanërisht trafikut të drogës dhe armëve, duke përdorur teknologji të avancuara dhe kontrolle më të rrepta në kufijtë detarë dhe tokësorë

2. Lufta ndaj korrupsionit:



- Bashkëpunimi me **StAR (Stolen Asset Recovery Initiative)**, një nismë globale e përbashkët e Bankës Botërore dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC), që synon të ndihmojë vendet në zhvillim në rikuperimin e pasurive të vjedhura nga zyrtarët e korruptuar dhe transferimin e tyre në vende të huaja. Kjo nismë ka për qëllim të luftojë korrupsionin, duke rikthyer fondet e vjedhura që kanë kaluar përmes sistemit financiar global në mënyrë të paligjshme.

Ne do të gjurmojmë dhe kthejmë pasuritë e vjedhura nga ish-zyrtarë të korruptuar që mund të kenë transferuar fondet jashtë vendit.

Ne do të fuqizojmë institucioneve vendase për të ndjekur gjurmët financiare, për të hetuar dhe konfiskuar asete të paligjshme dhe për t'i kthyer ato në shërbim të interesit publik.

Mbështetja për sistemin gjyqësor dhe organet e hetimit, për të ndjekur rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, duke bashkëpunuar me partnerë ndërkombëtarë në kërkim të pasurive të fshehura jashtë vendit.

- Politika e **tolerancës zero ndaj korrupsionit**, me ndërtimin e një sistemi antikorrupsion të fortë dhe të decentralizuar, duke përfshirë hetimet proaktive të bazuara në denoncime publike dhe anonime.
- Depolitizimi dhe profesionalizimi i administratës publike, duke krijuar një mekanizëm që e çliron shtetin nga ndikimi politik i korrupsionit dhe bandave. Kjo do të arrihet përmes reformave strukturore që kufizojnë ndërhyrjet politike në emërimet dhe vendimmarrjen e administratës.

3. Siguria kibernetike dhe reformimi i policisë

- Investime të mëdha në sigurinë kibernetike, duke krijuar një agjenci të specializuar për mbrojtjen e infrastrukturës kritike dixhitale, të ndërlidhur me qendrat globale të mbrojtjes kibernetike. Do të implementohen teknologjitë më të fundit për parandalimin e sulmeve kibernetike dhe mbrojtjen e institucioneve shtetërore dhe private.
- Reformimi i policisë së shtetit, duke e depolitizuar plotësisht dhe rritur standardet e profesionalizmit dhe meritokracisë. Policët do të marrin trajnim ndërkombëtar për teknikat më moderne të luftës kundër krimit, duke e bërë policinë më të efektshme dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve.
- Forcimi i policisë në terren dhe rikthimi i sigurisë në rrugë, me një prani më të madhe dhe më të dukshme në zonat urbane dhe rurale, për të garantuar sigurinë e çdo qytetari dhe për të luftuar kriminalitetin e vogël dhe të organizuar.

4. Forcimi i Forcave të Armatosura

- **Modernizimi i Forcave të Armatosura**, për t'i përshtatur ato me sfidat e reja të sigurisë rajonale dhe globale. Ky proces do të përfshijë investime në teknologji të reja ushtarake, trajnime me partnerët e NATO-s dhe rritjen e kapaciteteve për mbrojtjen e kufijve dhe sigurisë kombëtare.
- **Rritja e buxhetit për mbrojtjen, duke e bërë Shqipërinë një anëtare më të fortë dhe të besueshme të NATO-s**, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare për sigurinë kolektive. Kjo do të mundësojë përgatitjen e Forcave të Armatosura për t'u përballur me kërcënime të reja, si terrorizmi dhe konflikte të mundshme në rajon.



5. Arsimi

Hyrje

Parimet baze të organizimit dhe funksionimit të sistemit të arsimit do të jenë:

- ✓ Mbrojtja e dinjitetit njerëzor;
- ✓ Cilësia dhe rritja e aksesit në arsim;
- ✓ Solidariteti me nxënësit dhe studentët më vulnerabël;
- ✓ Mbrojtja dhe promovimi i arsimit;
- ✓ Ndërkombëtarizimi i arsimit;
- ✓ Efikasiteti dhe ulja e kostove – efektiviteti në sistemin arsimor – shkencor.

Qasja ndaj Arsimit: Arsimi është themeli i mundësive për çdo individ dhe garanton zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë. Një komb nuk ka të ardhme pa investuar në arsimin e brezit të ri. Prandaj, ne mbështesim reformat arsimore në të gjitha nivelet për të rritur cilësinë e tij. Arsimi duhet të jetë i çliruar nga ndikimet ideologjike duke synuar një depolitizim dhe dekomunistizim të plotë të përmbajtjes dhe kurrikulave, veçanërisht në shkencat shoqërore.

Depolitizimi dhe Dekomunistizimi i Arsimit: Reformat e propozuara synojnë të eliminojnë ndikimin politik në sistemin arsimor dhe rivendosin meritokracinë për personelin akademik dhe mësimor. Politika e centralizuar ka degraduar cilësinë e arsimit. Sistemi duhet të çlirohet nga këto ndikime për të krijuar një mjedis të hapur, ku arsimi i shërben vetëm zhvillimit intelektual të brezave të rinj.

Arsimi dhe Zhvillimi i Shoqërisë: Një arsim cilësor krijon qytetarë me identitet dhe dinjitet. Arsimi i përgjithshëm, universitetet dhe shkollat profesionale duhet të ndihmojnë çdo individ të ndërtojë një të ardhme të sigurt për veten dhe familjen e tij, duke ruajtur vlerat historike dhe kulturore të kombit shqiptar. Prindërit dhe mësuesit duhet të kenë një rol qendror në arsimin e fëmijëve, dhe jo shteti apo organizatat ndërkombëtare.

Reformimi i Arsimit Profesional dhe Universiteteve: Çdo diplomë duhet të ketë vlerë reale në treg, që të justifikojë kostot e arsimit. Fokusimi në arsimin profesional dhe universitetet si qendra të kërkimit shkencor është thelbësor për përgatitjen e një fuqie punëtore të aftë dhe për zhvillimin e vendit. Universitetet do të funksionojnë si institucione "research-based," ku kërkimi shkencor është prioritet, dhe programet akademike do të mbështeten në këtë drejtim.

Investimet në Kërkimin Shkencor: Ne mbështesim shumëfishimin e fondeve për kërkimin shkencor, krijimin e qendrave të ekselencës dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillimin e shkencës dhe inovacionit. Ky zhvillim do të përfshijë gjithashtu një reformim të Akademisë së Shkencave, për të mbështetur projekte me impakt të lartë për vendin.

Rimëkëmbja e Autoritetit Akademik: Rimëkëmbja e prestigjit të personelit mësimor dhe akademik është e rëndësishme për një sistem arsimor të fortë. Konkurenca meritokratike dhe depolitizimi i sistemit janë thelbësore për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe shkencës. Decentralizimi i vendimmarrjes dhe zvogëlimi i ndërhyrjeve politike do të ndihmojë në përmirësimin e menaxhimit të arsimit në nivel lokal.

Zhvillimi i Arsimit si Faktor Kryesor për Shoqërinë: Zgjerimi i mundësive për arsim, qoftë publik apo privat, duhet të jetë i barabartë për të gjithë, pavarësisht zonës gjeografike apo sfidave ekonomike. Bursa dhe ndihmesa meritokratike duhet të ndjekin studentin dhe jo institucionin, duke shpërblyer krijimtarinë dhe potencialin e nxënësve dhe studentëve.

Kthimi i Trurit: Mbështesim kthimin e "trurit" shqiptar nga diaspora me anë të incentivëve, si kreditë e buta për bizneset e vogla dhe të mesme, si dhe programe për të integruar ekselencën shqiptare në zhvillimin kombëtar. Internacionalizimi i arsimit dhe shkencës do të ndihmojë në integrimin e plotë të Shqipërisë në botën e zhvilluar.

Arsimi është shtylla kryesore për zhvillimin e vendit dhe mirëqenien e qytetarëve. Programi ynë synon një sistem të depolitizuar, të decentralizuar dhe të bazuar në kërkim, ku cilësia dhe meritokracia të jenë në qendër të vëmendjes. Vetëm përmes një reforme të thellë dhe të ndershme mund të ndërtojmë një të ardhme të qëndrueshme për Shqipërinë.



PROGRAMI ELEKTORAL I ARSIMIT 2025

Slogani/ Qëllimi: Një Sistem Arsimor Dinjitoz, Cilësor, i Arritshëm, dhe i Barabartë – Ne Duam dhe Dimë si ta ndërtojmë!

Arsim cilësor për nxënësit dhe studentët si:

- (i) **misionarë** të mbrojtjes dhe zhvillimit të lirisë dhe të të drejtave të njeriut, të demokracisë, familjes dhe vlerave tona kombëtare;
- (ii) **promotorë** të zhvillimit të Shqipërisë Evropiane dhe ndalimit të shpopullimit të saj;
- (iii) **qytetarë të mirëshkolluar** që zotërojnë aftësitë dhe kompetencat që kërkojnë shoqëria e mbështetur në dije dhe tregu i punës.

Propozimet:

1. **Buxheti publik për arsimin dhe shkencën arrin në 5% të GDP (aktualisht është 3,1%).** Kjo nënkupton që buxheti të arrijë 1 miliard Euro, në qoftë se GDP mesatare në vitet 2025-29 merret rreth 21-22 miliard Euro, ku:

- Buxheti i Arsimit parauniversitar arrin në 3,2 % të GDP;
- Buxheti i Arsimit i lartë dyfishohet dhe arrin në 1 % të GDP;
- Buxheti për shkencën 10-fishohet dhe arrin në 0,8 % të GDP.
- Investimi privat për arsimin, kërkimin dhe inovacionin arrin rreth 1,5 % të GDP.

Shqipëria është vendi që investon më pak se çdo vend në Europë për arsim dhe shkencë, ose më saktë në nivelin e vendeve të pazhvilluara të botës së tretë. Ky është shkaku kryesor i cilësisë së ulët në arsim dhe produktit gati inekzistent në shkencë. Në tre mandatet e Rilindjes Shqipëria është zhvilluar sipas modeleve të vendeve ku sundon ekonomia e zezë nga paratë e drogës, trafikeve, oligarkisë dhe korrupsionit, çka ka rritur luksin vetëm të atij grupi të përfshirë në ekonominë e zezë dhe ka varfëruar gjithë qytetarët e tjerë anembanë vendit, që ka çuar në shpopullimin thuajse të orientuar kryesisht në dëbimin nga vendi të rinisë dhe elektoratit të djathtë. Edhe ky investim i ulët në arsim është orientuar kryesisht në investime në zona të caktuara dhe këto kryesisht për ndërtime me kosto ekstravagante korruptive.

Sa më shumë që të vazhdojë ky nivel i ulët investimi për dijen, aq më e thellë do të jetë prapambetja në zhvillimin e gjithanshëm të vendit në krahasim me vendet e BE dhe ato të zhvilluara, aq më i vështirë dhe më i gjatë do të jetë integrimi i vendit në BE.

PD ka shansin historik që të marrë vendim dhe në 2025 të bëj kthesë e madhe në investimin në dije dhe shkencë, duke investuar bë arsim dhe shkencë si vend European dhe jo si një vend i botës së tretë! Kjo nuk do të jetë sakrificë për vendin, por një investim që garanton gjithë zhvillimin ekonomik shoqëror të vendit.

Ky investim gati i dyfishuar (krahasuar me buxhetet faktike) kërkohet me qëllimin kryesor: garantimin e arsimit cilësor për çdo fëmijë dhe të ri, çdo nxënës dhe student, pavarësisht ku banon, në qendër të Tiranës apo në fshatin më të largët të vendit, dhe pavarësisht nga gjendja ekonomike e prindërve. E thënë ndryshe, me këtë investim duhet të ndryshojë tërësisht fytyra e arsimit tonë në:

- (1) Akses për çdo fëmijë dhe të ri;
- (2) Përmbajtje moderne e mbështetur në traditën tonë dhe atë europiane;
- (3) Shkolla dhe universitete me infrastrukturë moderne dhe të sigurt; dhe
- (4) Mësues dhe pedagogë të çliruar nga kontrolli politik dhe me status si homologët e tyre në vendet e Europës demokratike.

Afati: Reformë përgjatë gjithë mandatit.

Financimi: Buxheti, fondet e huaja



2. Mësuesi dhe pedagogu i japin fytyrën shkollës dhe universitetit. Ata do të çlirohen nga kontrolli partiak, do të gëzojnë një status me nivelin më të lartë të lirisë akademike dhe pagat e tyre do të jenë mbi mesataren e pagave të mësuesve dhe pedagogëve në Rajoni e Ballkanit Perëndimor.

Ne zotohemi të dyfishohen pagat e mësuesve dhe pedagogëve më një rritje me ritëm: me nga **35% në vitin e parë dhe të dytë të mandatit dhe nga 15 % në vitin e tretë dhe të katërt të mandatit. (Paga minimale e mësuesit është 1300 Euro/muaj, ndërsa paga minimale në universitetet publike do të jetë 2500 Euro për profesorët dhe 2000 Euro për pedagogët me gradën “Doktor”)!**

Afati: Reformë përgjatë gjithë mandatit.

Financimi: Buxheti

3. Projekti Kombëtar: **Shkolla dhe Universitetet e shekullit XXI ose “Shkolla dhe universitete me infrastrukturë moderne.** Nxënësit dhe studentët do të kenë në çdo shkollë dhe fakultet të gjitha kushtet e nevojshme të hapësirave, higjienës, ujit të rrjedhshëm, ngrohjes, mobilimit, laboratorëve, infrastrukturës digjitale, bibliotekave, etj. si në çdo shkollë dhe universitet të vendeve të zhvilluara. **Afatet:** Brenda 6 muajve zhvillohet një hartë e re e rajonizimit të shkollave në zonat më të rrezikuara nga shpopullimi dhe ato më të varfëra të vendit, që konsideron uljen drastike të numrit të nxënësve, dhe brenda 3 viteve përfundon projekti në këto zona. Brenda 2 viteve përfundon projekti në universitetet publike. Brenda 4 viteve përfundon projekti për kopshtet, shkollat 9-vjecare dhe të mesme të vendit. Infrastruktura dixhitale sigurohet në të gjitha shkollat dhe universitetet publike brenda 2 viteve të para të qeverisjes.

Shqipëria është vendi që ka numrin më të madh (50-70%) të shkollave dhe universiteteve pa kushtet minimale të higjienës dhe furnizimit me ujë, pa ngrohje (90% e shkollave), pa minimumin e mobilimit dhe infrastrukturës laboratorike dhe digjitale. Jo vetëm nxënësit por edhe studentët në shkolla dhe universitete publike kanë thujse zero mundësi që të përdorin PC, pa folur për mjete të tjera më të avancuara të IT. Edhe detyrat, jo vetëm nxënësit por edhe studentët i bëjnë në celular, me internetin që u paguajnë prindërit. Shpejtësia e internetit në universitete dhe ato pak shkolla të disa qyteteve që mund ta kenë është shumë e ulët, thjesht një vjedhje masive që bëjnë kompanitë. Vetëm afërsisht 10% e nxënësve dhe më pak se 20% e studentëve kanë PC ose laptop në shtëpi, sepse ata dhe familjet e tyre nuk kanë mundësi financiare t’i blejnë. Kjo situatë haset vetëm në vendet e sapo dala nga luftërat dhe konfliktet. Kjo situatë duhet të ndryshojë sa më shpejt, në mënyrë që nxënësit, studentët, mësuesit dhe pedagogët të kenë kushte normale të mësimi dhe punës si qytetarë të një vendi europian.

Shqipëria është i vetmi vend në Europë që nuk ka akoma një Bibliotekë moderne universitare me fond on paper dhe fond digjital. Në këtë prioritet planifikohet të ndërtohet **Biblioteka Shkencore Universitare e Tiranës**, e cila do të shfrytëzohet nga studentët e universiteteve publike e private të Tiranës e të universiteteve rajonale, gjimnazistët, pedagogët dhe kërkuesit e vendit, si dhe qytetarët /lexuesit e interesuar nga Tirana dhe i gjithë vendi. (Kjo bibliotekë mund të llogaritet afërsisht 10 milion Euro).

Në kushtet e turrjes shumë të madhe të numrit të nxënësve dhe studentëve numri total i shkollave dhe universitete publike nuk do të jetë mbi 1000. Nisur nga investimet e bëra për shkolla të reja dhe rikonstruksione në 20 vitet e fundit, mund të supozohet që jo më shumë se në 300 prej tyre kërkohet ndërtim i ri ose rikonstruksion i thellë. Kjo do të thotë që investimi më i madh është për rikonstruksion të pjesshëm dhe pajisjen me infrastrukturën e tyre. Nisur nga ky argument, ky investim parashikohet të jetë rreth **150 milion Euro/vit dhe në total 500-600 milion Euro.** Është një investim i nevojshëm pasi më në fund Shqipëria bëhet me shkolla dhe universitete moderne.

Afati: afate të përshkallëzuar (shih më lart)

Financimi: rreth 150 milion Euro/vit nga buxheti dhe fondet e huaja.



4. **Programi „Arsimi shqiptar digjital i shekullit 21:** Digjitalizimi i kurrikulave, mësimdhënies e mësimnxënies, vlerësimit të cilësisë dhe menaxhimit të arsimit sipas modeleve më të mira të vendeve të tjera të ngjashme për nga madhësia me vendin tonë, sidomos Estonia.

Afati: përgjatë gjithë mandatit.

- Digjitalizimi i shkollave të zonave më të rrezikuara nga shpopullimi dhe më të varfëra – brenda 2 viteve;
- Digjitalizimi i Arsimit të lartë dhe të mesëm brenda 2 viteve;
- Digjitalizimi në arsimin bazë të gjithë vendit brenda 3 viteve.

Financimi: Fondi brenda Objektivit 3 (rreth 20 milion Euro/vit) nga buxheti dhe fondet e huaja. Por i gjithë financimi mund të sigurohet nga grantet e BE dhe të vendeve partnere.

5. Programi: Arsim cilësor për “Shqipërinë e harruar dhe të shpopulluar”

Politika të veçanta për zbutjen e shpejtë të pabarazisë dhe diskriminimit të nxënësve dhe studentëve të zonave më të rrezikuara nga shpopullimi, të zonave më të varfëra të vendit si dhe të grupeve të defavorizuara (minoritetet, paraplegjikët e tetraplegjikët). Këto zona do të përcaktohen mbi bazën e të dhënave të Censurit 2023 dhe treguesve të varfërisë.

- Kopshte dhe shkolla fillore me drekë** dhe me kushte normale për çdo fëmijë nxënës parashkollor dhe shkollor. Çdo fëmijë duhet të ketë frekuentuar të paktën për 1 vit kopshtin. Çdo fëmijë ndjek arsimin fillor- aksesit të jetë 100% dhe braktisja mundësisht zero. Do të aplikohen edhe përvoja/modele të vendeve të tjera për **Home schooling** të fëmijëve duke aplikuar një paketë mbështetëse (trajnim, mësim online, pagesë të prindit) për një nga prindërit e fëmijës - nxënës.
- Shkolla 9-vjeçare pa klasa kolektive, me drekë** dhe me kushte normale, në mënyrë që çdo fëmijë të përfundojë arsimin 9-vjeçar - aksesit të jetë 100% dhe braktisja mundësisht zero.
- Shkolla të mesme të mëdha, me drekë, në qendër të njësive administrative.** Çdo 15 – vjeçar duhet të ketë mundësi reale të vijojë arsimin e mesëm të përgjithshëm ose atë profesional.
- Shkolla të mesme të përgjithshme, profesionale ose të specializuara (të orientuara) me konvikte në qendër të bashkive.** Këto shkolla do të shërbejnë edhe për nxënësit e zonave të thella që marrin bursë dhe do të banojnë në konvikte.
- Mbështetje sociale e familjeve** për të mënjanuar braktisjen e shkollës nga fëmijët e tyre, nxënës të arsimit të detyruar, për të ndjekur dhe përfunduar me sukses arsimin e mesëm si dhe atë të lartë;
- Bursa për shpenzimet e jetesës për nxënësit dhe studentët** e këtyre zonave në konvikte/qendra studentore;
- Tarifa zero për studentët** e këtyre zonave në të gjitha ciklet e studimeve universitare;
- Paketë falas për arsimin digjital të nxënësve dhe studentëve** të këtyre zonave (internet falas, pajisje digjitale falas, akses falas në “Open Educational Resources”).
- Tekste falas në letër dhe elektronike.**
- Konsultime falas pas mësimit, përgatitore për maturantët** e këtyre zonave për tu përgatitur për maturë dhe për studime universitare, në mënyrë që ata të kenë shanse të konkurrojnë edhe në degët më të nevojshme për këto zona, sidomos mjekësi, mësuesi, IT, bujqësi, mjedis, ushqim, etj.
- Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme do të duhet të heqin dorë nga pajisjet e tyre të telekomunikacionit – veçanërisht telefonat celularë –, pajisjet e përshtatshme për regjistrimin e fotografive ose audio, dhe pajisjet inteligjente për qasje në internet, të cilat do të kthehen në fund të ditës (modeli hungarez).
- Suplement realist në pagë dhe shpërblim shtesë për mësuesit** që zgjedhin të punojnë në këto zona, por nuk janë banorë në këto zona (sipas modelit për mjekët).

Afati: përgjatë gjithë mandatit



Financimi: Fondi përveç atij në objektivat 3 dhe 4, max. 30 milion Euro/vit nga buxheti dhe fondet e huaja, sidomos ato të BE që kanë në fokus zonat e varfra dhe ato rurale.

6. Zhvillohet një Sistem modern i Arsimit të Mesëm dhe të Lartë profesional të orientuar kah kërkesat e tregut të punës dhe të zhvillimit ekonomik të vendit.

- a. Fuqizohen shkollat e mesme profesionale.
- b. Forcohet formimi praktik në programet profesionale të arsimit të lartë.
- c. Qendrat shumëfunksionale të AFP (QSHAFF)
- d. Zgjerohen mundësitë e shkollimit të orientuar profesional.
- e. Krijohet dhe institucionalizohet „FONDI I PRAKTIKAVE PROFESIONALE”
- f. Vetëpunësimi i nxënësve dhe studentëve që përfundojnë programet profesionale
- g. Shkollat e mesme profesionale, QSHAFF, Kolegjet e larta profesionale ofrojnë formim për të rinjtë shqiptarë në emigracion kurse trajnimi intensive ndërkombëtarisht të njohura për formimin profesional, mbështetur në aftësitë praktike jo formale të fituara përmes ushtrimit për disa vite të profesionit në vendet ku jetojnë. Këto kurse do të jenë ndërkombëtarisht të njohura e të certifikuar dhe synojnë të formojnë edhe teorikisht të rinjtë për profesionet që ata i zotërojnë dhe i ushtrojnë, pasi është bërë vlerësimi i aftësive praktike sipas standardeve që përdorin vendet e tjera. Plotësimi teorik do të realizohet përmes kombinimit të mësimin në prezence me format e tjera online (Blend learning, Distance learning, etj). Në fund të kursit, kandidatët certifikohen në një Certifikatë të Formimit Profesional, e cila u shërben të rinjve që të klasifikohen në kategori më të larta në profesion atje ku punojnë dhe të paguhën më mirë.

Afati: Reformë afatgjatë.

Financimi: Buxheti, programet e BE (sidomos Erasmus+, Garancia; EUYouth, etj) dhe të disa vendeve partnere sidomos RFGJ, Austria, Zvicra, etj.

7. Të arrihet cilësia dhe standardet e nivelit ndërkombëtar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar (APU). Çdo dëftesë dhe diplomë shqiptare përmbush standardet internacionale dhe garanton mobilitetin e nxënësve.

- a. *Zbatohen standardet e vendeve të zhvilluara për strukturën, kurrikulat, tekstet dhe materialet burimore në arsimin parauniversitar (APU).*
- b. *Nxënësit shqiptarë 19 – vjeçarë zotërojnë 2 gjuhë të huaja.*
- c. *Nxënësit shqiptarë zotërojnë kompetencat digjitale të nivelit të vendeve të zhvilluara.*
- d. *Në PISA 2028 arrihet klasifikim mbi mesataren e rajonit.*
- e. *Arsim i mesëm për çdo 15 vjeçar. E njëjta gjë vlen për Arsimin Profesional, pra zgjedhja me detyrim mes arsimit të përgjithshëm apo atij profesional.*
- f. *Matura shtetërore ngrihet në nivelin e maturës së vendeve të zhvilluara.*
- g. *Aplikimi i standardeve, strukturave dhe praktikave ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar dhe atë të lartë.*
- h. *Kurs i trajnimit të vazhduar të autorëve të teksteve mësimore. Ky kurs organizohet nga shteti me mbështetjen financiare të shtëpive botuese.*
- i. *Aplikohet gradualisht autonomia financiare e shkollave të mesme dhe shkollave 9 – vjeçare më të mëdha.*

Afati: Afatgjatë

Financimi: Buxheti dhe programet e huaja (BE, et al). I parashikuar më lart (Shih objektivi 2)

8. Programi “Universiteti shqiptar -2035”.

Programi synon që, përmes investimit të dyfishuar: (i) të reformoj programet e studimeve universitare, (ii) të zhvilloj kërkimin shkencor dhe inovacionin, (iii) të zhvillojë burimet njerëzore,



dhe (iv) të modernizojë infrastrukturën e universiteteve, në mënyrë që ato të ofrojnë shkollim cilësor të studentëve të përafërt me nivelet internacionale.

- a. Në bashkëpunim me komunitetin akademik hartohet ligji i ri i Armimit të Lartë që i përgjigjet më mirë reformimit të sistemit të AL dhe Kërkimit shkencor për 10-15 viteve të ardhshme. Përmirësohet/reformohet organizimi institucional, Vetëqeverisja, zgjedhja e autoriteteve drejtuese si dhe menaxhimi i universiteteve, sipas modeleve bashkëkohore që kanë në qendër studentin, cilësinë dhe performancën akademike kërkimore, efikasitetin dhe transparencën e vetëqeverisjes, menaxhimit institucional, financiar, akademik dhe të burimeve njerëzore të universitetit.
- b. **Reformohet financimi i IAL publike** duke u orientuar nga modeli **“Performance- Based-Funding”**, ku përveç komponentit akademik, vlerësohet performanca kombëtare dhe ndërkombëtare në kërkimin shkencor, transferimi i njohurive dhe inovacioni, dhe, gradualisht, edhe vendi që zë në rankimet ndërkombëtare.
- c. **Reforma e shkollave të larta me status “Universitet”** përfshin investim me përparësi për:
 - i) **Reformimin e thellë të programeve të studimit** për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës dhe për t’i përafëruar me standardet internacionale. **Programet me orientim shkencor** “Master i shkencave” dhe “Doktoratë” reformohen me qëllim që të përafrohen me nivelin e atyre të universiteteve homologe dhe ofrohen në dy gjuhë: shqip dhe, kur është e nevojshme, anglisht. **Programet me orientim të lartë profesional**, ku përfshihen Cikli post sekondar profesional dyvjeçar (niveli 5 i Kornizës së Kualifikimeve), Bachelor profesional (niveli 6) dhe Master profesional (niveli 7), reformohen për të përmirësuar kryesisht formimin praktik të studentëve.
 - ii) **Reformimin e thellë të organizimit institucional për misionin e dytë “kërkimi shkencor”**, në mënyrë që ato të jenë efikasë në hartimin dhe zhvillimin e projekteve kërkimore me fonde të brendshme dhe të huaja. Njësitë e kërkimit shkencor, sidomos ato ndërdisiplinore (departamentet ndërdisiplinore), dhe grupet kërkimore të formës së Profesurës (Professorship ose Chair), në vend të grupeve mësimore-kërkimore aktuale, mbështeten me përparësi, mbi bazën e projekteve kërkimore, për intensifikimin e kërkimeve shkencore në drejtime të rëndësishme për vendin (shih programin e kërkimit shkencor). IAL me status “Universitet” që ofrojnë studimet e doktoratës dhe gëzojnë të drejtën e promovimit për titujt akademik (Prof. asoc, dhe Profesor) mbështeten me përparësi përmes investimit për zhvillimin e kërkimit shkencor, në mënyrë që të justifikojnë statusin e tyre akademik si universitete ku programet e studimeve mbështeten në kërkim shkencor **“Research-based University”**.
 - iii) **Organizimin institucional për misionin e tretë “Transferimi i njohurive, i teknologjisë dhe i inovacionit”**.
 - iv) Universitetet duhet të përfshihen në rankimet ndërkombëtare me objektiva konkrete për t’u afruar, brenda vitit 2035, në rankimet sipas fushave.
 - v) Programi i konsideron **Universitetet Rajonale si qendra të dijes dhe zhvillimit** dhe i mbështet ato për reformimin tërësor të tyre, me qëllim ofrimin e programeve të orientuara nga nevojat kryesisht të rajonit.
- d. **Reforma e shkollave të larta me status “Kolegj universitar”, “Akademi”, dhe “Kolegje të larta profesionale”**.
- e. Mbështeten të gjithë IAL publike dhe private për të hyrë në partneritet me një ose më shumë universitete të huaja prestigjioze, që i mbështeten ato në Reformimit tërësor sipas Objektivave të Strategjisë së Zhvillimit të arsimit të lartë 2035.

Afati: afatgjatë

Financimi: Buxheti i llogaritur për AL dhe fondet e huaja

9. **Programi “Mësuesit e Gjeneratës së re”:** Reformimi i përgatitjes dhe trajnimit të mësuesve si faktor kyç për cilësinë e shkollimit të nxënësve dhe të rinjve.



- Programi/Strategjia “**Mësuesit e Gjeneratës tjetër**” - Bashkëpunim me organizata partnere me ekspertizën më të mirë për të hartuar një strategji tërësore për përgatitjen dhe trajnimin e mësuesve në vendin tonë, të paktën për dy dekadat që vijnë.
- Mbështetje për reformimin e programeve të mësuesisë në universitete;
- Rritja e nivelit të pjesës praktike dhe asaj teorike të provimit të shtetit për mësuesinë. Pikët e grumbulluara në të duhet të jenë baza për konkurrimin për punë, pa qenë nevoja për një mekanizim tjetër siç është Portali.
- Krijimi i sistemit të plotë të Trajnimit të Vazhduar të mësuesisë;
- Mbështetje për programe afatshkurtër për rishkollimin apo zgjerimin e aftësive shkencore në një lëndë tjetër pranë IAL, për t’iu përgjigjur më mirë nevojave për mësues;
- Trajnim i gjithë mësuesve për kurrikulat e reja dhe ICT dhe arsimin digjital.

Afati: Reforma realizohet për 2 vjet. Programet e reja fillojnë të zbatohen në vitin 2027.

Financimi: Përfshihet në buxhetin e AL. Mund të realizohet edhe me fonde të huaja

10. Investim real dhe depolitizim i kërkimit shkencor dhe i inovacionit. PD nuk beson se akademitë e modelit sovjetik dhe grupet universitare e shkencore të seleksionuara politikisht, mund të bëjnë shkencë. Vizioni i PD është se universitetet e depolitizuara, me pedagogët, kërkuesit dhe sidomos doktorantët e postdoktorantët e tyre, janë lokomotiva e vërtetë e një sistemi modern të kërkimit shkencor, zhvillimit dhe inovacionit (Research & Development & Inovation – RDI). PD garanton që çdo kërkues shqiptar, brenda dhe jashtë vendit, do të ketë mundësi dhe do të mbështetet për të realizuar idetë e tij kërkimore që i shërbejnë zhvillimit të gjithanshëm të vendit tonë.

10.1. Shumëfishimi (dhjetëfishimi) i investimit kombëtar për shkencën, i cili del në buxhet si zë i veçantë “Fondi për Shkencën dhe Inovacionin”, i cili arrin deri në fund të mandatit 0,8 të GDP, duke filluar në vitin e parë të mandatit me një pesëfishim të financimit aktual. Fondi për Shkencën dhe Inovacionin do të përdoret për këto drejtime/programe: (i) Ngritjen e laboratorëve ndërdisiplinorë modernë, me infrastrukturë “state-of-art” në fusha prioritare të shkencave të aplikuara dhe ato natyrore, të krahasueshëm me atë të vendeve të zhvilluara; (ii) Ngritjen e Qendrave Ndërdisiplinore të Kërkimit shkencor; (iii) Projektet kërkimore në kuadër të Programeve Kombëtare të Kërkimit; (iv) Bursat e doktorantëve dhe postdoktorantëve; (v) Programin e Ekselencës në kërkim; (vi) Profesurat Ekselente nga kërkues të Diasporës shkencore shqiptare ose kërkues të huaj; (vii) Bashkëfinancimin e projekteve internacionale të kërkimit, ku marrin pjesë kërkues nga Shqipëria dhe vendet e tjera, dhe (viii) Ngritjen e Qendrave të Transferimit të Njohurive, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe të Shërbimeve pranë universiteteve dhe institucioneve kërkimore.

Bursa universitare e doktorale në fushat strategjike që do t’i përcaktojë politika arsimore-shkencore e PD. Rreth 70-100 bursa, niveli Bachelor & Master, si dhe niveli PhD, në disiplinat shkencore strategjike për zhvillimin e një vendi (bankë, biznes, IA / antropologji, filozofi), disiplina të cilat nuk mund të bëhen performante në universitet tona, së paku për 4 vitet e ardhshme.

10.2. Hartimi dhe miratimi brenda 6 muajve të parë të qeverisjes i një ligji modern për kërkimin shkencor, zhvillimin dhe inovacionin (RDI), i cili garanton lirinë akademike dhe të kërkimit shkencor, autonominë e institucioneve të sistemit të shkencës, si dhe aplikon standardet më të mira demokratike të politikbërjes, manaxhimit dhe vlerësimit të RDI në Shqipëri.

10.3. Zbatohet plotësisht Liria e kërkimit për çdo kërkues shqiptar: Çdo kërkues me gradën shkencore “Doktor”, pavarësisht se ku punon, në universitete publike apo private, apo qendra kërkimore të vendit, ka të drejtë të konkurroj, pa marrë leje paraprake nga askush, me projekt kërkimor direkt në



Agjenci në kuadër të Programeve Kombëtare të Kërkimit (PKKZH) ose programeve të tjera. Suksesi në aplikim përcaktohet nga cilësia e projektit e vlerësuar nga borde/komisioneve të përbërë vetëm nga shkencëtarët më të mirë shqiptarë dhe të huaj të përzgjedhur me pjesëmarrjen e komunitetit akademik të vendit.

10.4. Krijohet “**Programi i Ekselencës në Kërkim**” për studime të doktoratës dhe postdoktoratës. Në këtë program përzgjidhen me konkurrim projektet me të mira të kërkimit për gradën “Doktor” dhe Postdoktoratë, të cilët realizohen në grupet kërkimore me rezultate kërkimore të nivelit internacional, që bashkëpunojnë edhe me grupe të universiteteve a qendrave kërkimore të njohura të vendeve të zhvilluara.

10.5. PD do të financojë çdo vit, përmes Fondit për Shkencën, të paktën 600 doktorantë dhe 50 postdoktorantë. Asnjë student i doktoratës dhe postdoktoratës nuk do të paguajë nga xhepi për studimet e doktoratës dhe postdoktoratës! Çdo student i doktoratës dhe postdoktoratës financohet nga “Fondi për Shkencën”, me bursë për vendin e punës në universitete apo qendra kërkimore, shpenzimet e realizimit të projektit shkencor si dhe të botimeve që do rrjedhin prej tij. Doktorantët shqiptarë dhe të huaj me projekt fitues do të kenë vend pune të financuar me një bursë 2-vjecare prej 1500 Euro/muaj nga ky Fond, ndërsa postdoktorantët shqiptarë dhe të huaj me projekt fitues do të kenë vend pune të financuar me një bursë 3-vjecare prej 2100 Euro/muaj, të financuar nga ky Fond. Me këtë investim Shqipërisë i shtohen afërsisht 2600 kërkues të rinj, duke e çuar numrin total në mbi 9000 kërkues, çka do të rritë raportin e tanishëm prej rreth 2,3 kërkues/1000 banorë në 3,8 kërkues/1000 banorë dhe do ta përafrojë atë me vendet e reja të BE.

10.6. PD mbështet me përparësi krijimin e “**Qendrave kërkimore dhe Laboratorëve kërkimorë ndërdisiplinorë të ekselencës**” në universitete publike dhe private, si dhe në institucione kërkimore e zhvillimore jashtuniversitytare në fusha prioritare të kërkimit dhe zhvillimit, ku realizojnë kërkime grupe më të mëdha kërkuesish, që kanë në përbërje të tyre edhe studentët e doktoratës e postdoktoratës.

PD do të investojë në mandatin e parë 30 milion euro për ngritjen, për herë të parë në Shqipëri, të laboratorëve modernë ndërdisiplinorë të kërkimit shkencor në shkencat e aplikuara dhe shërbimeve, me infrastrukturë moderne të standardeve internacionale, e cila u jep mundësi kërkuesve shkencorë shqiptarë të ndërmarrin kërkime shkencore fundamentale dhe të aplikuara të krahasueshme së paku me ato që kryen në vendet tjera të rajonit. Do të ngrihen, brenda 4 viteve, 15 laboratorë modernë ndërdisiplinorë (secili kushton afërsisht 2 milion Euro) në fushat e mëposhtme të shkencave të aplikuara (1 laborator për fushë):

- *Resurset nëntokësore, gjeoshkencat, përpunimi i mineraleve;*
- *Materialet dhe nanoteknologjia;*
- *Arkitektura, ndërtimi dhe zhvillimi urban;*
- *Bujqësia, blegtoaria, pyjet, akuakultura dhe peshkimi;*
- *Ushqimi dhe siguria ushqimore,*
- *Bioteknologjia dhe biologjia molekulare;*
- *Burimet ujore;*
- *Energjia e pastër dhe energjitë e rinovueshme;*
- *Mjedisi dhe ndryshimet klimatike;*
- *ICT, digjitalizimi dhe intelijenca artificiale;*
- *Mjekësia dhe shkencat e shëndetit;*
- *Mjekësia veterinare dhe shëndeti i kafshëve;*
- *Matematika e aplikuar dhe statistika;*



- *Fizika bërthamore dhe biofizika;*
- *Kimia e aplikuar, industriale dhe ushqimore.*

10.7. Ngrihen 100 laboratorë mësimorë-didaktikë në universitetet publike të vendit. Studentët tanë mësojnë në laboratorë mësimorë didaktikë modernë. Investim për “upgrade” ose ngritjen e të gjithë laboratorëve mësimorë-didaktikë për studentët në universitetet publike (100 laboratorë mësimorë-didaktikë në universitetet publike financohen me rreth 10 milion euro nga Fondi i Shkencës dhe Inovacionit).

10.8. Krijimi i “Profesurave Ekselente” nga kërkues të diasporës shkencore shqiptare ose kërkues të huaj. PD do të ftojë kërkuesit e afirmuar shqiptarë dhe kërkues të huaj, të cilët kanë përfunduar shkëlqyer PhD dhe një postdoktoratë të paktën 2-vjecare në universitete apo qendra kërkimore prestigjioze, dhe janë të afirmuar me botimet e tyre internacionale, të paraqesin projekte për të ngritur grupet e tyre të kërkimit të ekselencës, të afiluara pranë universiteteve tona dhe institucioneve të kërkimit jashtuniversitare, duke i mbështetur me paga deri 2 herë më të larta krahasuar me pagën e profesorit në universitetet tona, si dhe të gjitha shpenzimet e tjera për studentët e doktoratës si dhe të realizimit të projektit kërkimor.

10.9. Mbështeten me përparësi krijimi i “Njësitë të Transferimit të Njohurive, Teknologjisë dhe Inovacionit” në universitete publike dhe private me një status juridik publik të pavarur.

10.10. Rritja e statusit të Agjencisë së kërkimit (AKKSHI) drejt një Autoriteti Kombëtar publik të pavarur, i cili vë në jetë lirinë e kërkimit shkencor për çdo kërkues shkencor mbi bazën e konkurrimit me projekte dhe vlerësimit të meritës nga shkencëtarët jashtë çdo ndikimi politik. Si model për Agjencinë/Autoritetin do të merret ai agjencie/fondacioneve homologe në vendet e tjera (p.sh. Sllovenia).

10.11. Adaptohen procedura transparente, jo burokratike dhe krejtësisht të digjitalizuara për aplikimin, vlerësimin, miratimin dhe menaxhimin e projekteve kërkimore.

10.12. Anëtarësohet Agjencia/Autoriteti në rrjetin e Autoriteteve/agjencie/fondacioneve të vendeve të Rajonit për të bashkëfinancuar projekte të grupeve kërkimore të vendeve të rajonit.

Afati: Reformë afatmesëm. Agjencia duhet të reformohet brenda vitit 2027.

Financimi: Shumëfishimi (10-fishimi) i buxhetit në nivelin 0,8 % të GDP në fund të mandatit. Një pjesë e tij nga fondet e BE. Në vitin e parë buxheti për Shkencën & Inovacionin është 0,25 % të GDP, në vitin II- 0,35%; vitin III – 0,55% dhe në vitin IV- 0,8% të GDP.

11. PD konsideron integrimin ndërshqiptar në arsim dhe shkencë si rruga më e sigurt e integritit ndërshqiptar në tërësi.

Çdo shkollë, universitet dhe qendër kërkimore e vendit tonë duhet të ketë homologët, “binjakët” e saj/tij shqipfolës në Ballkan.

Pavarësisht propagandës përgjatë gati 12 viteve, bashkëpunimi në arsim midis shqiptarëve në Ballkan fatkeqësisht po dobësohet. Shqiptarët në arsim po izoloohen me vetëdije nga njeri-tjetri. Gjithnjë e më pak studentë shqiptarë po studiojnë në universitetet tona nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, ndërkohë që studentët nga Shqipëria në universitetet shqipfolëse në Ballkan janë të pakonsiderueshëm. E njëjta prirje vihet re edhe në shkëmbimet midis shkollave të mesme. Ndërkohë që duhet të synohej integrimi ndërshqiptar i komuniteteve akademike sipas fushave të



shkencës, sot jo vetëm që ato po largohen nga njeri-tjetri, por është krijuar thuajse një mjedis mosbesimi midis tyre. Kjo prirje nuk i shërben integritetit ndërshtetëror dhe duhet ndryshuar.

PD i konsideron nxënësit, studentët dhe njerëzit e dijes si promotorët më të mirë për përshtetimin e integritetit ndërshtetëror.

Prandaj PD, mbështetur edhe në traditën e saj të suksesshme të filluar që në 1992, do të nxitë dhe mbështetë me përparësi intensifikimin e bashkëpunimit real midis shkollave dhe universiteteve shqiptare në Ballkan, me objektivin që çdo shkollë dhe universitet i Shqipërisë të jetë i binjakëzuar të paktën me një institucion homolog shqiptar në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Luginën e Preshevës.

Afati: Reformë afatgjatë.

Financimi: Burimi kryesor i financimit është buxheti i shtetit dhe fondet rajonale të BE. (rreth 2 milion Euro/vit)

12. Internacionalizimi është rruga kryesore e integritetit të arsimit dhe shkencës shqiptare në Europë dhe në familjen e vendeve të zhvilluara.

Çdo universitet, qendër kërkimore, gjimnaz dhe shkollë profesionale bashkëpunon ngushtë deri në një binjakëzim me institucionet homologe në Europë, SHBA dhe më gjerë.

PD e konsideron internacionalizimin si rrugën kryesore të integritetit të arsimit dhe shkencës shqiptare në Europë dhe në familjen e vendeve të zhvilluara. Iniciativat e deritanishme në këtë drejtim janë të pamjaftueshme. Prandaj PD, mbështetur edhe në traditën e saj të hershme që në vitin 1992, do të nxitë dhe do të mbështetë çdo universitet publik, qendër kërkimore, gjimnaz dhe shkollë profesionale që të zhvillojë një bashkëpunim të ngushtë deri në binjakëzim me institucionet homologe në Europë, SHBA dhe më gjerë.

Afati: Afatgjatë.

Financimi: Burimi kryesor i financimit janë programet e BE.

13. Mbështetja e shkollimit shqip të fëmijëve shqiptarë në diasporë dhe thithja e “trurit” të diasporës akademike në dobi të zhvillimit të arsimit dhe shkencës tonë.

- Çdo fëmijë shqiptar në diasporë ka mundësi të mësojë gjuhën shqipe, kulturën dhe historinë e shqiptarëve.
- Programi “Brain Gain” dhe “Brain Circulation” në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.
- Përrurimi i një biblioteke digjitale shqipe online, me karakter të përgjithshëm dhe enciklopedik, në shërbim të fëmijëve dhe të rinjve të diasporës shqiptare.
- Përrurimi i një laboratorit /shkolle shqipe online, në shërbim të fëmijëve dhe të rinjve të diasporës shqiptare. (Si biblioteka, ashtu edhe laboratorit, mund të funksionojnë përmes një abonimi modest vjetor dhe përmes mbështetjes nga biznesi i diasporës dhe i vendit.

Afati: fillon që në vitin e parë të mandatit.

Financimi: Brenda buxhetit të arsimit dhe shkencës

14. Nxitja e investimit privat, sidomos në arsimin profesional, kërkimin shkencor dhe inovacionin do të jetë një përparësi.

PD do të përshtat përvijat/modelet më të suksesshme të vendeve të ngjashme me vendin tonë, për rritjen e investimit privat në arsim, kërkim shkencor dhe inovacion nga sipërmarrjet shqiptare vendase dhe sidomos nga diaspora sipërmarrëse dhe ajo akademike shkencore.

- Stimulimi i investimit privat në arsimin parashkollor dhe atë parauniversitar në qytetet e mëdha.
- Stimulimi i kompanive të mëdha private, të vendit ose të huaja, për të hapur shkolla të mesme profesionale dhe degë/programme profesionale në fushat ky ushtrojnë biznesin e tyre.



- c. Stimulimi i bizneseve të mëdha për të mbështetur me kapacitetet e tyre formimin praktik të nxënësve dhe studentëve të arsimit profesional të integruar me praktikën.
- d. Nxitja e shkollave të larta private për tu profilizuar në programet profesionale në bashkëpunim me sektorin privat prodhues apo të shërbimeve në sektorët përkatës.
- e. Nxitja përmes Fondit të shkencës, e shkollave të larta private dhe kompanive të vendit dhe të huaja, për të investuar në kërkimin shkencor, transferimin e teknologjisë dhe inovacion

Afati: gjatë gjithë mandatit.

6. Shëndetësia

Diagnoza e sistemit shëndetësor në Shqipëri

Partia Socialiste në zgjedhjet e vitit 2013 e përdori shëndetësinë si karrocë me dy kuaj beteje: Shëndetësia falas dhe Sistemi Britanik (Bismark) i organizimit dhe funksionimit

- Te dyja këto u prezantuan nëpërmjet një makine propagande të fuqishme si shpëtimi i sistemit të shëndetësisë
- Sot të dy këto kuaj kanë “ngordhur” dhe propaganda nuk mund të fshehë më situatën aktuale të sistemit dhe mosmarrjen nga ana e qytetarëve të një shërbimi bazë e jetësor siç është shëndetësia.

Është i njohur fakti që në sistemet shoqërore autoritare vlerësimi i jetës në vend vizatohet nga dy realitete; ai i parë me syrin e qeverisjes dhe që është një realitet virtual i përshkruar me ngjyra të ndezura, të bukura, plot dritë e begati dhe ai i ndjerë nga qytetarët, një realitet i vërtetë, i zymtë, i vështirë, e i mbushur plot varfëri e dhimbje.

Parë me sytë e qytetarëve anekënd këtij vendi, të atyre dhjetëra mijëra të sëmurëve që provojnë mbi kurrizin e tyre këtë “parajsë” shëndetësore të sistemit tone shëndetësor, realiteti është tërësisht i trishtë. Janë vetë qytetarët shqiptarë ata që sot me shume se kurrë provojnë mbi lëkurën e tyre këtë dështim, (COVID 19 është pasqyra e dështimit) duke marrë një shërbim jo cilësor, me mungesa të theksuara edhe në ato me elementaret si barnat, reagjentët e kushtet higjieno – sanitare, e duke e ndjerë thellë në shpirtin e kuletën e tyre zhvatjen nëpërmjet pagesave, e korrupsionit që në shumë raste shkon deri në ekstrem. Së dyti, janë vetë treguesit e sistemit shëndetësor që flasin për një sistem në stanjacion, jo cilësor, me qasje të cunguar.

“Numbers rule the universe.”/“Numrat sundojnë universin” – Pitagora

Treguesit statistikore janë të sakte, të ftohte, të paansheme, shkencore, të pagabueshëm. E këta tregues e bëjnë të shfryhet ‘tullumbacja’ boshe e sukseseve të qeverisjes aktuale dhe e rendisin sistemin tone shëndetësor në vendin e fundit në Evropë, pra jo të krahasueshëm krahasohemi me vendet e zhvilluara të BE por me shume dhe direkt me ato edhe të fundit në rajon. Për këtë mjafton të përmendim se treguesit baze statistikore të Organizatës Botërore të Shëndetësisë si vdekshmëria foshnjore, numri i mjekeve, shtretërve spitalore, vizitave, shfrytëzimit të shtratit, etj., janë shume më të dobët krahasuar me ato të Bashkimit Evropian, por edhe me shtetet e tjerë të rajonit tone.

Situata aktuale në vendin tonë parë nëpërmjet shifrave



Për të analizuar situatën e sistemit shëndetësor në Shqipëri, janë përzgjedhur dy vende fqinje, Mali i Zi dhe Serbia, si dhe dy vende të Bashkimit European, Italia dhe Gjermania. Për secilin prej katër vendeve janë shqyrtuar katër tregues bazë që vlerësojnë nivelin e përkushtimit të shtetit ndaj shëndetësisë: shpenzimet shëndetësore për frymë, përqindja e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) e shpenzuar për shëndetësinë, shpenzimet private dhe vdekshmëria foshnjore.

Ndër këta tregues, vdekshmëria foshnjore është treguesi më i gjithëpranuar në nivel global për të vlerësuar impaktin e cilësisë, qasjes dhe efektivitetit të shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor në një vend të caktuar.

Shpenzimet shëndetësore për frymë

Shpenzimet për kujdesin shëndetësor në Shqipëri janë në nivele skandaloze. Me vetëm 464.7 dollarë amerikanë për frymë, shpenzimet për shëndetësi në Shqipëri janë rreth dy herë më të ulëta se në Serbi dhe Malin e Zi, dhe plot shtatë herë më të ulëta se në Itali. Diferenca bëhet edhe më dramatike kur krahasojmë shpenzimet me Gjermaninë, ku ato për frymë janë 14 herë më të larta se në Shqipëri. Ky nivel i ulët investimi ka implikime të thella për cilësinë dhe aksesin në kujdesin shëndetësor për qytetarët shqiptarë.

Pasqyra 1: Shpenzimet shëndetësore për frymë (në US\$) në vendet e marra në shqyrtim (ref. Banka Botërore)

Nr	Vendi	Shpenzimet (në US\$)	Raporti me Shqipërinë
1	Shqipëria	464.7	
2	Mali i Zi	985.0	2 herë më të larta
3	Serbia	919.2	2 herë më të larta
4	Italia	3,350.0	7 herë më të larta
5	Gjermania	6,626.0	14 herë më të larta

Përqindja e PBB-së që shpenzohet për shëndetin

Edhe kur analizojmë përqindjen e PBB-së që shpenzohet për shëndetësinë, Shqipëria mbetet pas vendeve të tjera. Me vetëm 7.3% të PBB-së të dedikuar për shëndetësinë, Shqipëria është pas Malit të Zi (10.6%), Serbisë (10.0%), Italisë (9.0%) dhe sidomos Gjermanisë (12.7%). Kjo tregon se edhe pse ekonomia shqiptare është më e varfër krahasuar me këto vende, edhe përqindja e burimeve që i dedikohet shëndetësisë është më e ulët. Kjo e bën të pamundur përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe të infrastrukturës së nevojshme për kujdesin ndaj pacientëve.




Figura 1: Përqindja e PBB-së e shpenzuar për shëndetin në vendet e krahasuar (ref. Banka Botërore)

Shpenzimet private për shëndetin

Problemi më i madh për Shqipërinë është se pjesa më e madhe e shpenzimeve për shëndetësinë vijnë nga xhepi i qytetarëve, me një përqindje të lartë prej 59.7%. Në Gjermani dhe Itali shpenzimet private janë shumë më të ulëta, përkatësisht 12.2% dhe 21.9%. Kjo reflekton një sistem shëndetësor publik të fuqishëm që kujdeset realisht për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarit.

Varësia e kujdesit shëndetësor shqiptar nga shpenzimet private sjell një sërë problemesh, si rreziku për shpenzime katastrofike që mund të çojnë në varfëri, qasje të kufizuar në kujdesin shëndetësor për grupet e popullsisë me të ardhura të ulëta, dhe një pabarazi të thelluar në shëndet. Gjithashtu, rritja e shpenzimeve private krijon një presion të madh mbi familjet dhe minon kohezionin social, duke rritur pabarazinë në shëndetësi.

Kjo merr nota sarkazme kur krahasohet me premtimin e Partisë Socialiste për kujdes shëndetësor falas. Ndërkohë, përgjatë qeverisjes u krijua një sistem shëndetësor jo vetëm i keqfinancuar, por që qëndron në themelet e paqëndrueshme korruptive dhe në dëm qytetarëve, pacientëve dhe familjarëve të tyre.




Figura 2: Përqindja e shpenzimeve private të qytetarëve për përfitim të kujdesit shëndetësor (ref. Banka Botërore)

Vdekshmëria foshnjore

Nuk ka tregues më domethënës për shëndetin se sa numri i foshnjave me moshë 0-1 vjeç që humbin jetën për çdo 1,000 foshnja të lindura gjallë. Vdekshmëria foshnjore në Shqipëri është 8.4 për 1,000 lindje të gjalla, një shifër dukshëm më e lartë se në vendet e tjera të marra në shqyrtim. Për shembull, në Itali dhe Malin e Zi, kjo shifër është përkatësisht 2.2 dhe 2.3 për 1,000 lindje të gjalla. Kjo tregon se keqfinancimi dhe keqqeverisja e sistemit shëndetësor në Shqipëri kanë pasoja të drejtpërdrejta dhe të rënda, si për sasinë ashtu dhe për cilësinë e kujdesit shëndetësor, veçanërisht për foshnjat dhe nënat.

Nivelet skandaloze të vdekshmërisë foshnjore janë një tregues i qartë i mungesës totale të vëmendjes së qeverisë për shëndetin dhe jetën e qytetarëve shqiptarë. Shteti që nuk kujdeset as për shëndetin dhe jetën e foshnjave nuk mund të kujdeset për asnjë prej kategorive të tjera të të sëmurëve.




Figura 3: Vdekshmëria foshnjore e shprehur në foshnja të vdekura për 1,000 lindje gjallë (ref. Banka Botërore)

Duke analizuar të tjera burime statistikore dhe analiza të kryera në vazhdimësi, por me pasoja të rëndësishme për shëndetin e popullatës:

- Shqiptaret sot jetojnë 7 vite me pak se qytetarët e BE;
- Në Shqipëri, nga 1000 foshnja të lindura gjalle, vdesin brenda vitit të parë të jetës 3.4 here me shume se në BE;
- Shqiptaret kanë sot rreth 2.5 here me pak mjekë e infermiere se qytetarët e BE;
- Shqiptaret vdesin 1.8 here me shume nga sëmundjet kardiovaskulare se qytetarët e BE;
- Shqiptaret kanë sot rreth 2 here me pak spitale dhe shtretër spitalore,
- Shqiptaret paguajnë nga xhepat e tyre sot 60% të shpenzimeve për shëndetin e tyre krahasuar me 25% që paguajnë qytetarët e BE;
- Megjithatë Shqipëria shpenzon pothuajse sa mesatarja e vendeve të rajonit, treguesit kryesorë të cilësisë dhe efikasitetit të sistemit shëndetësor janë skandaloze.

Analiza e fakteve

Shifrat dhe faktet janë kokëfortë. Ato nxjerrin zbuluar propagandën edhe tregojnë pasqyrën e një sistemi shëndetësor të lënë pas dore, të keqfinancuar dhe të vjedhur, mbështetja e të cilit sipas modeleve afrikane i është lënë në kurriz qytetarit.

Siç tregojnë shifrat, Shqipëria qëndron shumë pas vendeve fqinje dhe vite dritë larg vendeve të Bashkimit Europian sa i përket investimeve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Me shpenzime të ulëta për shëndetësinë, varësi të madhe nga shpenzimet private dhe një vdekshmëri foshnjore të lartë, Partia Demokratike dhe aleatët e saj do të përballen me një prej sfidave më të mëdha në përpjekje për të përmirësuar shëndetin e qytetarëve dhe për t'u ofruar atyre një kujdesit shëndetësor cilësor, të arritshëm dhe kosto-efektiv.

Problematika kryesore e sistemit shëndetësor



Ne vlerësimin tonë, problemet me te mprehta me te cilat ndeshet sot sistemi ynë shëndetësor janë si më poshtë;

1. **Akresi i mangët dhe /ose i munguar** dhe pabarazi e popullatës për shërbim shëndetësor të të gjitha niveleve; shëndet publik, kujdes shëndetësor parësor, kujdes spitalor, kujdes dentar, shërbim farmaceutik etj. Këto mangësi/mungesa janë gjeografike por edhe financiare.
2. **Cilësi e dobët e shërbimit shëndetësor** te ofruar nga institucionet shëndetësore publike por jo vetëm. Popullsia shprehet shume e pakënaqur nga cilësia e shërbimit shëndetësor qe i ofrohet ne institucionet shëndetësore ne vend. Ballafaqimi i treguesve shëndetësor me standarde e përparuara botërore, tregon qe cilësia e shërbimit tone shëndetësor është shume larg këtyre standardeve. Është kjo arsyeja kryesore qe i detyron mijëra shqiptare ti drejtohen spitaleve ne vendet e tjera si Itali. Gjermani, France, Turqi, e me larg duke shpenzuar çdo vit dhjetëra milionë euro për këtë qellim.
3. **Efikasitet i ulët** i shërbimit shëndetësor publik, që do te thotë se me sasinë e parave publike dhe private qe shpenzohen në sistem prodhohet pak shëndet. Kjo lidhet jo vetëm me modelet primitive te menaxhimit ne institucionet shëndetësore por edhe me korrupsionin e konsiderueshëm të drejtuesve e më gjerë. Si pasojë e keqmenaxhimit, edhe ato pak para publike që shpenzohen në sistemin shëndetësor përfundojnë në shumicë në gropat e zeza te korrupsionit duke bërë që sistemi ynë shëndetësor te renditet ndër vendet me efikasitetin më të ulët në Europë.
4. **Centralizimi ekstrem.** Pavarësisht ndryshimeve kozmetike, sistemi ynë shëndetësor është tepër i centralizuar e mund te krahasohet vetëm me modelet socialiste ose komuniste, si ai i Koresë së Veriut.
5. **Financimi i pamjaftueshëm** është tashme një sëmundje kronike e sistemit tonë shëndetësor, që e ka vene këtë te fundit ne një gjendje letargjie të vazhdueshme. Qeveria aktuale ka dështuar me skemën e financimit (Fondin SDSH). Pagesat nga xhepi llogariten ne rreth 60% te financimit te sistemit tone shëndetësore, këto si pagesa ne shërbimin shëndetësor privat, pagesa në shërbimin shëndetësor publik dhe korrupsion. Kjo shifër është më shumë se alarmante dhe rendon xhepat e pacienteve dhe familjaret e tyre duke i çuar jo rralle ne shkatërrim financiar. Vlen për të theksuar se pagesat nga xhepi në vendet me sisteme te konsoliduar shëndetësore te Evropës si France, Britani, Gjermani, etj. arrijnë midis 6% deri ne 15%. Nga ana tjetër, ky fakt implikon drejtpërsëdrejti drejtuesit politike te sistemit shëndetësor të cilët ne mënyrë te hapur e te përsëritur kane nxitur publikisht një sistem të tillë.
6. **Politikë e dështuar me burimet njerëzore në shëndetësinë publike.** Pjesa me e keqtrajtuara dhe e keqmenaxhuar janë burimet njerëzore ne sistemin shëndetësor duke nisur prej:
 - a. Ministrave të Shëndetësisë të cilët nuk kanë një vizion të vetin, janë të akuzuar ose nën hetim për vjedhje dhe për tendera korruptive;
 - b. Drejtorë spitalesh shpesh herë pa formimin dhe njohjen minimale te menaxhimit te spitalit;



- c. Shpesh vihen re raste punësimesh nepotike apo partiake, duke e hequr meritokracinë dhe nga një sistem kaq jetësor sa shëndetësia.
7. **Mungesë e vëmendjes për digjitalizimin e shëndetësisë.** Ndërkohë që gjithë sistemet shëndetësore, jo vetëm në Europë, por edhe në vende me të ardhura shumë më të ulëta se Shqipëria janë përfshirë në transformimin digjital të shëndetësisë, në Shqipëri mungojnë deri edhe bazat e nevojshme për digjitalizimin. Lidhur me mungesën e digjitalizimit duhet theksuar:
 - a. Mungon Kartela Elektronike e Pacientit në spitale dhe kujdesin shëndetësor parësor, duke bërë që informacioni ende të regjistrohet në kartela letre.
 - b. Sistemi i shkëmbimit të informacionit shëndetësor që u kushtoi taksapaguesve shqiptarë 14 milionë euro të përfituar nga kredia austriake, nuk dihet se në çfarë gjendje ndodhet.
 - c. Mungesë e përfshirjes së kompanive ndërkombëtare të cilat mund të sjellin dijenitë, aftësitë dhe përvojat e tyre, bazuar në nevojat e sistemit shëndetësor shqiptar.
8. **Mungesa e trajnimeve dhe përditësimit me njohuri bashkëkohore** të stafëve të kujdesit shëndetësor në nivel qendror, rajonal dhe kombëtar.

Drejt një shëndetësie që zgjat jetën dhe i jep vlerë asaj

Konservatorët shqiptarë synojnë rimëkëmbjen e sistemit shëndetësor shqiptar me qëllim që ky sektor të pushojë së qeni një burim fitimesh përrallore për një grusht oligarkësh dhe të rivendoset në shërbim të jetës dhe shëndetit të qytetarit.

Qëllimi dhe parimet drejtuese

Rimëkëmbja dhe reformimi i sektorit shëndetësor shqiptar do të udhëhiqet nga qëllimi fisnik i rritjes së jetëgjatësisë për çdo shqiptar, duke u kujdesur paralelisht që kjo jetëgjatësi të përkthehet në vite jete cilësore, të lira nga sëmundjet dhe të gëzuara në shëndet të plotë fizik, mendor dhe social.

Më shumë jetë viteve dhe vite jetëve!

do të jetë moto me të cilën do ta qeverisin shëndetësinë konservatorët shqiptarë.

Parimet bazë të reformës do të jenë:

- Riorganizim i sistemit shëndetësor sipas parimeve të **sistemit shëndetësor Bismark**.
- Ndërmarrja e **politikave të qëndrueshme**, të cilat mbështetin zhvillimin strategjik, parashikueshmërinë afatgjatë të programeve zhvillimore dhe ndërhyrjet e bazuara mbi evidenca.
- Vendosja në qendër të sistemit shëndetësor e **familjes shqiptare**, si bërthamë e zhvillimit të shëndetit komunitar dhe mbarëshoqëror.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit shëndetësor dhe qasjes së popullatës ndaj shërbimeve **cilësore dhe të përballueshme**.



- Financimi i sistemit shëndetësor bazuar në **skemën e sigurimeve shëndetësore**, duke theksuar përgjegjësinë individuale për shëndetin, por duke krijuar paralelisht rrjete të sigurta (*safety nets*) për grupet dhe shtresat e cënueshme të popullatës.
- Hartimi dhe zbatimi i programeve sektorialë afatshkurtër dhe afatmesëm, të cilët fokusohen tek grupet me nevoja prioritare, p.sh., **shëndeti i të moshuarve**, parandalimi dhe trajtimi i **sëmundjeve tumorale**, etj.
- Partneriteti Publik Privat: ndërsa qeveria aktuale e shtrembëroi në nivele tejet shqetësuese konceptin e PPP-ve, Partia Demokratike do t'i shfrytëzojnë ato për programe të zhvillimit të infrastrukturës shëndetësore dhe ofrim të shërbimeve plotësuese. PPP-të do të karakterizohen nga **kontrolli publik dhe llogaridhënia**.
- **Transformimi digjital** i sistemit shëndetësor do të nisë që muajt e parë të ardhjes në pushtet dhe do të synojë që brenda një mandati katër vjeçar kartela elektronike e pacientit të jetë zbatuar në çdo spital dhe të krijojë bazat e një shëndetësie moderne të digjitalizuar.

Zbatimi praktik i reformës

Në praktikë reforma do të zbatohet bazuar në këto hapa konkretë:

- Zbatim në faza të cilat herë do të ecin paralelisht dhe herë do të pasojnë njëra-tjetrën. Këto faza të detajuara do t'u paraqiten për vlerësim dhe miratim shqiptarëve në kuadrin e fushatës elektorale, së bashku me ekipin që do t'i zbatojë ato. Fazat që do të zbatohen të parat do të jenë ato që **adresojnë nevojat më prioritare shëndetësore të shqiptarëve**, si edhe ato që kanë ndikimin më të shprehur në shëndet bazuar në evidencat më të mira.
- Vendosja e shëndetit të **familjes në qendër të sistemit shëndetësor** kërkon programe të qarta të kujdesit për gruan shtatzënë dhe foshnjat, mbështetje për shëndetin e fëmijëve dhe të të rinjve, kujdes për njerëzit madhorë të të gjitha moshave, si dhe, sigurisht, kujdes për të moshuarit. Kujdesi në dy moshat ekstreme, fëmijëri dhe moshën e tretë do të kërkojë **harmonizim të parimeve konservatore të përgjegjësisë individuale për shëndetin me rrjetet e sigurisë** për të garantuar që shtresat e cënueshme do të marrin një kujdes shëndetësor cilësor dhe të përbalueshëm.
- Shfrytëzimi efikas i burimeve për shëndetin, ndërkohë që gradualisht rriten shpenzimet në vlerë absolute dhe në përqindje të Prodhimit të Brendshëm Bruto, për t'u **njehsuar brenda mandatit të parë me mesataren e rajonit** dhe për të synuar më pas mesataren e vendeve të reja të Bashkimit Europian. Prioritizim i shërbimeve bazë dhe eliminimi i shpërdorimeve do të sigurojë që burimet e që janë në dispozicion të shfrytëzohen me efikasitet.
- Iniciativat që mbështetin **kujdesin e bazuar mbi vlerën** do të bëjnë të mundur zbatimin e modeleve të rinj të kontraktimit për institucionet shëndetësore dhe të pagesës për profesionistët e kujdesit shëndetësor. Mjeku dhe infermieri do të kenë të drejtën e dy-punësimit bazuar në modele që synojnë krijimin e të ardhurave dinjitoze, duke respektuar të drejtat për punësim dhe duke u kujdesur për shëndetin e punës. Bazuar në vlerat konservatore do të garantohen **shpërblimi sipas kontributit** dhe shpërblimi sipas arritjeve duke pasur si synim përfundimtar **përfitimet e matshme në shëndet**.
- Zhvillimi i burimeve për shëndetin, duke nisur nga burimet njerëzore, infrastruktura dhe pajisjet mjekësore. Në veçanti, **zhvillimi strategjik i burimeve njerëzore** për të dalë nga humnera rilindëse do të përbëjë një prej **prioriteteve më urgjente**, duke synuar që të vendosen bazat për një raport në rritje të personelit mjekësor dhe popullatës.



- Ofrimi me prioritet i programeve të parandalimit dhe kujdesit shëndetësor parësor, si programe që mundësojnë kosto-efektivitet të lartë (raport të lartë midis përfitimeve dhe shpenzimeve) dhe ndikim të drejtpërdrejtë në **shëndetin e individit, familjes, komunitetit dhe popullatës**. Promocioni i shëndetit, parandalimi parësor dhe diagnoza e hershme (parandalimi dytësor) do të kenë vëmendjen më të lartë dhe prioritare. Kjo do të ulë në afatgjatë barrën e sëmundjeve dhe do të ulë shpenzimet aktuale, duke lejuar që këto fonde të riinvestohen në fusha të tjera prioritare, digjitalizim dhe modernizim të sistemit.
- Fuqizimi i diagnozës dhe trajtimit të hershëm do të lejojë ndërhyrjet mjekësore të kenë efektivitet të lartë dhe kosto gjithmonë e më të ulëta. Qëllimi do të jetë shërimi, ngadalësimi i ecures së sëmundjeve dhe parandalimi i ndërlikimeve, ulja graduale e nevojës për trajtime spitalore dhe, përfundimisht, ulja e kostove të shërbimit, duke krijuar mundësi që **kursimet të përdoren në fusha të tjera prioritare**.
- Digjitalizimi gradual i sistemit shëndetësor, do ta sjellë këtë gjithmonë e më pranë **transformimit digjital**, për të krijuar një ekosistem shëndetësor të lidhur, që mundëson **vendosjen në qendër të familjes**, garanton vazhdimësinë e kujdesit shëndetësor, lejon përdorimin e sigurt dhe të bazuar mbi konsensusin e qytetarit të të dhënave shëndetësore për trajtim, politikë-bërje dhe kërkim shkencor. Temat si shëndeti digjital, telemjekësia, shëndetësia elektronike dhe inteligjenca artificiale nuk do të jenë thjesht demagogji e qeverisë, por përafrime të rëndësishme të ofrimit të kujdesit shëndetësor në dobi të shëndetit dhe jetës së qytetarit.
- **Sistemi shëndetësor privat** është bërë sot një pjesë e rëndësishme dhe jetësore e sistemit shëndetësor shqiptar. Shumë nga defektet dhe mangësitë e tij e kanë bazën tek përafrimi i qeverisë ndaj sektorit privat që e sheh këtë si pronë të oligarkëve dhe jo të sipërmarrësve të ndershëm dhe të atyre mijëra mjekëve, stomatologëve, farmacistëve, dhe pjesëtarëve të shërbimeve të asociuara shëndetësore që kanë qenë themelues të sektorit shëndetësor privat në Shqipëri. Duke i parë këta si **partnerë të barabartë** dhe duke i vendosur ata në **kushte të njëjta konkurrence** me ofruesit publikë, krijohet mundësia që kontributi i tyre në shëndet të jetë i plotë dhe domethënës.

Përfundim

12 vitet e fundit të qeverisjes socialiste e kanë kthyer shëndetësinë, si çdo sektor tjetër të jetës ekonomike-sociale të vendit, në një shkretëtirë. Afërsisht 500 milionë euro ka qenë vetëm fatura e katër koncesioneve mashtruese. Ndërkohë që një pjesë e ideuesve dhe zbatuesve të tyre sot janë duke dhënë llogari para drejtësisë dhe ndodhen pas hekurave, ata mbajnë vetëm një pjesë të vogël të fajit dhe janë duke u përdorur si koka turku për të mbuluar fajtorët e vërtetë dhe frymëzuesit politikë të kësaj grabitje të pashoqe.

Pasojat që vuan sistemi shëndetësor shqiptar janë të qarta dhe, siç u paraqitën në këtë dokument, përfshijnë shpenzime të pamjaftueshme për frymë, ndër më ulëtat në Europë, shpenzime marramendëse nga xhepi i qytetarit, ndër më të lartat në Europë dhe në botë, raportin më të ulët të numrit të mjekëve për banorë në Europë dhe, ajo që është më e rënda, përkeqësim dramatik të treguesve të shëndetit të qytetarit, ku spikat për keq shkalla e lartë e vdekshmërisë foshnjore

Shëndetësia shqiptare ka nevojë për një program i cili do të drejtohet nga parime të qarta konservatore dhe do të harmonizojë nevojat shëndetësore të shqiptarëve me mundësitë dhe zhvillimin strategjik të burimeve për shëndet. Zbatimi i këtij programi nga një ekip me vizion, njohuri dhe vullnet për ta zbatuar atë do të bëjë të mundur që shqiptarëve t'u shtohen vitet e jetës, ndërkohë që cilësia e jetës përmirësohet.



Duke ndjekur parimet konservatore të përgjegjësisë individuale për shëndetin, financimit nëpërmjet skemave të sigurimeve shëndetësore, vendosjen në qendër të sistemit shëndetësor të familjes dhe nevojave shëndetësore të saj, partneritetin me sektorin shëndetësor privat, skemat transparente dhe llogaridhënese të PPP-ve, etj., dhe duke i harmonizuar këto parime me krijimin rrjeteve të sigurisë (safety nets), do të mundësohet një sistem shëndetësor cilësor, i përballueshëm, kosto-efektiv, kur çdo qytetar ka qasje dhe që ka në qendër familjen shqiptare si gur themeli i shëndetit të komunitetit dhe gjithë shoqërisë

7. Dekomunistizimi

Pjesa e Parë: Për Dekomunistizimin e shoqërisë shqiptare dhe rehabilitimin e plotë të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë. (Draft konsultimor, hartuar nga Lindita Komani)

(Referencë: “Program i Integritetit të të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë”, vënë në dispozicion nga Z.Besim Ndregjoni, Unioni Mbarëkombëtar i Integritetit të të Burgosurve e të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë)

Sistemi komunist shkaktoi plagën më të thellë shoqërore që Shqipëria ka përjetuar në gjysmën e dytë të shekullit XX. Këto plagë ende vijojnë të ndikojnë në jetën e njerëzve që i mbijetuan diktaturës komuniste dhe familjeve të tyre.

Ky krim i padënuar sistematik i përngjan një bilanci lufte me: 5.037 burra dhe 450 gra të ekzekutuar për motive politike, 21.788 burra dhe 7.367 gra të dënuar me burgosje politike, 48.217 burra dhe 10.792 gra të internuar për motive politike, 11.536 familje të dëbuara nga qytetet kryesore dhe nga zonat kufitare, 64 shtetas të huaj të pushkatuar apo vdekur në burgjet shqiptare, 1.215 burra dhe 38 gra të huaja me kombësi jo shqiptare të burgosur, 95 shqiptarë të Kosovës të pushkatuar, 120 klerikë katolikë të ekzekutuar dhe burgosur, 83 klerikë bektashianë të ekzekutuar dhe burgosur, 60 klerikë myslimanë të ekzekutuar dhe burgosur, 39 klerikë ortodoksë të ekzekutuar dhe burgosur, 2.169 institucione fetare të shkatërruara dhe mbyllura (ref. Unioni Mbarëkombëtar i Integritetit të të Burgosurve e të Përndjekurve Politikë, 2024).

Tri dekada pas ngritjes së sistemit post-komunist është koha e duhur për të bërë një bilanc të strategjive e masave të ndërmarra nga qeveritë shqiptare ndër vite për trajtimin e dëmeve që shkaktoi komunizmi mbi individin, shoqërinë, ekonominë dhe politikën shqiptare dhe për dekomunistizimin e qëndrueshëm të Shqipërisë dhe rezultateve që janë arritur përmes zbatimit të tyre. Ky bilanc është i nevojshëm për të kuptuar se çfarë është ende e nevojshme për t'u bërë nga qeveria e Partisë Demokratike për t'i dhënë fund padrejtësisë dhe diskriminimit shoqëror, ekonomik e politik ndaj të përndjekurve në kohën e diktaturës komuniste dhe familjeve të tyre.

Masa të ndërmarra ndër vite

Qeveritë shqiptare ndër vite kanë fokusuar vëmendjen në masat për trajtimin e dëmeve me qëllim që viktimat e mbijetuara të komunizmit dhe pasardhësit e tyre të rifitojnë të drejtat si të gjithë qytetarët e tjerë dhe të integrohen në një shoqëri demokratike me të drejta të barabarta. Ndër këto masa mund të numërohen:

- Puna për kuadrin ligjor e cila është zhvilluar kryesisht në vitet 1992 – 1997, e shoqëruar me shtesa, ndryshime ose shfuqizime në vijim. Ky kuadër ligjor ka pasur për tematikë: pafajësinë e të dënuarve të komunizmit; njohjen e gjenocidit të kryer nga shteti komunist mbi viktimat e tij; kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik; statusin e të persekutuarve politikë; dëmshpërblimin për ish-të dënuarit dhe ish-të përndjekurit; kthimin dhe kompensimin e pronave; përcaktimin e disa simboleve, në përkujtim të viktimave dhe krimeve të shkaktuara nga regjimi komunist në Shqipëri.
- Realizimi i masave që parashikohen në kuadrin ligjor.



- Përfshirja me kuota të posaçme si studentë në sistemin arsimor universitar dhe punonjës në institucione shtetërore të viktimave të komunizmit dhe pasardhësve të tyre.
- Krijimi, financimi dhe mbarëvajtja e institucioneve që trajtojnë pjesë të veçanta të krimit komunist dhe kujdesen për integrimin e të përndjekurve si: Instituti për Studimin e Krimeve të Komunizmit (2010), Instituti i Integritetit të të Përndjekurve Politikë (1997) si dhe Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 1944-1991 (2016).

Një pjesë e mirë e masave nuk janë zbatuar ende. Mes tyre vlejnë të nxirren në pah veçanërisht:

- Mospërfundimi ende 32 vjet pas ngritjes së sistemit postkomunist i dëmshpërblimit të ish-të dënuarve dhe ish-të persekutuarve
- Mospërfundimi i procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave
- Mosrealizimi i Muzeut Kombëtar të Viktimave dhe të Krimeve të Komunizmit, ngritja e Obeliskut të Viktimave dhe të Krimeve të Komunizmit në Tiranë, si dhe të monumenteve përkujtimore në qytetet e tjera në Shqipëri, që janë parashikuar për realizim përmes ligjit nr.10241, dt.25.02.2010.

Vëmendja e qeverive shqiptare ndër vite ka qenë tek viktimat por jo tek kriminelët që orkestruan dhe zbatuan shfarosjen dhe dëmtimin në shumë raste pa kthim të jetës së dhjetëra mijëra shqiptarëve. Për pasojë, ende sot nuk është dije publike lista e saktë e gjithë aparatit kriminel që kreu vrasjet, hetimet, torturimet, burgimet e persekutimin e njerëzve. Njohuri publike të fituara vijnë kryesisht nga dëshmitë e viktimave të komunizmit përmes librave që kanë shkruar ata vetë, intervistave në media e ndonjë filmi dokumentar si dhe studimeve që mund të jenë kryer ndër vite në rrafsh privat nga organizata jo-qeveritare, nga hulumtues shkencorë pranë universiteteve dhe në 13 vitet e fundit edhe në Institutin e Studimit të Krimeve të Komunizmit.

Roli i veçantë i Partisë Demokratike

Puna për kuadrin ligjor për trajtimin dhe dhënien e zgjidhjeve për dëmet e shkaktuara gjatë periudhës së qeverisë mbi të përndjekurit politikë në Shqipëri është zhvilluar kryesisht në periudhat e qeverisjes së Partisë Demokratike 1992-1997 dhe 2005-2013. Për sa i takon pjesës politike-shoqërore, veçanërisht vlejnë të theksohen:

- Ligji nr.7514, dt.30.09.1991 dhe ndryshimet e tij në vitin 1993 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”. Ky ligj i hapi rrugën riintegritetit në çdo fushë të jetës së njerëzve të dënuar dhe të përndjekurve politikë gjatë diktaturës komuniste.
- Ligji nr.7598, dt.1.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë” dhe VKM 40 kushtuar ndihmës ekonomike e VKM 184 për dhënien e kompensimit pasuror për ish të dënuarit dhe përndjekurit politikë nga sistemi komunist.
- Ligji nr.8001, dt.22.09.1995 “Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”. Ky ligj përcaktonte në nenin 3 që:

“Nuk mund të zgjidhen paskëtaj në organet qendrore dhe lokale të pushtetit dhe as të emërohen në administratën e lartë të Shtetit, në sistemin gjyqësor dhe në masmedia, deri në 31 dhjetor 2001 autorët, ideatorët dhe zbatuesit e krimeve të mësipërme, që kanë qenë deri më 31 mars 1991: ish- anëtarë të Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror të PPSH (dhe PKSH), ish-ministra dhe ish- deputetë të Kuvendit Popullor, ish-anëtarë të Këshillit Presidencial, ish-kryetarët e Gjykatës së Lartë, ish-Prokurorët e Përgjithshëm, ish-sekretarë të parë të rretheve, ish-punonjës të Sigurimit të Shtetit, ish-bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit si dhe denoncuesit dëshmitarë në dëm të të pandehurve në proceset politike, me



përfashtim të rasteve kur kanë vepruar kundër vijës zyrtare dhe janë larguar vetë në mënyrë publike.”

Rebelimi komunisto-banditesk i vitit 1997 pati mes të tjerash dy pasoja të rëndësishme në fatin e këtij ligji dhe efektit që do të kishte ai mbi shoqërinë shqiptare. Nën forcën e këtij rebelimi, në prag të zgjedhjes të parakohshme u miratua ligji nr.8219, dt.13.05.1997 dhe pas ardhjes në pushtet të Partisë Socialiste u miratua ligji nr.8231, dt.9.08.1997 të cilët e ndryshonin shumë ligjin nr.8001.

Ligji 8219, neni 3:

"Nuk mund të zgjidhen paskëtaj deputetë në Kuvendin Popullor dhe kryetarë bashkie dhe as të emërohen në administratën e lartë të shtetit, në sistemin gjyqësor dhe në masmedia, deri në 31 dhjetor 2001 autorët, ideatorët dhe zbatuesit e krimeve të mësipërme, që kanë qenë ish-anëtarë të Byrosë Politike, ish-punonjës të Sigurimit të Shtetit, ish-bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit, denoncuesit dëshmitarë në dëm të të pandehurve në proceset politike, me përfashtim të rasteve kur kanë vepruar kundër vijës zyrtare dhe janë larguar vetë në mënyrë publike, si dhe personat e dënuar me vendim të gjykatës për krime kundër njerëzimit.

Ligji 8231, neni 3:

Në ligjin nr. 8001, datë 22.9.1995 "Për genocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike e fetare", ndryshuar me ligjin nr.8219, datë 13.5.1997, në nenin 3, në paragrafin e parë hiqen fjalët:

"zgjidhen paskëtaj deputetë në Kuvendin Popullor dhe kryetarë bashkie dhe as të".

- Rezoluta, dt.30.10.2006 "Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri", e cila referuar "Rezolutave të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës dhe konkretisht: Rezolutës 1096 (1996) "Masat për të çrrënjësuar trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste"; Rezolutës 1481 (2006) "Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste", si dhe vendimeve të Konventës së Parë Kombëtare të Shoqatës Mbarëkombëtare për Integrimin e të Përndjekurve Politikë dhe Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës "Për dënimin e krimeve të komunizmit në Shqipëri", datë 12.5.2006", parashikonte 17 pika reflektimi dhe veprimi, nga të cilat pjesa më e madhe nuk janë vënë ende në jetë.
- Ligji nr. 10241, dt.25.02.2010 "Për simbolet e përkujtimit të viktimave dhe të krimeve të komunizmit në Shqipëri", i cili shpallte datën 20 Shkurt, ditën e rrëzimit të monumentit të ish-diktatorit Enver Hoxha, si "Dita e përkujtimit të viktimave dhe të krimeve të komunizmit në Shqipëri" dhe ngarkonte Këshillin e Ministrave të krijonte Muzeun Kombëtar të Viktimave dhe të Krimeve të Komunizmit në Shqipëri e të nxirrte aktet e nevojshme nënligjore për ngritjen e Obeliskut të Viktimave dhe të Krimeve të Komunizmit në Tiranë, si dhe të monumenteve përkujtimore në qytetet e tjera të Shqipërisë. Sikurse mund të konstatohet sot në vitin 2024, ky ligj ende nuk është vënë në zbatim.

Mungesa të konstatuara

Përqasja e qeverive shqiptare ka pasur për qëllim kryesisht faljen nga ana e viktimave të keqbërësve të tyre, por jo njohjen e fajit nga ana e keqbërësve, kërkesën për falje dhe dënimin e tyre. Për pasojë, pajtimi dhe paqja shoqërore mes viktimave dhe keqbërësve të tyre, e lidhur drejtpërdrejt me konceptin e drejtësisë, nuk ka ndodhur ende. Në një shoqëri të papajtuar dhe ku nuk është vënë drejtësi, integrimi i viktimave dhe pasardhësve të tyre mund të jetë vetëm i metë.



Qeveritë shqiptare ndër vite nuk kanë marrë masa të mjaftueshme për rehabilitimin fizik dhe mendor të viktimave të komunizmit dhe asistimin psikologjik ndër vite si për viktimat ashtu edhe për pasardhësit e tyre.

Qeveritë shqiptare ndër vite nuk kanë marrë gjithashtu asnjë masë të posaçme për të realizuar dekomunistizimin e qëndrueshëm të shoqërisë shqiptare pavarësisht njohurive të plota mbi përmasat e krimeve dhe dëmeve të shkaktuara nga regjimi komunist në Shqipëri. Për pasojë, sot në televizionet kombëtare dhe lokale shqiptare ende transmetohen filma të realizuar nga Kinostudio “Shqipëria e Re” pa asnjë lloj filtri dhe informimi për publikun lidhur me filmat dhe regjimin në të cilin ata u realizuan. Një brez i tërë të rinjsh të lindur në vitet e fundit të komunizmit e në vijim janë rritur duke i parë këto filma që paraqesin një realitet të lumtur komunist të shoqëruar me portretin e diktatorit në sfond dhe dënimin e viktimave të komunizmit, talljen e figurave publike të kthyer në personazhe të filmave, përfshi këtu edhe pjesëtarë të klerit. Rezultat i drejtpërdrejtë i këtij keqzhvillimi është që tek shumë të rinj është krijuar një perceptim tejet i metë dhe i gabuar dhe nostalgji për një regjim mizor si ai komunist, për të cilin, në mungesë të informacionit të marrë në familje e shkolla, ata nuk kanë asnjë prekje direkte përveç shikimit të këtyre filmave. Ka pasur ndërkohë diskutime publike mes artistësh, shkrimtarësh, studiuesish e intelektualësh lidhur me si duhen trajtuar produktet artistike-letrare të periudhës së komunizmit por nuk ka një njëmendësim në mes tyre lidhur me këtë temë.

Në vitin 2016, Kontrolli i Lartë i Shtetit në kohën e drejtimit nga Z.Bujar Leskaj nga Partia Demokratike, kreu auditimin e performancës “Rehabilitimi i ish-të Përndjekurve Politikë në Periudhën e Tranzicionit”, i pari i këtij lloji në Shqipëri, rezultatet e të cilit u shpallën në vendimin nr.86, dt.30.06.2016. Auditimi u ushtrua në Institutin e Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë, Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave. Përmes këtij auditimi, KLSH u përpoq t’i japë përgjigje pyetjes: “A i ka shërbyer rehabilitimit të plotë të ish-të përndjekurve politikë, kuadri ligjor i miratuar dhe masat e marra për këtë qëllim gjatë periudhës së tranzicionit?”. Përfundimi në të cilin arriti KLSH shprehet në këtë mesazh auditimi:

“Kuadri ligjor i miratuar dhe masat e marra nga Ekzekutivi në periudhën e tranzicionit për Rehabilitimin e ish-të dënuarve e të përndjekurve politikë në vendin tonë i kanë arritur pjesërisht objektivat, nuk kanë siguruar plotësisht dhe kanë dështuar në rehabilitimin e kësaj shtrese të shoqërisë në një kohë optimale. Dispozitat ligjore kanë qenë të fragmentarizuara dhe jo gjithëpërfshirëse, burimet financiare të pamjaftueshme dhe ka munguar bashkëpunimi i duhur e koordinimi i punës së institucioneve shtetërore për t’i ardhur në ndihmë ish-të dënuarve e të përndjekurve politikë. Shoqëria shqiptare i ka mundësitë për dëmshpërblimin material dhe rehabilitimin e arsyeshëm të këtij grupi shoqëror në një kohë optimale, duke iu përgjigjur kështu detyrimeve ligjore dhe atyre të përcaktuara në Konventat Ndërkombëtare, që ka marrë përsipër me vendosjen e shtetit të së drejtës, për mbylljen e kësaj plage shoqërore në vendin tonë”.

Propozim për programin zgjedhor të Partisë Demokratike për Zgjedhjet Parlamentare të Vitit 2025

Duke vlerësuar përpjekjet e bëra, por duke reflektuar thellësisht mbi mangësitë që ka pasur vetë përfaqësja e Partisë Demokratike në trajtimin e kësaj plage shoqërore ndër vite, edhe në periudhat e saj në krye të qeverisë së Shqipërisë, programi për dekomunistizimin dhe rehabilitimin e plotë të ish-të dënuarve dhe përndjekurve politikë si pjesë e programit të Partisë Demokratike për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 përmban sa vijon:

Dekomunistizimi

- Çelje dhe mbështetje në çdo drejtim e zhvillimit të një procesi reflektimi të thellë publik mbi sistemin komunist, dëmet dhe plagët e rënda shoqërore dhe politike që ai shkaktoi në Shqipëri. Në vazhden e këtij procesi, Partia Demokratike do të udhëhiqet nga parimet e parashikuara në



Rezolutën e vitit 2006 “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri” dhe do të zbatohet të gjitha pikat e parashikuara në të, përkthyer edhe në masa konkrete sikurse janë parashikuar në ligjin nr.10241, dt.25.02.2010 “Për simbolet e përkujtimit të viktimave dhe të krimeve të komunizmit në Shqipëri”.

- Kryerja e lustracionit dhe hapja e dosjeve.
- Më konkretisht, Partia Demokratike zotohet për hartimin dhe zbatimin në bashkëpunim me organizatat përfaqësuese të ish-të dënuarve dhe përndjekurve politikë (si psh Unioni Mbarëkombëtar i Integritetit të të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë etj.) të një plani veprimi për:
 - Rritjen e pensionit të paktën në nivelin e minimumit jetik për ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë të cilët nuk kanë mundësi të tjera ekonomike, mbështetje nga familja ose nuk kanë pasardhës.
 - Ndjekje me prioritet dhe zgjidhje e çështjes së banimit për ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë të cilët ndonëse mund të kenë pasur nevojë ende nuk kanë marrë mbështetje të posaçme në këtë drejtim dhe jetojnë në kushte të rënda.
 - Ndonëse shumë e vonuar në kohë, zhvillim i një fushate mbarëkombëtare për të ofruar mbështetje psikologjike-psiqike të posaçme për ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë dhe familjet e tyre për të minimizuar efektet e traumës së drejtpërdrejtë dhe asaj të trashëguar si dhe pasojave të saj.
 - Ngritjen e Muzeut Kombëtar të Viktimave dhe të Krimeve të Komunizmit në Shqipëri.
 - Ngritjen e Obeliskut të Viktimave dhe të Krimeve të Komunizmit në Tiranë, si dhe të monumenteve përkujtimore në qytetet e tjera të Shqipërisë.
 - Kthimin në muze të disa prej burgjeve dhe kampeve të internimit (përfshi Burgun e Spaçit, Burrelit, etj.).
 - Nderimin pas vdekjes së figurave kyçe antikomuniste shqiptare, përfshi organizatorët e Revoltës së Spaçit dhe vendosjen e emrave të tyre për emërtim rrugësh e sheshesh.
 - emërtimin e një sheshi në Tiranë në nderim të revoltës së Spaçit ku të vendosen monumentet e heronjve të kësaj revolte Pal Zefi, Hajri Pashaj, Dervish Bejko, Skënder Daja dhe një mur me emrat e të ridënuarve të revoltës.
 - Rishikimin e datës së Ditës Përkujtimore të Viktimave të Komunizmit në vijim të procesit të reflektimit dhe të diskutimit me organizatat përfaqësuese të ish-të dënuarve dhe përndjekurve politikë, në rast se do të konsiderohet e nevojshme (një sugjerim vjen nga Unioni për datën 24 Janar 1945, data e kryengritjes së parë antikomuniste).
 - Realizimin e një seance dëgjimore në Kuvendin e Shqipërisë për krimet e komunizmit ku të referojnë të mbijetuarit e diktaturës.
 - Mbështetje të plotë për realizimin e një konference të përvitshme me rastin e Ditës Përkujtimore të Viktimave të Komunizmit, për ndarjen e rezultateve të studimeve më të fundit lidhur me krimet e komunizmit dhe dëmet mbi viktimat e tij ndërmjet studiuesve, politikëbërësve, përfaqësuesve të viktimave të komunizmit dhe publikut të gjerë, konferencë e cila do të shoqërohet me zhvillimin e një seance përkujtimore në Kuvendin e Shqipërisë për viktimat e komunizmit.

Për të mundësuar dekomunistizimin e qëndrueshëm të shoqërisë shqiptare, masat që do të ndërmerren janë mes të tjerash:

- Dhënia e një mandati të qartë politik një ministrie përkatëse, e cila do të hartohet brenda njëqind ditëve të para të qeverisë, dhe zbatohet, në bashkëpunim me partnerët dhe palët e interesuara, një program katërvjeçar, i cili do të orientohet nga këto objektiva dhe drejtime punë kryesore:



- Dënim i krimeve të komunizmit me ligj dhe njohje e fajit shtetëror e kërkim i faljes ndaj viktimave të komunizmit në Shqipëri, përfshi këtu edhe për krimet e kryera ndaj klerit (klerikëve dhe objekteve të kultit).
- Ndjekje me prioritet dhe realizim i rishikimit të teksteve shkollore për të reflektuar në mënyrë të domosdoshme realitetin e komunizmit, dëmet dhe plagën shoqërore që ai krijoi, rezultate të punës studimore së kryer deri më sot që reflektojnë pasojat e tij mbi njerëzit dhe shoqërinë shqiptare, por edhe më gjerë në vendet e tjera që u drejtuan nga sistemi komunist, masat e ndërmarra në vite për rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe përndjekurve politikë, përmbajtjen e ligjeve kryesore dhe rezolutës për dënimin e krimeve të komunizmit. Si pjesë e programit shkollor do të përfshihet zhvillimi i ekskursioneve për shkollat e mesme në vendet më të njohura për krimet e kryera (burgjet si ai i Spaçit, kampi i Tepelenës e më gjerë).
- Pezullim i shfaqjes në televizionet shqiptare (kombëtare, lokale, publike dhe private) deri në përmbylljen e një procesi shqyrtimi dhe filtrimi të gjithë fondit të filmave të realizuar nga Kinostudioja “Shqipëria e Re” dhe materialeve të regjistruara të pjesëve teatrale të vëna në skenë në kohën e komunizmit, me qëllim pengimin e përhapjes së të pavërtetave, fyerjeve ndaj ish-të dënuarve e të përndjekurve politikë, si dhe glorifikimit të pabazë të sistemit komunist dhe figurave drejtuese të tij si dhe jetës shoqërore në atë sistem.
- Rritje e mbështetjes me fonde për Institutin e Studimit të Krimeve të Komunizmit dhe mbështetje për organizatat të cilat zhvillojnë hulumtime dhe aktivitete për zbulimin e krimeve të komunizmit dhe dëmeve të shkaktuara prej tij në Shqipëri.

Pjesa e Dytë: Platformë e Partisë Demokratike të Shqipërisë mbi dekomunistizimin e Kurrikulave Shkollore dhe Arsimit shqiptar. (Agron Tufa dhe Lindita Doda)

Vendet e tjera ish-komuniste e bënë një ndarje e qartë, serioze dhe reale, e të përgjegjshme për brezat me trashëgiminë e komunizmit. Në Shqipëri kjo nuk ndodhi. Nuk ndodhi as në elitat politike dhe as në trashëgiminë tonë kulturore. Përveç qëndrimit të dyzuar të elitave politike që drejtuan vendin kjo erdhi dhe nga indiferentizmi e papërgjegjshmëria e aktorëve shoqërorë e akademikë në ndërtimin real, serioz të sistemit tonë shkollor, thënies së të vërtetës sonë historike të periudhës sonë të afërt të sistemit komunist.

Sidomos në dhjetëvjeçarin e fundit janë ngjallur reminishenca të së kaluarës në çdo sektor të jetës, nga qeverisja, gjyqësori e deri në jetën shoqërore dhe kulturore. Kjo e keqe po ngjall dhe një frymë të alergjisë nga mashtrimet dhe përpjekja për t'i mbyllur përgjithmonë rrugët e njohjes së historisë tonë më të afërt që është diktatura.

Është thelbësore që Partia Demokratike të riformulojë boshtin e saj ideologjik si forcë politike e vlerave të lirisë së individit, për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare kësaj çështje, pasi nxënësit dhe të rinjtë e sotëm nuk kanë dijet e duhura për komunizmin në Shqipëri.

Për këtë arsye është i rëndësishëm së pari dekomunistizimi i kurrikulave dhe teksteve shkollore. Studimi i kurrikulave dhe i altertekteve shkollore të rishikohet nga një grup ekspertësh të cilët të përqëndrohen në trajtimin e real të historisë, ekonomisë dhe letërsisë në periudhën komuniste. Të pasqyrohet realiteti komunist në programet mësimore të hartuara para dhe pas vitit '90. “Bazuar në sondazhin e realizuar me mësues nga IDMC Albania në vitin 2020, 60% e mësuesve të anketuar nuk janë të sigurtë cila është shifra e viktimave të regjimit komunist pasi ajo nuk përmendet në tekstet e historisë.”

Kjo e dhënë tregon se ka një mungesë të konsiderueshme të informacionit qoftë në kurrikulat mësimore në shkolla por edhe në kurrikulat universitare në fushën e mësuesisë.



Duhet të dokumentohen dhe të bëhen të njohura nëpër shkolla dhe në universitete të gjitha ngjarjet e rëndësishme, mes diagramës së terrorit nga viti 1942 deri në vitin 1991; të hidhet dritë mbi të kaluarën komuniste të vendit, duke bërë që kjo e kaluar të futet në librat shkollorë të të gjitha brezave, në mënyrë që ata të mos mbeten viktimë e mashtrimeve historike.

Të identifikohen si data të rëndësishme historike të qëndresës dhe lirisë kryengritjet kundër regjimit si kryengritja e Qafë Barit, Spaçit, kryengritja e Zhapokikë, gjyqet famëkeqe dhe dënimet e elitës së kombit etj.

Nevojitet të identifikohet numri real i personave të ekzekutuar dhe të zhdukur në periudhën komuniste i cili është shumë herë më i lartë nga ai çfarë është deklaruar. Të trajtohen me statusin e dëshmorit të atdheut e jo thjesht si viktima revoltash të armatosura dhe dënime formale të tyre. Ka një nevojë emergjente që të ndalohet përdorimi i simboleve komuniste në publik.

Me konkretisht, propozimet për dekomunistizimin përmes ndërhyrjeve në arsim janë si më poshtë:

1. Partia Demokratike e Shqipërisë, me të ardhur në pushtet, duhet të hartojë një ligj për Arsimin Kombëtar, që ndalon riciklimin e trashëgiminë së ideologjisë komuniste në tekstet shkollore, mundësisht edhe universitare.
2. Platformën e dekomunistizimit të teksteve shkollore, të mbështetur në ligj të posaçëm, pushteti i Partisë Demokratike ta zbatojë përmes Ministrisë së Arsimit.
3. Ministria e Arsimit duhet të ngejë, konfigurojë e të bashkërendojë grupe specialistësh dhe ekspertësh në lidhje me specifikën e problemeve të teksteve shkollore ekzistuese.
4. Ministria e Arsimit me grupet e ekspertëve shkencorë, të hyjnë në marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e specializuara (Institute, Shoqata, Departamente Universitare dhe specialistë të njohur për trajtimin e së shkuarës diktatoriale komuniste të shoqërisë), ku të shqyrtohen ngushtë strategjitë e qasjes ndaj problemeve dhe vështirësive që duhen paraparirë.
5. Ministria e Arsimit duhet të mbështesë grupet e ekspertëve dhe konsulentëve për të ndërmarrë një evidentim rrënjësor të kurrikulave shkollore (altertektet) në nivelet e shkollave të detyrueshme (klasat VI-IX) dhe Gjymnazet për periudhën e diktaturës komuniste.
6. Ministria e Arsimit që koordinon grupet e specialistëve, të mbikëqyrë e të vlerësojë evidentimin e problemeve në tekstet shkollore, të vlerësojë shkallën e kontaminimit me trashëgiminë ideologjike komuniste dhe vijimin e glorifikimit të saj dhe të diskutojë me hollësi e vendosë për rishikimin e kurrikulave.
7. Ministria e Arsimit me instrumentat e saj (grupet e ekspertëve dhe konsulentëve), me të drejtën që i jep ligji, të fillojë zbatimin e Platformës së Dekomunistizimit të teksteve shkollore si inerci e trashëgimisë totalitare, duke nisur me shmangien e kësaj përmbajtjeje në altertektet ekzistuese shkollore, përplotësimin e tyre me informacione apo materiale të vërteta dhe edukative, sipas profilit të lëndës.
8. Rishikimi të përfshijë (siç pritet) lëndët e formimit humanitar (Histori, Letërsi, Filozofi, Edukatë qytetare apo Njohuri Shoqërore).
9. Ministria e Arsimit duhet të bëjë hap vendimtar e kulmor, si kushtin më të domosdoshëm e garantues në këtë drejtim: hartimin dhe futjen në kurrikulën e sistemit shkollor të detyrueshëm dhe të gjymnazeve të lëndës me titull “Shqipëria gjatë diktaturës komuniste: 1944-1991”.



10. Teksti të hartohet nga një grup autorësh, ekspertë për periudhën historike në fjalë dhe të ruajë karakterin e informimit të hollësishëm, dokumentar e antropologjik.

11. Grupi i autorëve të hartimit të lëndës së detyrueshme kurrikulare të zgjidhet nga ekspertë të historisë, kulturës, ligjeve, ekonomisë, etj., që janë të specializuar për periudhën 1944-1991. Ministria e Arsimit dhe qeveria shqiptare duhet t'i garantojnë grupit të ekspertëve që hartojnë lëndën "Shqipëria gjatë diktaturës komuniste: 1944-1991" akses të lirë në arkivat shtetërorë e institucionale (AQSH, Arkivi i MPB, AIDSSH, IKK etj).

12. Kompozimi i lëndës kurrikulare "Shqipëria gjatë diktaturës komuniste: 1944-1991" të kryet sipas sferave shoqërore, ku regjimi stalinist shqiptar ushtroi terrorin, skllavërimin dhe tjetërsimin e shoqërisë: likuidimi i sferës ekonomike (zhdukja e tregut privat, e pronës private, sekuestrimet e pasurive të luajtshme e të paluajtshme, shfarosja e klasës së pronarëve të tokave, fabrikantëve, tregtarëve, zanatçinjve, etj); likuidimi i sferës religjioze (ndërhyrja dhe trysnia për ndryshimin e statuteve të komuniteteve fetare dhe nënshtrimi i tyre, shembja e tempujve të besimit, arrestimi, dënimi dhe pushkatimi i klerikëve, ndalimi me ligj i besimeve fetare); likuidimi i klasave: terrori i ushtuar si hakmarrje mbi ish-pronarët, shtresën e mesme, kundërshtarët, përndjekja e tyre, burgosjet, internimet; likuidimi i drejtësisë: drejtësia e popullit, gjyqet masive demaskuese (gjyqi special, gjyqi i deputetëve, etj), suprimimi i Ministrisë së drejtësisë, rënia e avokatit mbrojtës, etj.; likuidimi i kulturës kombëtare: ndalimi i një vargu shkrimtarësh të mëdhenj që kishin qenë edukatorë kombëtarë, shpallja e tyre armiq (Faik Konica, Gjergj Fishta dhe shkrimtarët katolikë, Ernest Koliqi, Arshi Pipa, Martin Camaj, etj.), ndërprerja e trashëgimisë dhe varrosja e gjuhës letrare geqe dhe e kulturës së saj; sundimi i dogmës ideologjike të realizmit socialist si nënshtrim pa kushte në shërbim të diktaturës – mutantizimi i kulturës; sfera arsimore: përgatitja sipas një zinxhiri të pandërprerë zombifikues të gjeneratave shkollore, që nga çerdhet deri në Universitet; Bujqësia dhe Industria – planet pesëvjeçare dhe zbulimi i grupeve armiqësore deli në falimentin total në fund të viteve 1980; rendi dhe siguria: mbizotërimi i terrorit të pandërprerë, sistemi i kolonive ndëshkimore, burgjeve dhe internimeve, roli gjakatar i drejtësisë komuniste, pushteti i pakufizuar i Sigurimit të Shtetit, ai arma besnike e PPSH, si polici politike përndjekëse që ushtroi gjenocid mbi qytetarët shqiptar, etj.

13. Për hartimin e këtij teksti kyç, të detyrueshëm në kurikula, duhen zgjedhur ekspertë e njohës, konsultues të çdo sfare, pa lejuar kurrësi hartimin e tekstit nga një dorë apo dyshe e vetme.

14. Teksti të përmbajë, sipas çdo sfare tematike, një dokument real njerëzor, letër, aktgjykim, përshkrim, ditar apo fragment memuaristike, mundësisht të personaliteteve që kaluan kalvarin e Hadesit komunist nëpër burgje apo kampe të detyrueshme pune (Atë Zef Pllumi, Arshi Pipa, Uran Kalakulla, Sami Repishti, Atë Konrad Gjollaj, Dom Simon Jubani, Pjetër Mëshkalla, Pjetër Arbnori, Fatos Lubonja, Visar Zhiti, Lekë Tasi, Petrit Velaj, – e shumë libra memuaristikë të botuar tashmë me dhjetra nga ISKK); Kryengritjet dhe Revoltat Kundërkomuniste – të popullsisë së Veriut (Kryengritjet - Kelmend, Anamal/Koplik, Postribë) dhe të Jugut – Zhapokikë 1948; Revoltat e mëdha në burgjet komuniste – Revolta e Spaçit, maj 1973 dhe Revolta e Qafë-Barit – maj 1984.

15. Vetëm me ndërmjetësinë e detyrueshme të një teksti bazë kurrikular si "Shqipëria gjatë diktaturës komuniste: 1944-1991", mund të nisë karakteri i shumëfishtë i lidhjes së brezit të ri me një kujtesë të shpërfillur kriminalisht, fuqia humane e së cilës ka vlerat të padiskutueshme njohëse dhe edukative.

16. Në çdo kapitull të veçantë të kësaj lënde, nxënësit do të njihen me një personalitet (fjalavjen, me personalitetin letrar e politik, për shembull, të Musine Kokalarit apo Sabiha Kasimatit; të Trifon Xhagjikës, Havzi Nelës, Arshi Pipës, Genc Lekës dhe Vilson Blloshmit, Shefqet Bejës, Riza Alizotit, Selaudin Totos apo Abdyl Kokoshit), do të diskutojnë rreth personalitetit të caktuar, aktit të rezistencës së tij, do lexojnë literaturë përplotësuese, do të ndjekin materiale filmike, dokumentarë rreth këtyre martirëve.



17. Më së fundi, por jo më pak e rëndësishme, kjo lëndë e detyrueshme shkollore, do t'i çojë natyrshëm nxënësit shqiptarë të vizitojnë vendet e vuajtjeve të heronjve që kanë njohur gjatë lëndës, ish-burgjet komuniste dhe kampet e punës së detyruar. Teksti i lëndës do të ketë dhe Hartën e Burgjeve dhe kampeve të internimit si dhe Hartën e ekzekutimeve, pra, një topografi të plotë të terrorit komunist (materiale eksistuese gjenden të gatshme tashmë në ISKK).

8. Prona

Hyrje

Ne besojmë se liria dhe prona janë të lidhura bashkë dhe lindin me njeriun. Sa më i fortë është themeli i pronës private, aq më e fortë është e mira e përbashkët. Ne besojmë se prona private është një instrument i fuqishëm për të ndërgjegjësuar njerëzit me ndjenjën e përgjegjësisë. Zotërimi i pronës private rregullon detyrimet e zotëruesve, pasi ata pranojnë detyrimet morale dhe ligjore në lidhje me pronën. Prona private rregullon shoqërinë për të mbrojtur ligjin dhe rendin.

Prona dhe respektimi i saj, si e drejtë themelore e njeriut, sjell siguri individuale dhe sociale, marrëdhënie paqësore mbi baza morale midis individëve në shoqëri, respektim të ligjit dhe rendit, respektim të pronës së tjetrit dhe mbrojtje, detyrim për ta ruajtur dhe zhvilluar atë më së miri.

I. Problematika e Pronësisë në Shqipëri

Situata Aktuale dhe Statistikë

- **Sipërfaqet për kompensim:** Sipas të dhënave nga ish-Komisionet për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, janë 7200 ha truall dhe 68,000 ha tokë bujqësore për t'u kompensuar. Kjo përbën një faturë financiare minimale prej 6.5 miliardë euro sipas ligjit 133/2015.
- **Dosjet e patrajtuara:** Aktualisht ka rreth 10,000 dosje të patrajtuara nga Agjencia e Trajtimit të Pronës.
- **Legalizimet:** Nëpërmjet 79 VKM-ve, 339 ha tokë u janë shpronësuar pronarëve për legalizimin e ndërtimeve informale, me një faturë financiare prej 40 miliardë lekësh.

Memorandumi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës thekson nevojën për një zgjidhje gjithëpërfshirëse të problemit të të drejtave të pronësisë. Kjo zgjidhje duhet të bazohet jo vetëm në sfidat aktuale që Shqipëria po kalon, por edhe në eksperiencat e ngjashme të vendeve të tjera anëtare të Këshillit të Evropës në zbatimin e vendimeve të GjED-së .

Rekomandime Kryesore

1. **Zgjidhja e Konflikeve:** Përfshirja e një mekanizmi të qartë dhe të drejtë për zgjidhjen e konflikeve të lidhura me të drejtat e pronësisë. Vendet anëtare të Këshillit të Evropës kanë përvoja të ndryshme në zgjidhjen e konflikeve të lidhura me të drejtat e pronësisë, duke përfshirë zgjidhjet e konflikeve të ndryshme dhe metodat e ndryshme për kompensim
2. **Transparenca dhe Përcaktimi i Vlerave:** Zgjidhja e konflikeve dhe kompensimet duhet të jenë të transparent dhe të përcaktuar në bazë të vlerave të pronave.
3. **Afati dhe Efikasiteti:** Përcaktimi i një afati të arsyeshëm për zbatimin e vendimeve dhe kompensimeve.



4. **Respektimi i Drejtave të Pronarëve:** Sigurimi që të drejtat e pronarëve janë të respektojë gjatë gjithë procesit të kompensimit.
5. **Zbatimi i Ligjeve dhe Rregullave:** Zbatimi i ligjeve dhe rregullave në mënyrë të drejtë dhe për të siguruar që procesi të jetë i përfshirë.

Këto rekomandime dhe përvoja janë të rëndësishme për të ndihmuar Shqipërinë në zhvillimin e një politike të kompensimit të përfshirë dhe të drejtë për të drejtat e pronësisë.

- Është vënë në dukje ekzistenca e një vakumi ligjor në sistemin e brendshëm, mungesa e mjeteve efektive për zgjidhjen përfundimisht të çështjes së kthimit dhe të kompensimit të pronave dhe probleme të tjera në lidhje me garantimin e kësaj të drejte. Kuadri ligjor shqiptar paraqitet jo efikas dhe nuk ka mjete efektive ankimimi; mungesa e fondeve nuk është arsye objektive që shteti të mos kompensojë individët si dhe është ende e pranishme nevoja për të bërë ndryshimet e duhura ligjore, administrative ose financiare.
- Mosrespektimi i së drejtës së pronësisë si një ndër të drejtat më themelore në një shtet demokratik përbën një situatë shqetësuese për realitetin shqiptar. Shqetësimi në lidhje me këtë situatë është i dyfishtë pasi:

- a) shkelen të drejtat e individëve dhe
- b) shteti shqiptar është i detyruar që për shkak të këtyre vendimeve të pagojë shuma të konsiderueshme.

Në shumë raste vetë organet e brendshme gjyqësore ndikojnë ose forcojnë moszbatimin e vendimeve gjyqësore si dhe të ligjit për kthim dhe kompensim i cili përcakton se vendimet bëhen përfundimtare pasi shterojnë të gjitha rrugët e ankimit. Ndërkohe që sipas kodit civil vendim përfundimtar dhe i ekzekutueshëm është vendimi i gjykatës së apelit. Një vendim që trajton çështjen e pronës kundër ATP është i pa ekzekutueshëm pasi mbaron trajtimi në gjykatën e apelit.

Pas ushtrimit dhe ndërveprimit të proceseve administrative të legjitimuara qysh në vitin 1993 përmes ligjit 7698/1993, deri te ligji 9235/2004, i ndryshuar, dhe pas ndërhyrjes së sistemit gjyqësor në çështjet e pronësisë për njohjen, kthimin dhe apo njohjen e së drejtës për kompensim të kësaj kategorie, sot kemi një panoramë të larmishme, ku sipas mënyrës së trajtimit dhe përfitimit, identifikohen disa grupe subjektesh “Ish Pronarë”:

- ata që e kanë ezauruar njohjen dhe kthimin e pronës plotësisht apo pjesërisht përmes vendimeve administrative të institucione kompetente për kthimin e pronës apo vendimeve të gjykatave;
- ata që kanë ezauruar njohjen formale të pronës dhe kthimin e saj përfundimisht me akte administrative dhe apo gjyqësore;
- ata që kanë ezauruar njohjen formale të pronësisë në tërësi dhe njohjen e saj për tu kompensuar, përmes akteve administrative të institucioneve kompetente të kthimit të pronës në vite dhe ende nuk kanë përfutuar asnjë formë kompensimi;
- ata që e kanë ezauruar njohjen formale të pronës dhe njohjen e llojit të kompensimit konkret por të paezauruar as në kohë e as tani;
- ata që kane ezauruar me vendim te formës se prere administrative dhe apo gjyqësor te njohjes së pronës dhe të së drejtës për tu kompensuar e për shkak të vendndodhjes së kësaj prone në zona që u urbanizuan dhe legalizuan kanë përfutuar shuma financiare konkrete nga proceset e legalizimit të zonave informale.
- ata që kanë përfutuar njohjen formale juridike (administrative) të pronës por nuk kanë asnjë vlerësim për të drejtat e tyre vijuese mbi këtë pronë pas kësaj vendimmarrje, Pra, vendimi shprehet



vetëm për njohjen e pronës. Nuk shprehet nëse njohja e pronës nënkupton kthimin e pronës apo kompensimin e saj. etj.

- ata që kanë përfituar njohjen pjesërisht përmes vendimeve të institucioneve administrative të kohës, për shkak të kufizimeve sasiore që vendoste ligji për kategori të caktuara tokash (kryesisht toka bujqësore) dhe nuk ka shteruar me akt juridiko formal njohjen e pjesës së mbetur brenda dimensionit të përgjithshëm sasior dhe perimetrit të kufitarëve të asaj prone. Dhe madje edhe në pjesën e ezauruar me një vendim administrativ formal ndoshta kanë të ezauruar pjesërisht kthimin e jo të drejtën e kompensimit;
- ata që kanë përfituar njohjen formale juridike të pronës bazuar në dokumente e prova të adresuara në gjykatë e që më pas nuk e kanë shteruar të drejtën në institucionet e njohjes, kthimit dhe kompensimit për shumë arsye. Pra, ende nuk një akt përfundimtar njohje pronar.
- ata që kanë përfituar njohjen formal juridike të pronës me akte administrative por që edhe kanë shteruar dhe përfituar të drejtën e kompensimit plotësisht ose pjesërisht me anë të kompensimeve fizike gjatë vijës bregdetare të detit Adriatik, por edhe sipas modaliteteve që jepnin aktet e kohës.
- ata që kanë përfituar me vendime të Gjykatës së Strasburgut lënien në fuqi të vendimeve që i kanë njohur kthyer dhe apo njohur të drejtën për kompensim të pronave të tyre duke u shoqëruar edhe me fatura konkrete.
- ata të cilët kanë përfituar formalisht e juridikisht realizimin e të drejtës për tu kompensuar fizikisht por që në kushtet e mungesë për ta disponuar e gëzuar nuk rezulton ta kenë shteruar këtë të drejtë (rasti i zaptimeve apo I mosdorëzimit asnjëherë të asaj prone sipas rregullave të kohës për marrjen në dorëzim të parcelës së kompensuar);
- ata që kanë përfituar njohje dhe të drejtën për tu kompensuar financiarisht deri në masën e 200m2 për rrethin e Tiranës e Kavajës, sipas çmimit të tregut të viteve 2006-2007-2008 e vijim;
- ata që kanë përfituar nga realizimi i plotë i së drejtës së njohur për kompensimi për pronën e njohur me akte administrative gjatë këtyre viteve 2009-2024. Këtu bëjnë pjesë edhe ata të cilët kanë pranuar të heqin dorë nga masa totale financiare për tu kompensuar, përkundrejt 20%, 40% etj. të vlefshës monetare takuese, masë e cila realizohet me shpërndarje periodike disa vjeçare.

Krahas kategorive të subjekte të ashtuquajtur të shpronësuar apo ish pronarë të para viteve 1945, renditen edhe kategori të pronarëve të cilat kanë fituar pronat e tyre sipas modaliteteve që njeh Kodi Civil, një prej të cilave është fitimi i pronësisë me anë të ligjit.

- Përfituesit nga ligji 7501 dhe ligje të tjera me objekt të ngjashëm
- Përfituesit nga Ligji për privatizimin e banesave
- Përfitues nga ligj Për legalizimin
- Përfitues nga kontratat administrative vendore për efekt zhvillimi ekonomik dhe biznesi. Me këtë rast tjetërsimi dhe kalimi i kushteve parësore të asaj kontrate duke e rritur vlerën e investimit (në mënyrë fiktive) në masën 150% të vlerës së tokës me qëllim përfitimin e asaj sipërfaqe prone në mënyrë të prejardhur nga procesi i privatizimit. Këtu bëjnë pjesë raste të shumta abuzive të cilat u kanë dhënë mundësinë investorëve të quajnë tokë bujqësore tokat në afërsi të brigjeve detare e të tjetërsojnë destinimin duke i përvetësuar me titull disponimi e më pas duke u ndryshuar destinimin e duke i thyer në zona turistike me ndërtime shumë katëshe. Abuzimet janë të panumërta në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore që kanë pasur në administrim në këto vite toka në inventar të shtetit dhe me interes për nga pozicioni gjeografik.



Kategorive më sipër, në kuadër të hedhjes dritë mbi situatën dhe gjetjen mekanizma rikuperues, do të duhet t'u shtojmë edhe subjektet që kanë përfituar përmes koncesioneve, partneritetit publik privat si dhe ata që kanë përfituar në kuadër të statusit investitor strategjik apo me anë të akteve favorizuese të tjera.

Po ashtu, nuk mund të lihen pa u identifikuar edhe ata që bëjnë pjesë në kategorinë e llojit pronarë prej ligjit:

- Ata që kanë përfituar legalizimin e trojeve dhe banesave përkundrejt një shpërblimi;
- Ata që kanë përfituar legalizimin e oborreve në përdorim dhe truallit nën banesë për hir të VKM favorizuese e rregullatore;
- Ata që me vendime gjyqësore të formës së prerë kanë ezauruar kërkesat e posedimeve të pandërprera në mirëbesim apo keqbesim dhe tjetërsimin e tyre në disponim për hir të gëzimit qetësisht e të pandërprere. Pavarësisht se pronat kanë qenë në proces njohje dhe kthimi nga institucionet administrative të kohës.
- Ata që me vendime gjykatash kanë fituar të drejtën e posedimit dhe disponimit të pronave si trashëgimtarë të ish pronarëve.

Në kuadër të qasjes së kësaj panorame të larmishme subjektësh me opsionet e mundshme për zgjidhje të përshtatshme e koherente, në drejtim të rritjes së garancive për rikuperimin e gjendjeve juridiko ekonomike apo financiare të kategorisë së subjekteve të shpronësuar pa të drejtë pas 1944, duhet doemos të sjellim në vëmendje konsideratën tejet negative për kuadrin ligjor aktual të trajtimit dhe administrimit të çështjeve të pronësisë. Ligji për kadastrën dhe ligji për ATP, VKM 827, VKM për regjistrimin e ATP-ve etj.

II. Linjat dhe Parimet për Zgjidhjen e Çështjes

Zgjidhja e çështjes së pronës kërkon një qasje të integruar dhe reforma të thella ligjore dhe institucionale.

Parimet Kryesore të Propozimeve Tona

- a. **Kthimi fizik i pronës:** Ky duhet të jetë parimi themelor i procesit, duke ndjekur praktikën më të mira në vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore. Me qëllim reduktimin e faturës financiare për buxhetin e shtetit, i duhet dhënë një peshë më e madhe kompensimit fizik ku fondi shtetëror i trojeve dhe tokave të vihet në dispozicion të këtij procesi. Nevojitet një identifikim i Pronave të Disponueshme, që mund të përfshijnë toka të lirshme, ndërtesa të pashfrytëzuara, apo prona të tjera publike.
 - Pronat e identifikuara duhet të vlerësohen në mënyrë të drejtë për të siguruar se ato kanë një vlerë të barabartë me pronat e konfiskuara, dhe duhet të jenë të pranueshme për ish-pronarët, që të plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre. Kjo mund të përfshijë toka bujqësore për fermerët, ndërtesa për qëllime komerciale për biznesmenët, etj.
- b. **Kompensimi i drejtë:** Kur kthimi fizik nuk është i mundur, kompensimi financiar duhet të bazohet në vlerën e tregut dhe jo në hartat e vlerës të përcaktuara nga qeveria. Në çdo rast, duhet kryer një kompensimin me vlerën e drejtë të pronës për pronarët legjitim.
- c. **Skema alternative kompensimi:** Me qëllim reduktimin e faturës financiare, duhen shqyrtuar mundësitë e përdorimit të instrumenteve financiare si obligacione, ari, aksione në kompani



shtetërore apo edhe pjesëmarrjes nëpërmjet një fondi investimi si mjete shtesë të kompensimit financiar.

d. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe Kodifikimi i qartë i ligjeve të pronësisë: Duhet të miratohet një ligj i ri që vendos standarde të qarta dhe afate për përfundimin e procesit të kthimit dhe kompensimit.

e. Transparenca dhe digjitalizimi

- Modernizimi i regjistrave të pronësisë dhe krijimi i një harte digjitale të titujve të pronësisë
- Vendosja e mekanizmave për transparencë dhe përgjegjshmëri në çdo hap të procesit
- Përfundimi 100% i regjistrimit fillestar sistematik kombëtar dhe krijimi i regjistrat elektronik publik të pasurive të paluajtshme të konsoliduar.
- Përfundimi 100 % i proceseve të përkohshme të nivelit kombëtar:
- Forcimi i sistemit të drejtave të pronësisë dhe mbrojtjes të tyre deri në fazën e ekzekutimit sipas standardeve të GjEDNj-së në përputhje me Strategjinë Nder sektoriale të Drejtësisë, me qëllim rritjen e sigurisë mbi pronën e fituar me ligj dhe të investimeve mbi të, si dhe të dinamizmit të tregut të tokës brenda një afati 4 vjeçar.
- Modernizimi i sistemit të informacionit për të drejtat e pronësisë, nëpërmjet dixhitalizimit 100% të sistemit të pasurive të paluajtshme sipas standardeve të direktivës INSPIRE.

III. Propozime Konkrete

Shpallja e “**Moratoriumit të çështjeve të tokës dhe pronave të grabitura**”. Brenda këtij kuadri ne propozojmë të ndërmerren masat si më poshtë:

1. **Inventarizim i të gjithë tokave në Republikën e Shqipërisë** për të parë gjendjen aktuale, dhe pronësinë e tokave të ndryshme, si dhe pronësinë që kanë pasur në vitin 1945 dhe atë që kanë sot. Me një vullnet politik, me një Ministri përkatëse që do e shtyjë këtë çështje madhore përpara, do të synohet që ky inventarizim të mbyllet sa më shpejt.
2. **Rishikimi dhe shfuqizimi i ligjeve problematike**
 - Rishikim i kuadrit ligjor që ka të bëjë me pronat, trajtimin, vlerësimin, administrimin e tyre dhe certifikimin e tyre apo dhënien shërbim të pafrytshëm e me kosto shumë të lartë, shtetasve shqiptarë apo të huaj.
 - Shfuqizim i të gjithë atyre akteve përmes të cilave po krijohen pronarë të rinj të mbivendosur në pronat e njohuara, kthyerat dhe të certifikuara për hir të premtimeve elektorale apo klienteliste apo dhënies shpërblim në meritë të kontributit partiak atyre që i ndërtojnë sot dhe të nesërmen i legalizojnë nën aplikimin e VKM 827. Kjo VKM është një akt antikushtetues që del mbi valencën e ligjit, të Kushtetutës duke krijuar pronarë të rinj privatë si ndërhyrje, në emër të interesit publik.
 - Parimi i sigurisë juridike duhet të garantohet në të gjitha aktet ligjore. Të drejtat, garancitë dhe detyrimet duhet të adresohen kryesisht nëpërmjet ligjeve. Aktet nënligjore duhet të respektojnë në mënyrë të rreptë hierarkinë e normave juridike, të cilat duhet të jenë sa më të pakta dhe nuk duhet të përbëjnë burimin kryesor të proceseve.
 - Grupet e interesit dhe veçanërisht shoqatat e pronarëve legjitimë duhet të përfshihen në të gjitha grupet e punës të ngritura nga institucionet shtetërore me qëllim hartimin e akteve ligjore dhe të dokumenteve të politikave publike.



- Duhet shfuqizuar ligji aktual 133/2015 për trajtimin e pronës. Edhe skema e kompensimit sipas ligjit aktual është tërësisht e dështuar. Ligji i ri për kthimin dhe kompensimin e pronës duhet të përfshijë parimin e kthimit fizik si parim thelbësor. Kompensimi, qoftë ai fizik, ashtu edhe ai financiar, duhet të jenë plotësues ndaj kthimit fizik. Kompensimi financiar duhet bazuar në vlerën e tregut.
 - Ligji për legalizimet dhe të gjitha aktet që përbëjnë bazë ligjore për legalizimet në të ardhmen duhen shfuqizuar. Për ndërtimet pa leje që tashmë janë legalizuar dhe është fituar e drejta e pronësisë, shteti mund të marrë parasysh zbatimin e një taksimi të posaçëm që siguron financim shtesë për procesin e kompensimit të pronave. Niveli i taksimit mund të lidhet me mundësitë financiare të ndërtuesit, vëllimin dhe përdorimin e ndërtesës.
 - Duhet miratuar një ligj i ri për shpronësimin për interes publik (ligji aktual është i vitit 1999 me disa shtesa dhe ndryshime) në përputhje me praktikën më të mira evropiane, ku kufizimi i të drejtave të pronësisë në bazë të interesit publik të jetë i mirëpërcaktuar dhe të mos jetë i hapur ndaj praktikave abuzive. Ligji duhet të kufizojë rastet e interesit publik potencial si për shembull, infrastruktura e transportit publik, institucionet publike të arsimit dhe shërbimeve, infrastruktura e mbrojtjes kombëtare etj, me qëllim qartësimin e faktit që jo çdo interes ose projekt kombëtar apo vendor mund të justifikojë shpronësimin. Shpronësimi duhet lejuar vetëm në favor të një subjekti shtetëror. Subjekti shtetëror propozues duhet të jetë në gjendje të vërtetojë që ka shteruar të gjitha mundësitë për të fituar pronësinë me mjete të tjera përveç shpronësimit dhe që qëllimi i projektit mund të arrihet vetëm nëpërmjet shpronësimit. Pronari duhet të jetë palë në procedurën e shpronësimit dhe duhet të ketë të drejtën e ankimit në gjyq. **Kompensimi duhet të bazohet në vlerën e tregut dhe duhet të përfshijë edhe kompensimin e dëmit** (duke përfshirë jo vetëm investimet, por edhe të ardhurat e pritshme/fitimin e munguar).
 - Duhet **shfuqizuar ligji për investimet strategjike** dhe ligji 20/2020 si një ligj i disfavorshëm për subjektet e shpronësuar.
3. Riorganizimi i Agjencisë së Kadastrës dhe i ATP. Nxjerrjen nga juridiksioni e kompetenca lëndore e përberë e administrimit të proceseve të pronësisë. Kadastra ose Zyra e Regjistrimit nuk është gjë tjetër veçse një magazinë publike e akteve doravorë dhe apo elektronikë si edhe e regjistrave historiko institucional që lidhen me ecurinë kronologjike të çdo parcele. ATP nuk ka dhënë asnjë vendim që nga viti 2013 por vetëm ka bërë sikur ka vlerësuar disa prona nën suazën e vlerësimit sipas çmimit 1 lek të vitit 1944. Në brendësi të veprimtarisë së saj vetëm ka mashtruar publikun dhe subjektet ish pronarë.
 4. Krijimin e mekanizmave të shërbimit të përshtatshëm për të gjithë shtetasit shqiptarë subjekte të disponimit, posedimit dhe gëzimit të pasurive private në Republikën e Shqipërisë.
 5. Marrja fund e aplikimit të parapaguar dhe vonësve procedimorë me vite dhe shoqëruar me dhjetëra ri aplikime të ri paguara. Ndërtimi i sistemit elektronik të shërbimit që të përmbush performancën më të lartë e të krijojë garanci maksimale jo vetëm drejt efektivitetit, por edhe anës ekonomike të qytetarit. Trajtimi i kërkesave dhe aplikimeve të kryhet pa parapagesë. Pagesa të kryhet vetëm në momentin e marrjes shërbim, me saktësi maksimale.
 6. Implementimi i parimit të reparacionit atje ku është e mundur, me qëllim uljen e barrës ekonomiko financiare nga shteti (taksapaguesi) për kategorinë e subjekteve të shpronësuar pa të drejtë por disponues të aktit të njohjes së pronës dhe njohjes të së drejtës për tu kompensuar.



7. Zgjidhja e çështjeve të pronësisë ende të pa njohur, të pa kthyer e të pa kompensuar vetëm përmes sistemit gjyqësor dhe ndoshta duhet parë mundësia e krijimit të Gjykatave Administrative për çështjet e pronësisë së patrajtuar me akt përfundimtar.
8. Implementimi i nocionit “Fond garancie”, i cili do të jetë i lidhur ngushtësisht me dinamikën e zhvillimit të tokës, kryesisht atë urbane/trojet në qytete apo zona zhvillimore me interes ekonomik apo turistik. Ndjekja e detyrimit me fatin e tokës është një mjet/mekanizëm shkarkues pas realizimit të disa proceseve paraprake identifikuese, si më poshtë do rendis:
9. Në kuadër të rishikimit të riorganizmit të veprimtarisë kadastrore të realizohet domosdoshmërisht pasqyrimi i rrjedhës historiko kronologjike të çdo parcele të territorit Shqiptar. Çdo dokument që lidhet me tagrat, me të drejtat reale dhe ideale të pasqyrohet në historik (apo kartelën elektronike e fizike). Pasqyrimi i të gjithë rrjedhës së pronësisë do të na mundësojë të njohim situatën që lidhet me:
 - akte për të cilat nuk jemi në dijeni e që përbëjnë një faturë të fshehur;
 - subjekte të tjerë të panjohur më parë ndoshta që kanë përfituar pa të drejtë dhe në kushtet e një fature të lidhur me atë truall detyrimisht do të mbartin detyrimin për të ezauruar faturën qoftë edhe duke ia ngarkuar si taksë periodike deri në shumën për tu shlyer.
10. Nëse tokat e njohura për kompensim bien në zona urbane me perspektiva zhvillimore, sugjerojmë të futet koncepti i përfshirjes në përfitim edhe të ish pronarit, ose si masë shpërblimi nga investitori(duke e rregulluar shteti me akte raportet e përfitimit) ose duke lejuar te ezaurohet me anë të ndërtimit mbi planifikim pra sipërfaqe ndërtimore shtesë në dobi të përfitimit nga ish pronarët. P.sh. Ne rast se zona zhvillimore ka një planifikim prej 7-9 kate, të lejohet me ligj të posaçëm që leja e ndërtimit në tokën truall do të ketë dy kate ekstra në kuadër të fondit të garancisë. Fond të cilin ose e garanton dhe administron fillimisht shteti deri në kalimin si përfitim kompensimi përfundimtar ish pronarit. Administrimi dhe shpërndarja nga shteti bën që të shënjohet ezaurimi përfundimtar i shpërblimit të papërmblusur apo detyrimit të perealizuar. Në rast se toka nuk ka ish pronarë të identifikuar sipërfaqja ndërtimore do të kalojë për efekt të fondit të garancisë rezervë dhe shteti mund të përdorë ose mekanizmin e vënies në ankand deri në nxjerrjen e masës financiare më të mirë ose duke ua ofruar si sipërfaqe ndërtimore kategorisë ish pronarë toka e të cilëve përkon mbi vepra publike të patjetërsueshme apo të mbrojtura prej natyre apo. Shteti pasi e kalon në administrim të tij, kompenson fizikisht ish pronarët potencial të cilët heqin dorë nga pretendimi mbi pronat e tyre me vendndodhje të tjera.
11. Për kategoritë e pronarëve të tokave të përfituara për shkak të ligjeve të kohës, atëherë të ngarkohen me taksën e barrës pronësore në rast se në ato prona përkon të ketë ish pronarë jo përfitues as me kthim të pronës dhe as me ndonjë formë kompensimi. Taksa do lidhet gjithmonë me përfituesin origjinal (përfituesin e parë) si në kushtet e përfitimit nga ligji 7501 ashtu edhe në kushtet e përfitimit të banesave të privatizuara. Përgjashtim bëjnë rastet kur këto prona janë tjetërsuar dhe janë shitur në blerës të parë të dytë e të tretë.
12. Një opsion tjetër mund të jetë ngarkimi me të njëjtën taksë të barrës pronësore të çdo objekti të privatizuar e të pa shitur ende tek të dytë apo të tretë etj. Nëse një apartament i privatizuar pas viteve 1992 shitet sot ai do të taksohet edhe me taksën e re të reparacionit pronësor. Në rast se kjo do të sjellë në rënie të kërkesës për këto apartamente apo pallate do i japin premisën e zhvillimit të mëtejshëm urban infrastrukturor duke gjetur investitorë të cilët në atë njollë urbane marrin përsipër të ndërtojnë objekte të reja shumëkatëshe ku sërish do të ngarkohen me barrët e përmendura në pikat e mësipërme, siç është fondi I garancisë etj.



13. Në rast se prona është njohur për kompensim nën argumentin se përpara vitit 1991 ajo u shpronësua për interes publik, atëherë gjetja e reparacionit do t'i nënshtrohet vlerësimit sipas kritereve të ligjit kur i është njohur dhe kompensuar prona dhe identifikimit të përfitimit deri në atë çast të kësaj kategorie. Gjithsesi, në kudër të reparacionit do të duhet të mendohet baraspeshimi i masës së përfituar me atë të pretenduar në vite. Kjo do të ndodhë për të gjithë kategoritë.
14. Me rastin e pasqyrimin të historikut ligjor të çdo parcele do të identifikohen edhe përfituesit abuziv nga ligji 7501 të cilat kanë tjetërsuar apo falsifikuar gjendjet civile për momentin e volitshëm, duke mashtruar për vendbanimin apo qenien pjesë në ferma e kooperativa apo NB me qëllim përfitimi. Certifikatat janë gjeneruar duke tjetërsuar kryesisht librat aktivë të gjendjeve civile, por ballafaqimi për përfitimin nga ligji 7501 do të bëhet përmes regjistrave themeltarë dhe dokumenteve statistikore arkivore të kohës.
15. Shpallja e pavlefshmërisë absolute e AMTP-ve të përfituara padrejtësisht ose të cilat nuk rezultojnë të jenë poseduar sipas qëllimeve të ligjit, nuk rezulton të jenë paguar taksat.
16. Shfuqizimi i ligjit për investimet strategjike
17. Identifikimi i fondit të pronave shtetërore dhe private (në atë zonë ose zona të afërta) në hartë digjitale dhe përdorja e fondeve për kompensim fizik të targetuar. Psh. në varësi të madhësisë së parcelave, ftohen ish pronarët të aplikojnë për marrjen e tyre si masë kompensimi fizik dhe nëse nuk pranojnë atëherë le t'u shuhet e drejta për t'u kompensuar në formë tjetër. Shteti mund të nxisë edhe projekte zhvillimore në zona ende të pavëna dorë me qëllim rritjen e vlerës ekonomike të fondit që mund të jepet si kompensim fizik.

Përfundim nga taksimi në shitje apo rishikimi i titullit do të kenë rastet e përfitimit të trojeve të shtëpive në fshat dhe oborreve rreth tyre, gëzuar para vitit 1991. Pasi për formalizimin dhe legjitimin e tokave të trashëguara në fshat, u përdor si mekanizëm ligji 7501.

9. Zhvillimi Territorial dhe Decentralizimi

Hyrje

Partia Demokratike beson se në kontekstin e zhvillimit të një vendi dy janë aspektet më të rëndësishme: popullsia (rasti i Shqipërisë së ndarë në sy shtete Shqiptare na e bën të pamundur përdorimin e termit më të përshtatshëm që është kombi) dhe territorialiteti ku popullsia zhvillon aktivitetet e saj jetësore, ekonomike, kulturore dhe shoqërore. Çdo gjë tjetër është produkt i ndërveprimit të këtyre dy aspekteve, veçanërisht i punës së individëve dhe grupeve që synon përdorimin në mënyrë të qëndrueshme dhe ndër- gjeneracionale të burimeve natyrore dhe territoriale me perspektivën e zhvillimit të një niveli sa më të lartë jetese me dinjitet për individin, familjen dhe kombin.

Partia Demokratike, si një organizim i individëve që respektojnë lirinë e besimit, vlerëson se Zoti, Krijuesi apo Natyra është arkitekti më i madh dhe i vetëm i natyres. Ne besojmë se natyra, ashtu si ajo është projektuar e zhvilluar shpreh rregullin, harmoninë, proporcionin, bukurinë, thjeshtësinë dhe elegancën e saj. Nëse nuk do të ishte e tillë, bota do të qe kaotike, e shëmtuar, e rrëmuishme. Nga ana tjetër, ne besojmë se çdo arkitekt – edhe arkitekti më i mirë i botës njerëzore, në të gjitha kohët – është arkitekt i kulturores. Çdo ndërhyrje e tij dëmton natyren, prandaj, ne, si të djathtë, duhet të ndërhyjmë duke vlerësuar dhe marrë në konsideratë deri në detajin më të vogël çdo zhvillim ndërtimor.

Ne besojmë se Atdheu duhet dashur në çdo centimetër të shtrirjes territoriale të tij, jo vetëm kufiri që na ndan nga fqinjët apo flamuri që na identifikon. Duhet të vlerësojmë dhe dashurojmë të gjitha burimet natyrore të tij, kudo ku ato ndodhen, dhe jo vetëm në qytetet e mëdha. Atdhedashuria e re do të jetë zhvillimi i zgjuar, i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës i burimeve natyrore dhe territoriale të Atdheut. Nga njëra anë,



të përfitojmë nga gjithçka të mirë që natyra na ofron dhe teknologjia na mundëson ti kthejmë në të mira materiale për të përmirësuar nivelin e sotëm të jetës së qytetarëve; nga ana tjetër, t'i mirëmbajmë dhe zëvendësojmë këto burime që t'ua trashëgojmë brezave të ardhshëm. Ne do të duhet të krijojmë kushtet qeverisëse që çdo qytetar e familje të përfsihet dhe të përfitojë nga kjo qasje patriotike.

Partia Demokratike beson se toka bujqësore duhet trajtuar si 'zonë e mbrojtur'. Shqipëria është vendi më i varfër në Europë duke u bazuar te toka bujqësore për individ. Kemi më pak tokë bujqësore edhe se Egjipti, i cili rreth 70% të territorit e ka nën shkretëtirë. Në vitin 1994, sipas statistikave të kohës, ne kishim një fond të tokës bujqësore prej 2300m²/ banor, ndërsa një statistikë tjetër e mes-viteve 2000 na tregon se ky tregues ka arritur në 1700 m²/ banor. Ne jemi të vetëdijshëm se kjo 'tretje' e tokës bujqësore është rezultat i politikave të gabuara të ndjekura në këto vite tranzicion, përfshirë vitet kur PD ka qenë në qeverisje.

Ne besojmë se qeverisja kombëtare, rajonale dhe vendore nuk kanë marrëdhënie hierarkike, dhe asnjë qeverisje nuk është superior ndaj një niveli tjetër qeverisës. Pas 70 vjetësh shëtitje nëpër populizëm shoqëror e politik, Shqipëria ka domosdoshmëri një formulim të qartë mbi çfarë i delegojmë si fushëveprimi qeverive të tre niveleve që ne kemi. Sikurse e kemi prezantuar më parë, kjo dallohet në çdo fushëveprimi qeverisës, por është vendimtare në sektorët që kanë impakt në dimensionin territorial dhe urban të vendit. Parimi i zvogëlimit të fushës së veprimtarisë së qeverive duhet ta frymëzojë këtë ushtrim politik. Ne besojmë se Shqipëria ka domosdoshmëri një ndarje më decentralizuese të fushëveprimit ndërmjet tre niveleve qeverisëse. Ne jemi të bindur se, sa më afër komunitetit të jetë vendimmarrja aq më të qenësishme janë zgjidhjet e problemeve dhe barazpeshimi i aspekteve urbanë e territorialë.

Partia Demokratike thekson se Shqipërisë së dimensionit territorial i nevojitet 'Utopia' e rajoneve policentrike urbane. Dimensionin urban i saj ka domosdoshmëri një qasje policentrike në shkallë të ndryshme urbane. Ne do të duhet të arrijmë këtë nëpërmjet një qëndrimi politik gjithëpërfshirës për një rishpërndarje të balancuar të popullsisë nëpër territorin kombëtar. Kjo do të synojë bërjen bashkë të burimeve natyrore dhe njerëzore, jo vetëm si një mundësi për prosperitet ekonomik, por edhe si një tezë patriotike. Kjo qasje politike do të ndërmerret me synimin për të mos lejuar shpopullimin e Atdheut dhe për të krijuar kohezion kombëtar, nga njëra anë; dhe për të penguar atomizimin e shoqërisë dhe për të krijuar komunitete në solidaritet. Çdo politikë kombëtare, rajonale dhe vendore, dhe çdo projekt i ndërmarrë, do të konsiderojë si prerogativë kombëtare këtë qëndrim politik.

Ne besojmë se struktura hapësinore e Shqipërisë ka nevojë për një barazpeshim të qendrave të banuara të një njësie rajonale apo vendore qeverisëse. Policentrizmi, me dy karakteristikat e tij – specifika dhe komplementariteti – duhet t'i identifikojë qendrat e banuara. Ne jemi të vetëdijshëm se sot Shqipëria urbane përbëhet nga dy tipologji të kundërta të qendrave urbane: të mëdha, të mbipopulluara dhe me densitete të larta ose, të braktisura, të nënpopulluara dhe me densitete të ulëta banimi. Të dyja këto modele qendrash të banuara janë shumë të vështira e me kosto shumë të lartë për t'u administruar, përveç çekuilibrave të brendshme urbane që indikojnë cilësinë e jetesës urbane të jetës së qytetarëve dhe shëndetin publik të komuniteteve. Të parat, paraqesin mungesa të mëdha në mundësi punësimi e aktivitete të tjera jetësore; kurse të dytat, të harruara, vuajnë mungesë financimesh për shërbime minimale publike.

Ne besojmë se filozofia 'Qyteti ndërtohet për njerëzit dhe nga njerëzit', nuk është një slogan revistash për urbanistikën, por parimi më bazik në ndërtimin e qendrave inteligjente, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të jetesës. Territoret e përshtatura për jetesë njerëzore që nuk zhvillohen në përputhje me planifikime që vijnë si produkt i proceseve demokratike që përfsihjnë të gjitha palët e interesuara dhe të prekura nga zhvillimet e propozuara, janë të destinuar të dështojnë në çdo aspekt. Rasti Shqiptar është shembulli më klasik i kësaj mënyre përjashtuese zhvillimi urban e ndërtimor.

Shqipëria e sotme ka domosdoshmëri jetike të ndërmarrë procese planifikuese ku përfsihirja e qytetarëve të interesuar të jetë prerogativë. Ne zotohemi të ndërtojmë një sistem ligjor dhe praktika planifikuese që ta sigurojnë këtë domosdoshmëri sa demokratizuese aq edhe produktive në cilësinë urbane të komplekseve dhe lagjeve të banimit dhe qytetit si entitet integral.



Reforma e Sistemit të Planifikimit dhe Zhvillimit Territorial

Reforma e sistemit të planifikimit dhe zhvillimit territorial është e një rëndësie jetike, jo vetëm për objektin e saj primar -- që është *zhvillimi i planifikuar i dimensionit territorial dhe urban të vendit* -- por edhe si një:

- (1) *komponent i rëndësishëm i luftës kundër korrupsionit* (zvogëlimi i qeverisjes, dhe fuqizimi i pushtetit vendor);
- (2) *instrument kyç i qeverisjes së mirë* (barazisë kushtetuese dhe fuqizimit të qytetarit në proceset vendimarrëse);
- (3) *kontributor thelbësor në strukturimin e modeleve të sektorëve të tjerë të zhvillimit kombëtar dhe shoqëror* (struktura sociale, modeli politik, ekonomik dhe kulturor);
- (4) *mbrojtës i mjedisit nga zhvillimet dëmtoese* (burimeve natyrore dhe territoriale përfshirë ndikimet e ngrohjes globale); dhe
- (5) *sigurues i cilësisë së lartë të jetesës urbane për qytetarët* (strehimi, transporti, punësimi, cilësia e infrastrukturave inxhinierike dhe sociale, cilësia mjedisore e qendrave të banuara).

Kjo reformë është e domosdoshme për tre arsye thelbësore:

- (a) me gjithë përpjekjet e vazhdueshme Shqipëria nuk ka arritur të stabilizojë një sistem të planifikimit dhe zhvillimit territorial dhe urban në përputhje me parimet dhe praktikën e vendeve demokratike dhe të zhvilluara perëndimore;
- (b) qeverisja socialiste ka ngritur një sistem të hiper-centralizuar pushteti në këtë sektor, të krahasueshëm dhe shpesh në tejkalim edhe të sistemit të kohës së diktaturës komuniste; dhe
- (c) qeverisja socialiste e ka përdorur këtë sektor bazik në sektorin më të korruptuar të zhvillimit të vendit.

Reforma e kërkuar do të sigurojë:

1. mbrojtje e mjedisit natyror dhe pronësisë publike të tokës nga grabitja dhe dëmtimi, si pasojë e korrupsionit dhe papërgjeshmërisë së qeverisjes;
2. zhvillimin hapësinor, territorial dhe urban mbështetur në instrumente planifikimi të hartuara dhe miratuara në procese demokratike dhe gjithëpërfshirëse e palëve të interesuara dhe qytetarëve;
3. lehtësimin e procedurave të lejdhënies për zhvillim ndërtimor dhe të adresojë çështjet e padrejtësisë së thellë në zhvillimin e pronësisë private në qytete dhe territore të tjera të rëndësishme kombëtare, etj.

Kjo është një reformë afatmesme dhe sistematike, sepse kërkon reformimin e thellë të gjithë sistemit, përfshirë atë kulturor, legjislativ dhe praktikave të përditshme menaxhuese. Ajo është gjithashtu komplekse, sepse përfshin disa komponentë specifikë dhe komplementar. Disa nga më thelbësorët janë:

1- Reforma Administrativo - Territoriale

Reforma Administrativo- Territoriale është një domosdoshmëri, përveç shumë aspekteve të tjera, edhe për sektorin e planifikimit dhe zhvillimit territorial. Ajo do të mbështetet në parimet e decentralizimit të funksioneve qeverisëse drejt pushtetit vendor dhe të fuqizimit të qytetarit në qeverisjen vendore. Parimet e vendosura nga dokumentet e institucioneve të Bashkimit Europian apo të organizatave të rajoneve më të gjera do të frymëzojnë çdo element të saj.

Propozimi e vendos qeverisjen **në tre nivele qeverisëse: nivelin kombëtar; nivelin rajonal dhe nivelin vendor**. Këto nivele **duhet të jenë plotësisht autonome nga njëra tjetra**, për sa i përket funksioneve që secila prej tyre ushtron në qeverisjen territoriale, **por në bashkërendim të plotë me njëra tjetrën**.

2- Hartimi dhe miratimi i një legjislacioni 'Për Planifikimin dhe zhvillimin e Territorit'.

Legjislacioni i ri do të mbështetet në parimet e qeverisjes së mirë urbane, si dhe jo vetëm: **zhvillimi i qëndrueshëm, ekonomik e social; bashkërendimi horizontal dhe vertikal; shumëllojshmëria; planifikimi i detyrueshëm; vazhdimësia në planifikim; transparenca dhe llogaridhënia; shërbimin me një ndalesë dhe pranimin në heshtje; specifika në planifikim; delegimi e nëndelegimi i kompetencave dhe kontraktimin e shërbimeve; efektiviteti, qëndrueshmëria, efienca, profesionalizmi dhe përgjegjshmëria në procesin e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit të territorit; subsidiaritetin;**



harmonizimin me normat e standardet evropiane në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit e të kriterëve mjedisore.

Legjislacioni i ri do të konsiderohet si një sistem gjeneral me dy komponentë kryesor, atë të **planifikimit territorial**, dhe atë të **kontrollit të zhvillimit**. Palët e interesuara dhe qytetarët e prekur nga zhvillimi, duhet të jenë një autoritet vullnetar i planifikimit, sepse përfshirja e tyre shkon në përputhje me të drejtat e tyre kushtetuese dhe ligjore, dhe jo në zbatim të ndonjë përgjegjësie ligjore. Autoritetet e planifikimit duhet të jenë në përputhje të plotë me funksionet e niveleve të ndryshme qeverisëse, për territorin në juridiksion të tyre. Ato duket të kenë legjitimitet të plotë mbi vendimarrjet e tyre.

Në legjislacionin e ri, proceset e hartimit dhe miratimit të instrumenteve të planifikimit do të jenë plotësisht të hapura për palët e interesuara dhe qytetarët. Niveli i pjesëmarrjes publike do të përcaktohet sipas nivelit qeverisës, dhe në këtë kuptim edhe të fushëveprimtarisë të secilës prej tyre, të përcaktuar më parë me ligje për secilin nivel qeverisës.

3- Rishikimi i legjislacionit për ‘Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave dhe Ndërtesave informale’

Legjislacioni i ri do të mbështetet në dy parime bazike të djathta: **zvogëlim i rolit dhe madhësisë së qeverisë dhe rritjen e lirisë së individëve për të kryer transaksione private mes njëri-tjetrit.**

Ai mbështetet në tre shtylla kryesore. Së pari, **legalizim i ndërtesës**, njohja formale që ky volum ndërtimor ekziston dhe i njihet si pronë ndërtuesit apo ndërtuesve të paligjshëm. Së dyti, **kthimi te pronari legjitim**, toka mbi të cilin është bërë ndërtimi informal, duke e lejuar atë të përfitojë nga shitblerja e saj apo nga rrizhvillimi i saj në një moment të dytë. Dhe së treti, **lënia e mekanizmave të moralshëm të tregut të lirë të veprojnë duke rregulluar marrdhëniet e pronësisë midis dy pronarëve.**

Këto tre shtylla do të përshpejtonin procesin e legalizimeve, do ta bënin atë më të drejtë dhe do të zvogëlonin kostot ndaj taksapaguesit publik si për institucione qeverisëse edhe për financim publik. Një mënyrë tjetër për ta përshpejtuar formalizimin e ndërtesave paleje mbështetet në një parim tjetër libertarian, duke e kaluar funksionin qeverisës të legalizimit, integrimin dhe urbanizimin e ndërtesave dhe zonave informale, drejt pushtetit vendor.

4- Rishikimi i Planeve të Përgjithshme Teritoriale Kombëtare dhe Vendore ekzistuese dhe hartimi i instrumentave Rajonalë.

Një nga projektet qeverisëse thelbësore në sektorin planifikimit dhe zhvillimit territorial do të jetë rishikimi i instrumenteve kombëtarë dhe lokal të miratuara më parë, në dy shtylla kryesore: **përmirësimi i aspektit procedural demokratik të miratimit të tyre** (përfshirja e palëve të interesuara); dhe, **përmirësimi i aspektit teknik përmbajtësor të tyre.**

Ky projekt, gjithashtu, do të përfshijë hartimin e instrumenteve Rajonal të planifikimit territorial, sipas: dimensionit gjeografiko-administrativ të përcaktuar nga reforma ‘Administrativo- Territoriale’; dhe dimensionit demokratiko-përmbajtësor të përcaktuar nga legjislacioni i ‘Planifikimit dhe Zhvillimit Territorial’.

5- Projektet në sektorin e ndërtimit

Ky projekt, ndër të tjera do të përfshijë tre seksione: Eurokodet si kushte teknike projektimi; vlerësimi i objekteve ndërtimore të kohës së regjimit komunist; dhe eficiencën e energjisë në ndërtesa.

Eurokodet janë të miratuara si standarde shqiptare por përdorimi i tyre ngelet vullnetar përderisa ato nuk janë të miratuara si kushte teknike projektimi. Ato janë miratuar si kushte teknike projektimi në të gjitha vendet e BE-së dhe miratimi si të tilla edhe në vendin tonë përbën një hap tjetër të rëndësishëm në drejtimin tonë drejt komunitetit evropian.

Praktikat e vlerësimit të ndërtesave janë kthyer normale në vendet e zhvilluara. Ne do të ndjekim të njëjtat praktike, duke vënë në qendër qytetarin dhe bashkëpunimin me komunitetin në çdo hap. Pjesë e paketave



të vlerësimit mund të përshihen edhe objektet informale të cilat përbëjnë një volum të madh aktualisht në stokun e banesave dhe për të cilat nuk ka asnjë informacion mbi sigurinë e tyre.

Rishikim tërësor i akteve nënligjore që rregullojnë organizimin, funksionimin dhe aspekte teknike të sektorit të efikasitetit të energjisë në ndërtesa, bazuar në Direktivat e BE-së.

10. Transporti

Transporti është një element kyç për zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturor të vendit, duke mundësuar lidhjen më të mirë të Shqipërisë me rajonin dhe Evropën. Partia Demokratike, në të kaluarën, ka kontribuar në mënyrë të qenësishme në përmirësimin e rrugëve dhe infrastrukturës kombëtare, duke përfunduar projekte madhore si Rruga e Kombit, dhe duke shtruar mbi 11,000 km rrugë. Investimet në këtë sektor kanë ndihmuar për përmirësimin e qarkullimit të mallrave dhe njerëzve, duke rritur ekonominë dhe turizmin. Megjithatë, sfida e zhvillimit të një sistemi hekurudhor mbetet një nga prioritetet për të ardhmen, për të siguruar një transport më efikas, të lirë dhe ekologjik.

Një prioritet kryesor për Partinë Demokratike do të jetë investimi në hekurudha moderne, për të krijuar një rrjet të integruar kombëtar që lidh qytetet kryesore të vendit dhe përmirëson lidhjet rajonale. Duke ndjekur modelet evropiane, ky zhvillim do të kontribuojë në rritjen e ekonomisë, zvogëlimin e trafikut rrugor dhe ndotjes, si dhe në uljen e kostove për transportin e mallrave. Për më tepër, do të shikohet edhe mundësia e zbatimit të konceptit të interportit, që do të lehtësojë qarkullimin dhe shpërndarjen e mallrave nëpërmjet porteve detare dhe hekurudhave, duke e bërë Shqipërinë një qendër logjistike të rëndësishme në rajon.

Korridoret ndërkombëtare që kalojnë përmes Shqipërisë, si Korridori VIII, përfaqësojnë mundësi të jashtëzakonshme për të integruar vendin më tej në tregjet evropiane dhe globale. PD do të mbështesë investimet strategjike në këto korridore për të siguruar që Shqipëria të bëhet një pikë kyçe transporti dhe tregtie në Ballkan, duke përmirësuar infrastrukturën dhe duke tërhequr investime të huaja.

1. Zhvillimi i Rrjetit Hekurudhor:

Rindërtimi i rrjetit hekurudhor: Nisma për të ndërtuar rrjetin e parë modern hekurudhor që lidh kryeqytetin Tiranë me qytetet kryesore të Shqipërisë, si Durrësi, Shkodra, Elbasani, Vlora, Korça, etj. Synimi është të ulë kostot e transportit të mallrave dhe të rrisë sigurinë e udhëtarëve, duke ndihmuar njëkohësisht zhvillimin ekonomik dhe turizmin.

Hekurudha për mallra: Krijimi i një rrjeti të dedikuar për transportin e mallrave, që lehtëson qarkullimin e produkteve bujqësore dhe industriale drejt porteve dhe qyteteve të mëdha, duke reduktuar ngarkesën në rrugët automobilistike.

Financimi me partneritete publike-private (PPP): Për të ulur barrën financiare mbi shtetin, ky projekt mund të financohet në bashkëpunim me sektorin privat dhe me mbështetjen e BE-së apo institucioneve ndërkombëtare për zhvillim.

2. Modernizimi dhe Zgjerimi i Porteve:

Zhvillimi i portit të Durrësit si një hub ndërkombëtar: Modernizimi i infrastrukturës së portit të Durrësit për të konkurruar me portet më të mëdha në Adriatik, për ta shndërruar atë në një pikë të rëndësishme të transportit të mallrave. Kjo përfshin përmirësimin e terminaleve të kontejnerëve, ndërtimin e magazinave moderne dhe krijimin e lehtësirave për transport të shpejtë mallrash.

Porti i Vlorës dhe Sarandës: Shndërrimi i këtyre porteve në qendra të rëndësishme për turizmin, duke ofruar shërbime të dedikuara për anijet turistike dhe jahtet. Për më tepër, porti i Vlorës mund të zhvillohet për transportin e mallrave në jug të Shqipërisë, duke krijuar një lidhje të rëndësishme me tregjet ndërkombëtare.



Koncepti i Interportit: Ndërtimi i një interporti në zona strategjike si Durrësi, që të shërbejë si një qendër logjistike që lidh transportin rrugor, hekurudhor dhe detar. Kjo do të ndihmojë në përsheptimin e qarkullimit të mallrave dhe uljen e kostove logjistike për bizneset.

3. Transparenca dhe Rigjykimi i Marrëveshjeve për Portet e Zaptuara:

Zaptimi i portit të Durrësit: Rishikimi i marrëveshjeve të nënshkruara në lidhje me portin e Durrësit për të siguruar që ato të jenë në përputhje me interesat kombëtare. Çdo marrëveshje e dyshimtë që ka për qëllim privatizimin pa mbrojtur interesat strategjike të Shqipërisë duhet të rishikohet ose anulohet.

Auditim i zaptimit të porteve të Vlorës dhe Sarandës: Një hetim transparent dhe auditim për të vlerësuar nëse marrëveshjet aktuale për këto porte janë të ligjshme dhe të dobishme për ekonominë shqiptare. Nëse zaptimi i këtyre porteve është bërë në kundërshtim me interesat publike, do të ndërmerren hapa për rikthimin e tyre nën kontrollin shtetëror.

4. Lehtësimi i Transportit Ndërkombëtar dhe Rajonal:

Integrimi rajonal: Ndërmarrja e projekteve që lidhin Shqipërinë me rrjetin hekurudhor të Ballkanit, për të krijuar korridore të reja tregtare që lidhen me Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Greqinë dhe Malin e Zi.

Transporti detar ndërkombëtar: Zhvillimi i marrëveshjeve me vende të rajonit dhe BE për krijimin e korridoreve të gjelbra në transportin detar, që favorizojnë shkëmbimet tregtare të shpejta dhe me kosto të ulët.

11. Familja

a) Bazat e familjes

Familja dhe vlerat familjare janë dhe mbeten themeli i shoqërisë. Rëndi i kësaj të fundit varet pikërisht nga funksionaliteti i saj dhe i gjithë shoqërisë. Në duar të familjes është e ardhmja e shoqërisë dhe kombit. Ne kemi një traditë të vyer të familjes dhe mbrojtjes së saj por si kudo në botë edhe në Shqipëri mënyra e jetesës ka ndryshuar dhe politikat të cilat quhen të ndjeshme dhe të orientuara nga e ardhmja duhet të kenë parasysh në radhë të parë traditën më të mirë shqiptare të familjes dhe mbrojtjen e saj. Për këtë arsye politikat e familjes duhet të bazohen në vlerat tradicionale dhe në realitetet e reja. Familja nuk ekziston si nocion vetëm për veten. Ajo është pjesë thelbësore e shoqërisë, cohës kulturore dhe jetës sociale, e rrethuar nga struktura të shëndetshme dhe të veshura me moral.

Prandaj, mbi të gjitha, në këto kohë të trazuara, ne mbrojmë me vendosmëri familjen si dhe martesën tradicionale – të cilat në traditën dhe qytetërimin tonë janë të shenjta dhe të pazëvendësueshme. Duke parë rrezikun që i kanoset, e shohim si detyrë të vëmë theksin e duhur për nevojën e mbështetjes dhe mbrojtës së të drejtave që kanë të bëjnë me familjen, vlerat familjare si dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen e jetës së gjeneratave të ardhshme që nga ngjizja.

Ashtu si gjithë shoqëria, edhe familja shqiptare ka pësuar deformime, përkeqësim dhe jo rrallë herë edhe shpërbërje. Mungesa e politikave të qarta dhe konservatore për familjen dhe ruajtjen e saj, shpopullimi i vendit, varfëria dhe ndryshimet ekonomiko-shoqërore të vendit, si dhe zhvendosjet nga zonat në rurale në zonat urbane, mungesa e një perspektive të qartë për të ardhmen, janë faktorë kryesorë të përkeqësimit të familjes në Shqipëri.

Pasiguria në martesë dhe mungesa e kohezionit në bashkëjetesë, mos përkrahja e prindërve të vetëm kryefamiljar dhe vdekshmëria e lartë foshnjore si dhe lindshmëria e ulët në vend, kanë sjellë probleme të mëdha me shpërbërjen e familjes në shumë çifte të reja dhe sidomos në shtresën e mesme.



Vlerat e familjes lidhin bashkë burrat dhe gratë në barazi. Politikat tona të familjes kanë për qëllim të krijojnë kushtet optimale që sa më shumë njerëz të vendosin për një jetë me fëmijë. Për këtë arsye është e rëndësishme të ketë liri të plotë zgjedhjeje në mënyrë që prindërit të mund të kombinojnë familjen dhe punën.

Brenda familjes njerëzit kërkojnë virtyte shoqërore dhe morale, detyrime të barabarta, besim dhe përgjegjësi dhe respekt për individualizmin. Në familje është përvoja më e mirë e jetës së brezave. Për këtë arsye vlerat familjare, janë elemente themelore për zhvillimin e individit por edhe për bashkëjetesën sociale. Është pikërisht kjo që ne demokratët konservatorë e ndiejmë detyrim të mbrojmë vlerat e familjes si traditën tonë më të mirë.

b) Ndryshimet demografike në Shqipëri dhe shpopullimi

Shqipëria, për shkak të pasojave të keqeverisjes, të kushteve jo të favorshme ekonomike dhe socio-politike, ka kohë që përballët me migrimin masiv, veçanërisht të rinisë dhe tashmë të shtresës së mesme.

Administrata e politizuar, arsimi i cunguar, mungesa e meritokracisë, mungesa e shpresës për të tashmen dhe të ardhmen, kriza e besimit, mungesa e punës dhe puna e paguar pak dhe e papaguar, etatizmi dhe centralizimi i pushtetit qendror dhe vendor, dhe mungesa e decentralizimit urban dhe territorial, politizimi i shoqërisë dhe mungesa e përfaqësimit demokratik, kanë sjellë situatën aktuale të shpopullimit të Shqipërisë.

Një dukuri e tillë që rrezikon të përshkallëzohet, për ne është tejet shqetësues. Zgjidhja mund të arrihet vetëm duke pasur platformë efikase ekonomike, shoqërore dhe juridike të cilat do rrisnin dhe zhvillonin mirëqenien dhe kualitetin e jetesës. Në mënyrë të veçantë, duke mbështetur familjet e reja me programe të veçanta ekonomike.

Ulja e lindshmërisë në vend, rënia e standardit të jetesës, rënia e sistemit shëndetësor dhe kujdesit për jetën, dhe masat detyruese nga shteti, janë probleme tepër shqetësuese për ne. Për këtë arsye ne mendojmë se përqasja e re për të ndaluar fenomenin e shpopullimit dhe uljes së lindshmërisë duhet të ketë karakter kombëtar dhe është çështje e interesit kombëtar shqiptar që duhet trajtuar me urgjencë me politika të caktuara ku liria e individit, shteti i së drejtës, krijimi i mundësive të barabarta dhe përfaqësimi demokratik të marrin përparësi kombëtare.

Ne propozojmë një Pakt të Madh Kombëtar për të ndaluar dhe kthyer trendin e shpopullimit dhe rënies demografike.

1. Forcimi i Familjeve të Reja

- **Kredi pa interes për martesat e reja:** Ofrimi i një kredie pa interes deri në 2 milionë lekë për çiftet që martohen për herë të parë, të falur nëse ata kanë të paktën tre fëmijë.
- **Bonus për çdo fëmijë të lindur:** Një bonus për çdo fëmijë të lindur, me vlerë të lartë për fëmijën e tretë dhe të katërt, duke inkurajuar familjet që të kenë më shumë fëmijë.

2. Ulje Taksash për Familjet e Mëdha

Përrjashtim nga tatimi mbi të ardhurat për nënat me katër ose më shumë fëmijë.

Ulje të taksave për familjet me tre ose më shumë fëmijë: Familjet e mëdha do të përfitojnë nga ulje e përqindjeve të tjera të tatimeve si TVSH dhe taksat lokale.

3. Kredi për Strehimin dhe Pronësinë



Program për shtëpi për familjet e reja: Familjet me tre ose më shumë fëmijë do të përfshihen në një program lehtësimi për blerjen e një banese të re.

Ulje e interesit për kreditë për strehim: Kredi të subvencionuara për banesë me interesa minimale për familjet e reja dhe ato me fëmijë, të cilat falen pas lindjes së fëmijës së tretë.

4. Kredi për Makina Familjare

Kredi të buta për makina me shtatë vende: Ofrimi i kredive të buta për blerjen e makinave me shtatë vende për familjet me tre ose më shumë fëmijë, duke ulur kostot e transportit për familjet e mëdha.

5. Leje lindje dhe Mbështetje për Prindërit

- Zgjerimi i periudhës së pushimit të lejes së lindjes dhe lejes për baballarët: Pushimet e paguara për nënat deri në dy vjet, dhe për baballarët deri në 6 muaj, duke rritur përfitimet për familjet me shumë fëmijë.
- Ndihma për gjyshërit: Mundësimi që gjyshërit të marrin ndihmë financiare për t'u kujdesur për nipërit dhe mbesat kur prindërit janë në punë.
- Lehtësim nga barra tatimore për nënat kryefamiljare

6. Politika për Emigracionin e Kundërt

- Program për kthimin e shqiptarëve të diasporës: Ofrimi i përfitimeve fiskale dhe lehtësimeve për shqiptarët që kthehen nga emigracioni, duke përfshirë kredi të butë për strehim dhe bonuse për fëmijët që lindin pas kthimit.
- Nxitja e investimeve për kthimin në atdhe: Mbështetje për sipërmarrjet dhe investimet e shqiptarëve që duan të kthehen për të zhvilluar biznese në Shqipëri.

(Për më shumë, ju lutem referojuni programit të Departamentit të Familjes në Partinë Demokratike. Duke qenë se është përpiluar një dokument nga PD, ne nuk jemi zgjatur në këtë seksion)

12. Rinia

Partia Demokratike është krijuar nga të rinjtë. Ata janë zemra që pulson pa pushim, për t'i dhënë oksigjenin e nevojshëm, energjinë e domosdoshme dhe frymëzimin jetësor demokratëve. Partia Demokratike forcohet dhe tregon anën më të mirë të saj kur të rinjtë shqiptarë kanë të gjithë mundësitë për të shpalosur potencialin e tyre jashtëzakonisht të madh, për të nxjerrë në pah shpirtin e tyre antikomformist dhe për të na drejtuar nga e ardhmja, duke respektuar, nderuar dhe vlerësuar familjet, traditat dhe historitë e tyre.

Ndaj, Partia Demokratike e vlerave konservatore është e vendosur të ketë në fokus të politikave të saj dhe në krah të aksionit dhe vendimmarrjes politike rininë shqiptare. Qëllimi ynë është edukimi patriotik dhe shkencor, krijimi i terrenit të duhur për shpalosjen e potencialit rinor në atdheun e tyre, shtysat për formimin e familjeve të reja dhe ndalimi i menjëhershëm i emigracionit me anë të rikthimit të shpresës.

Në radhë të parë, ne synojmë të jemi garantët që zëri i familjeve për fëmijët e tyre të dëgjohet fuqimisht dhe kurdoherë. Duhet të jenë prindërit dhe fëmijët vendimmarrësit kryesorë nëpërmjet pjesëmarrjeve në bordet e shkollave apo mekanizmave të tjerë që do të duhet të krijohen.

Decentralizimi i pushtetit do të mundësojë që procesi i dëgjimit, shqyrtimit dhe vendimmarrjes për problemet e fëmijëve dhe të rinjve të bëhet sa më afër tyre në komunitetet ku jetojnë. Rikthimi i veprimtarive jashtëshkollore (sportet, artet dhe shkenca), jetës së sigurt në komunitet, dhe zhvillimi i



procesit krijues dhe mendimit kritik që në fëmijëri janë synime kryesore për ne. Mbi të gjitha, është bindja jonë e palëkundur se në themel të një shteti të fortë shqiptar qëndron edukimi patriotik e shkencor dhe siguria maksimale e fëmijëve dhe të rinjve kudo në territorin e Republikës.

Ne mbrojmë pa kompromis të drejtën e pjesëmarrjes së të rinjve në shoqata, organizata studentore, forume diskutimi, shpalosjen e ideve dhe jetësimin e projekteve të të rinjve shqiptarë.

Besimi ynë është se rinia është garantuese dhe nismëtare e mirëqenies dhe mbarëvajtjes së familjes, komunitetit dhe shtetit shqiptar në të ardhmen. Ndaj, rinia jonë do të duhet të thotë mendimin e vet për fatet e shtetit dhe shoqërisë. Ajo do të duhet të jetë kokëllartë përpara rinisë së vendeve të tjera të Evropës dhe të Botës, pasi potenciali i rinisë sonë, aftësitë dhe idetë janë jo vetëm të barabarta, por në shumë fusha dhe më përpara vendeve të tjera.

Ne jemi të bindur se rinia shqiptare është përqafuese e vlerave të tilla si familja, miqësia, puna në grup dhe aktivitetet që synojnë forcimin e parimeve tradicionale të shoqërisë qytetare. Por, na takon ne që t'u krijojmë të tëra mundësitë që ata të shfaqin këto parime dhe vlera.

Shqipëria sot ka një nga normat më të mëdha të papunësisë së të rinjve. Qëllimi ynë është që me anë të ekonomisë së tregut, edukimit cilësor, shkollave profesionale, forcimit të familjes shqiptare dhe rivendosjes së meritokracisë, t'u sigurojmë vendin e tyre të rinjve shqiptarë në tregun e punës, me të ardhura dinjitoze dhe lëvizshmëri shoqërore të lartë.

Kjo arritje do të jetë thelbësore, pasi Shqipërinë e shekullit të 21-të do e kenë në kujdestari pikërisht të rinjtë. Forcimi i kombit tonë varet pazgjidhshmërisht nga forcimi i rinisë shqiptare.

Programi ynë do të **fokusohet në zhvillimin e mundësive ekonomike, rritjen e aftësive profesionale dhe edukative, përfshirjen në proceset kulturore, ekonomike, shoqërore dhe politike, dhe nxitjen e vlerave tradicionale si familja, puna dhe patriotizmi.**

Ky program bazohet në shembujt më të mirë nga praktikatat e huaja të suksesshme për të motivuar dhe fuqizuar brezin e ri shqiptar që të marrë rol aktiv në ndërtimin e së ardhmes së vendit të tyre.

1. Nxitja e mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes

Program kombëtar për sipërmarrjen rinore: Duke marrë shembull nga programet në SHBA dhe Britani, do të krijohet **një fond i posaçëm për të mbështetur start-up-et rinore**. Ky fond do të ofrojë grante, trajnime dhe mentorim për të rinjtë që duan të fillojnë bizneset e tyre, duke theksuar inovacionin në teknologji, bujqësi dhe turizëm. Do të krijohen mundësitë ligjore dhe praktike për **forma alternative të mbledhjes së fondeve, si crowdfunding.**

Iniciativa për punësimin e të rinjve: Një skemë që do të inkurajojë bizneset të punësojnë të rinj, duke ulur barrën e kontributeve për punëdhënësit për çdo të ri të punësuar. Do të krijohen lehtësime fiskale për kompanitë që përqendrohen në trajnimin dhe zhvillimin e fuqisë punëtore rinore, duke ndjekur modele nga Gjermania dhe Izraeli.

2. Program edukativ dhe profesional për të rinjtë

Diploma të njohura ndërkombëtarisht dhe arsim i lidhur me tregun: Reforma të thella në sistemin arsimor për të përshtatur programet shkollore me kërkesat e tregut të punës. Të rinjtë do të kenë mundësi të marrin diploma të njohura ndërkombëtarisht nga universitetet shqiptare përmes marrëveshjeve me institucione evropiane dhe amerikane.

Zgjerimi i arsimit profesional dhe trajnimeve praktike: Në bashkëpunim me sektorin privat, do të krijohen shkolla profesionale dhe qendra trajnime që përgatisin të rinjtë për tregun e punës në fusha të tilla si teknologjia e informacionit, energjia e rinovueshme dhe turizmi. Modelet gjermane dhe zvicerane të arsimit dual do të integrohen, duke ofruar një kombinim të mësimin teorik dhe praktik.



3. Pjesëmarrja aktive në jetën politike dhe shoqërore

Iniciativa për përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje: Do të krijohen forume rinore lokale dhe kombëtare që do të funksionojnë si këshilla këshillimore për qeverinë, duke ofruar të rinjve mundësinë që të përfshihen direkt në vendimmarrje dhe të ofrojnë propozime për çështje si arsimi, punësimi, mjedisi dhe teknologjia.

4. Fuqizimi i vlerave kombëtare dhe traditave

Program kulturor dhe edukativ për identitetin kombëtar: Do të zhvillohet një program edukimi dhe promovimi që do të theksojë rëndësinë e trashëgimisë kombëtare, historisë dhe vlerave tradicionale shqiptare. Ky program do të përfshijë aktivitete kulturore, përfshirjen e të rinjve në projekte kombëtare për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe promovimin e patriotizmit.

Mbështetje për familjen dhe përfshirjen e rinisë: Duke u bazuar në praktikën e vendeve konservatore si Hungaria, programi ynë do të nxisë ndërtimin e vlerave të forta familjare te të rinjtë.

Ne zotohemi në zbatimin e nismave që mbështesin të rinjtë në krijimin e familjeve të qëndrueshme përmes lehtësimeve tatimore për çiftet e reja dhe kredi të buta për blerjen e shtëpive.

5. Fuqizimi i aksesit të të rinjve në teknologji dhe inovacion

Qendra inovacioni dhe teknologjie për të rinjtë: Do të krijohen qendra inovacioni në të gjithë Shqipërinë që do të ofrojnë kurse dhe trajnime për të rinjtë në fusha si programimi, robotika dhe inteligjenca artificiale. Këto qendra do të marrin modelin e Silicon Valley dhe vendeve skandinave për të krijuar një gjeneratë inovatorësh dhe për të shkuar drejt zonave të lira ekonomike për shërbimet teknologjike, për shërbime të caktuara shëndetësore, dhe industriale.

6. Mobiliteti dhe shkëmbimet ndërkombëtare

Marrëveshje për shkëmbime rinore me vendet evropiane dhe më gjerë: Do të krijohen marrëveshje ndërqeveritare me vendet e BE-së dhe të tjera për të nxitur programet e shkëmbimit rinor dhe profesional, duke ndjekur modelin e programeve të suksesshme si Erasmus. Kjo do t'u japë të rinjve mundësinë të përfitojnë nga edukimi dhe përvoja ndërkombëtare.

Pasaporta rinore për udhëtime në BE dhe më gjerë: Një iniciativë e veçantë për të rinjtë shqiptarë që do t'u mundësojë udhëtime më të lira dhe akses në evente kulturore dhe edukative në BE dhe vendet tjera partnere. Kjo iniciativë synon të lehtësojë dhe inkurajojë udhëtimet e të rinjve shqiptarë në vendet e Bashkimit Evropian dhe shtete të tjera partnere për arsye edukative, kulturore dhe profesionale. Ajo do të funksionojë si një kartë identiteti speciale dhe një program përfitimesh për të rinjtë, duke u bazuar në modele të ngjashme të suksesshme të vendeve evropiane, siç është European Youth Card.

7. Promovim i aktiviteteve sportive

Program për promovimin e sporteve dhe jetës aktive: Qeveria do të inkurajojë ndërtimin e qendrave sportive dhe krijimin e programeve për të nxitur të rinjtë të angazhohen në sporte dhe aktivitete fizike. Përmes investimeve të përbashkëta me komunitetet lokale, do të ndërtohen palestra dhe fusha sportive për të rinjtë, duke ndjekur modelet e vendeve të suksesshme të BE-së.

Lufta kundër varësisë nga teknologjia: Duke ndjekur shembullin e vendeve të përparuara si Japonia dhe Koreja e Jugut, do të krijohen programe edukative për të ndërgjegjësuar të rinjtë për rreziqet e varësisë nga teknologjia dhe për të promovuar përdorimin e shëndetshëm të saj.



13. Mjedisit

Demokratët shqiptarë janë në mbrojtje të natyrës, por duke mos rënë pre e përdorimit të çështjes së mjedisit për interesa të grupimeve neo-marksiste dhe për përfitime personale.

Mbrojtja e mjedisit, veçanërisht e pasurive natyrore, është thelbësisht parim konservator. Duhet ta mbrojmë atë në mënyrën më të mirë të mundshme, pasi nuk na përket vetëm neve. Ajo na është trashëguar nga paraardhësit tanë, kështu që ruajtja e saj është detyrim i dyfishtë, pasi që i takon edhe gjeneratës së re që po rritet, ashtu si dhe gjeneratave të së ardhmes, të cilat nuk kanë lindur akoma. Është pasuri e paçmueshme për ne, dhe si e tillë nuk mund të vendoset në treg as rrezik.

Keqpërdorimi i pasurive natyrore dhe ndotja e mjedisit, shpesh e toleruar për hir të interesave të ndryshme personale dhe politike, duhet ndaluar. Prandaj shfrytëzimi i pasurive natyrore duhet bërë në mënyrë etike sipas standardeve dhe teknologjisë bashkëkohore, me përgjegjësi, duke mos shkaktuar ndotje apo dëme.

Pyjet, parqet, lumenjtë, liqenet, detet, etj. duhen kujdesur dhe mbrojtur dhe duhet të ndalojmë me urgjencë shfrytëzimin klientelist dhe të papërmbyajtshëm që vjen si pasojë e zhvillimit agresiv.

Gjithashtu do ndalet në mënyrë të menjëhershme masakra urbane në qytete dhe duhet ndërprerë dhënia e lejeve të ndërtimit pa kriter e mbi baza klienteliste duke i shërbyer mafies së ndërtimit dhe pastrimit të parasë së jashtëligjshme dhe kështu duhet inkurajuar shtimi i zonave të gjelbërta nëpër qytete.

Po ashtu, ne do të inkurajojmë përdorimin e energjisë së rigjenerueshme si dhe të lëndëve dhe automjeteve ekologjike; përdorimi i mjeteve të përditshme nga materiale të tretshme ekologjike dhe riciklimi i mbetjeve duhet të kryer me metoda bashkëkohore.

Është detyra jonë si konservatorë – mbrojtës të natyrës – të ruajmë peizazhin si pjesë e trashëgimisë sonë natyrore, një shprehje e bukurisë së vërtetë të vendit tonë, duke garantuar harmoninë e tij me komunitetet dhe të drejtat e njeriut, trashëgiminë historike, bujqësore dhe blegtorale.

Në thelb, gjithsesi, mbetet nxitja e nismave vendore dhe konkrete mjedisore kundër planifikimit të përqëndruar mjedisor, dhënies fund të abuzimeve me tenderat dhe ofertat e pa kërkuara, masakrës së inceneratorëve (djegësve) të mbetjeve urbane, mungesës së kontrollit për emetimin e gazrave dhe rishikimit të përpunimit të karburanteve.

Në këtë kontekst, ne dënojmë aferën e djegësve si një ndër çështjet me ndjeshmëri të madhe publike, dhe me një prej dëmeve më të mëdha financiare për taksapaguesit shqiptarë. Të gjithë aspektet e kësaj afere bien ndesh me çdo gjë që një individ i djalhtë beson, që prej ndotjes, të mënyra e dhënies së koncesioneve dhe deri te mungesa e transparencës, korrupsioni dhe pandëshkueshmëria. Dëmi më i madh sot me aferën e djegësve i bëhet mjedisit pasi mbetjet vazhdojnë të digjen dhe groposen duke përbërë kështu një problem madhor për shëndetin publik të qytetarëve.

Mungesa e transparencës e garës, shkatërrimi i mjedisit dhe trashëgimisë kulturore janë elementët të cilët bëjnë konservatorët të jenë kundër të njëjtës skemë shfrytëzimi e korrupsioni në Portin e Durrësit, të Vlorës, Aeroportin e Vlorës apo Parkun Arkeologjik të Butrintit.

Këto tema janë me rëndësi të veçantë për konservatorët pasi shkelin çdo rregull tregu të lirë, konkurrence të ndershme që ne besojmë, por dhe dëmtojnë mjedisin dhe trashëgiminë tonë kulturore. Koncesionet dhe tenderat jo vetëm që do duhet të bëhen me garë të pastër dhe transparencë maksimale, por nuk do duhet t'u jepen kompanive offshore, apo atyre të cilave nuk u dihet pronari fundorë.

Ruajtja dhe përmirësimi i mjedisit natyror duhet të bëhet duke respektuar cilësinë e jetës së njerëzve, pa rënë barra e këtij ndryshimi mbi supet e shqiptarëve, duke i ngarkuar me taksa apo rregulla të reja. Për ne, si konservatorë, mbrojtja e mjedisit është parësore, pasi është një trashëgimi e cila na është ngarkuar



për ta ruajtur, për ta pasuruar dhe për t'ua kaluar brezave që do të vijnë. Ne besojmë se mbrojtja e mjedisit bëhet duke nisur nga familja, nga komuniteti dhe duke rritur nivelin e tyre të jetesës.

Programet dhe idetë e detyruara nga e majta globale apo vendore për të garantuar ruajtjen e mjedisit kanë për qëllim vetëm krijimin e një rendi politik të ri, që modifikon në mënyrë thelbësore jetën e njerëzve dhe përqëndron më tej vendimmarrjen në pak duar.

Shqipëria është një vend që energjinë e saj e siguron nga burimet ujore dhe jo nga burime energjie me ndotje të lartë. Duke marrë parasysh edhe këtë fakt, ruajtja dhe përdorimi i burimeve ujore, i lumenjve, deteve dhe liqeneve të vendit tonë me kujdes bëhet dhe më thelbësor.

Ne besojmë se nxitja e mbrojtjes së mjedisit natyror bëhet me qenien njerëzore si protagonist kryesor. Përballë ambientalizmit radikal të programeve të detyruara nga lart, ruajtja e zonave natyrore dhe të mbrojtura nuk mund të bëhet duke dëmtuar bashkësitë vendore dhe mënyrat e prodhimit tradicionale. Decentralizimi dhe dhënia e përgjegjësisë dhe menaxhimit pushtetit vendor dhe komunitetit është kyç në këtë proces.

Përballë modeleve të mbishfrytëzimit të burimeve natyrore, është e nevojshme të garantohet se e gjithë veprimtaria njerëzore, veçanërisht ekonomike, respekton trashëgiminë natyrore të shqiptarëve.

14. Marrëdhëniet me Jashtë

Hyrje

Shqipëria ka një rol të veçantë dhe të pazëvendësueshëm në politikën ndërkombëtare, i cili buron nga pozita e saj gjeostrategjike mes Lindjes dhe Perëndimit. Si një shtet i vendosur në një rajon historikisht të ngarkuar me përplasje forcash dhe interesash të kundërta, Shqipëria ka pasur dhe vazhdon të ketë një ndikim të madh në stabilitetin e Ballkanit dhe në lidhjet ndërkombëtare që shtrihen përtej tij.

Me anëtarësimin në NATO në vitin 2009 dhe synimin e integritetit në Bashkimin Europian, Shqipëria ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol kyç në promovimin e stabilitetit dhe paqes në një rajon të ngarkuar me tensione të vazhdueshme dhe pasojat e konflikteve të kaluara.

Në një kohë kur sfidat gjeopolitike globale dhe rajonale po bëhen gjithnjë e më të ndërlikuara, përballja me kërcënime si lufta hibride, siguria kibernetike dhe transformimet energjetike kërkon një politikë të jashtme proaktive, të bazuar në partneritete të forta dhe interesa kombëtare të mirëartikuluara. Në këtë kontekst, PDSH angazhohet për një politikë të jashtme që jo vetëm mbështetet në aleancat historike me Perëndimin, por gjithashtu në qasjet strategjike për t'u përballur me sfidat e reja. Një diplomaci e fortë, një ekonomi e ndërlidhur globalisht dhe një sistem mbrojtës i modernizuar janë tre shtyllat kyçe që do të fuqizojnë Shqipërinë si një aktor të rëndësishëm në rajon dhe më gjerë.

Me këtë platformë të re, PDSH ka për qëllim të trajtojë çështje kyçe që kanë ndikuar në rënien e besimit të qytetarëve, por dhe partnerëve të huaj në sistemin politik dhe në rolin ndërkombëtar të Shqipërisë. Ne synojmë të ridimensionojmë marrëdhëniet strategjike me aleatët, të rikthejmë integritetin e diplomacisë shqiptare dhe të avancojmë interesa konkrete që përforcojnë pozicionin tonë në një rend botëror gjithnjë e më multipolar.

a) Shqipëria sovrane



Për ne, sovraniteti kombëtar dhe ai ekonomik janë baza kryesore për çdo marrëdhënie të Shqipërisë me botën. Ky sovranitet buron nga populli shqiptar, i cili është burimi i çdo pushteti publik dhe mbetet themeli i çdo vendimmarrjeje. Çdo pushtet, në përputhje me parimet tona, është i krijuar për të shërbyer në interes të popullit dhe për të realizuar vullnetin e tij.

Sipas kësaj parimi, populli shqiptar ka të drejtën e patjetërsueshme të marrë vendime të drejtpërdrejta ose indirekte për të ardhmen e Shqipërisë, duke përfshirë ndryshimet në sistemin politik dhe ekonomik. Kjo e drejtë është thelbësore dhe nuk mund të kufizohet nga faktorë të jashtëm apo të brendshëm.

Garantimi i sigurisë, lirisë dhe vetëqeverisjes së qytetarëve shqiptarë është një prioritet i padiskutueshëm për ne. Ne angazhohemi që të mbrojmë këto vlera kundër çdo kërcënimi të mundshëm, qoftë nga jashtë, qoftë nga brenda vendit.

Njëkohësisht, ne do të punojmë për të siguruar mirëqenien ekonomike të qytetarëve shqiptarë, duke garantuar që çdo qytetar dhe çdo organizëm tjetër, pa dallim, të respektojë interesat ekonomike të Shqipërisë.

Ne besojmë fuqishëm se populli dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë janë mbi çdo faktor të jashtëm, dhe kundërshtojmë çdo përpjekje për të imponuar influenca që janë në kundërshtim me vullnetin dhe vendimet e Sovranit.

b) Njohja e Kosovës dhe çështja kombëtare

Ne, të vetëdijshëm se me Kosovën dhe pjesën tjetër të kombit shqiptar jashtë trojeve, nuk na bashkojnë vetëm historia, gjak, gjuha, kultura e traditat e përbashkëta, por dhe shpirti i lirisë e vetëvendosjes, zotohemi që në çdo moment **do mbrojmë integritetin territorial e politik të Republikës së Kosovës përballë çdo plani apo faktori kërcënues vendor apo ndërkombëtar për tjetërsimin e tij.**

Në formësimin e politikës sonë të jashtme, njohja e Kosovës dhe mbrojtja e saj luajnë një rol shumë të rëndësishëm e të pakontestueshëm.

Ne jemi një komb, një origjinë, në shtete të ndryshme, me qëllim bashkimin në familjet euro- atlantike ose sipas aspiratave të shqiptarëve në të dy shtetet.

Dinjiteti politik kombëtar dhe mbrojtja e të drejtave themelore të Shqiptarëve në Kosovë, komunitetit shtetformues shqiptar në Maqedoninë e Veriut, pakicave Shqiptare në Mal të Zi, Serbi e Greqi, ashtu si të drejtat e çdo shqiptari kudo në Botë, janë një nga idealet e frymës tonë konservatore, për të cilat nuk negociojmë.

Çdo negociatë apo marrëveshje në lidhje me kufijtë tokësorë, detarë, ajrore të Shqipërisë tashmë të përcaktuar, do të duhet në radhë të parë të bazohet në sovranitetin e tërësisë sonë territoriale, interesat kombëtar të popullit shqiptar dhe vendimin e sovranit.

c) Marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Partia Demokratike e Shqipërisë e konsideron marrëdhënien me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si një nga shtyllat kryesore të politikës së saj të jashtme, duke e ndërtuar këtë partneritet mbi një vokacion të përbashkët të luftës për liri, demokraci dhe të drejta të pakufizuara për individin. Ky angazhim, i thellë dhe i pandërprerë, ka qenë gjithmonë i ngushtë me vizionin dhe vlerat e Partisë Demokratike, që u lind si kundërpeshë ndaj një regjimi diktatorial dhe të padrejtë. Kjo histori e përbashkët, ka bërë që SHBA-të të



jenë partneri ynë kyç për sigurinë, zhvillimin dhe prosperitetin afatgjatë të Shqipërisë. Kjo marrëdhënie, e thelluar përmes një angazhimi të përbashkët për lirinë dhe demokracinë, ka qëndruar e pandryshuar, pavarësisht ndryshimeve të mëdha politike dhe sfidave globale që kemi përballuar gjatë dekadave të fundit.

Në këtë kuadër, Partia Demokratike e shikon partneritetin me SHBA-në si një mundësi të pazëvendësueshme për forcimin e institucioneve demokratike në Shqipëri, për mbrojtjen e sovranitetit tonë kombëtar dhe për zhvillimin e një shoqërie që ka në thelb vlerat e iniciativës private dhe lirisë së individit.

d) Integrimi evropian

Bashkimi Evropian është një histori e lirisë, paqes dhe prosperitetit. Projekti i Bashkimit Evropian është një bashkim fuqish dhe vlerash që erdhi pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Shqipëria për arsye të historisë së saj izoluese dhe komuniste, mbeti jashtë kësaj nisme që më pas u kthye në frymë dhe familje të madhe. Në fillimet e para të periudhës post komuniste Shqipëria u bë pjesë e ëndrrës për një Evropë të bashkuar dhe shqiptarët u ngritën në revolucionin e tyre antikomunist me sloganin “Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Evropa”.

Lidhja jonë me Evropën ka rrënjë të thella historike, kulturore dhe ekonomike. Si popull që ka në ADN-në e tij mëshirimin e traditës, historisë dhe vlerave evropiane, shqiptarët e konsiderojnë integrimin evropian të vendit një nga interesat më madhor në hierarkinë e interesave strategjikë.

Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian është prioritet strategjik kombëtar për Partinë Demokratike. Vlerat tradicionale të Evropës, rilindja evropiane, janë udhërrëfyset e filozofisë tonë politike dhe si të tilla ne do mundohemi t’i adaptojmë e t’i konservojmë në çdo stad të procesit të integrimit, duke mos tjetërsuar asnjëherë shqiptarizmin dhe tradicionalizmin. Sovraniteti i çdo shteti në familjen e madhe Evropiane zhvillohet dhe mbrohet nëse bëhemi bashkë dhe veprojmë së bashku. Marrëdhëniet tona dypalëshe me vendet e Bashkimit Evropian, Mbretërinë e Bashkuar, dhe vendet e tjera evropiane do të jenë të një rëndësie të veçantë për Partinë Demokratike.

Ngadalësimi i reformave dhe korrupsioni i tejskajshëm, krimi i organizuar dhe mos pasja e një qasje realiste në lidhje me Bashkimin Evropian kanë sjellë zvogëlim të fuqisë sonë negociuese për anëtarësimin në BE. Asnjë nismë rajonale apo dypalëshe nuk mund të zëvendësojë integrimin evropian, por ne jemi të bindur se Shqipëria do të vijojë me ndihmën tonë të paçmuar përpjekjet për tu anëtarësuar sa më parë në BE, si dhe do të jetë një histori suksesi në të ardhmen në përmbushje të reformave për anëtarësim.

Propozimet konkrete të Partisë Demokratike:

Për një forcë të qendrës së djathtë konservatore, qëllimi kryesor në marrëdhëniet me jashtë është **të forcojë sovranitetin e Shqipërisë, të konsolidojë pozicionin e saj strategjik në rajon, dhe të sigurojë anëtarësimin e plotë në Bashkimin Evropian brenda mandatit të parë qeverisës**. Ky program duhet të bazohet në diplomaci të fuqishme, partneritete strategjike dhe reforma të thella të brendshme që përshpejtojnë procesin e integrimit evropian.

1. Integrimi Evropian si prioritet kryesor



Futja e Shqipërisë në BE brenda mandatit të parë: Ky do të jetë prioriteti kryesor. Për këtë qëllim, qeveria e ardhshme do të përqendrohet në përmbushjen e kritereve të BE-së për reformën gjyqësore, luftën kundër korrupsionit dhe shtetin e së drejtës. Do të ndërmerren hapa konkretë për t'i dhënë fund kapjes së institucioneve dhe për të përmirësuar funksionalitetin e tyre.

Angazhimi i vazhdueshëm me Komisionin Evropian dhe shtetet anëtare për të siguruar mbështetje të plotë politike dhe teknike. Delegacione të nivelit të lartë do të udhëheqin bisedime diplomatike të pandërprera për të forcuar vullnetin politik të partnerëve evropianë.

2. Partneritet strategjik me SHBA

Rikthimi i angazhimit të fortë me SHBA-në: SHBA mbetet aleati kryesor i Shqipërisë për sigurinë dhe mbrojtjen. Në një botë gjithnjë e më të globalizuar dhe me sfida të reja gjeopolitike, ky partneritet strategjik duhet të mbështetet në disa pika kyçe që pasqyrojnë interesat e përbashkëta të Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara, si dhe vlerat e përbashkëta që i ndajnë të dyja kombet:

- Siguria dhe Mbrojtja Kolektive

Në një kohë kur kërcënimet globale po shfaqen gjithnjë e më të sofistikuar dhe të larmishme, nga luftërat hibride, sulmet kibernetike, deri te përshkallëzimi i tensioneve ndërkombëtare me aktorë si Rusia dhe Kina, bashkëpunimi në fushën e sigurisë është thelbësor. Shqipëria, si anëtare e NATO-s, ka një interes të drejtpërdrejtë për të forcuar marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara në mbrojtjen e sigurisë kolektive, si dhe për të kontribuar në ruajtjen e stabilitetit rajonal. Partneriteti me SHBA-të është i nevojshëm për të përballuar kërcënimet kibernetike që kanë kapur dimensione globale dhe për të siguruar një mbrojtje më të avancuar ndaj sulmeve të jashtme dhe të brendshme. Në këtë kuadër, bashkëpunimi i ngushtë në fushën e sigurisë kibernetike, përgatitja e forcave të armatosura dhe zhvillimi i infrastrukturës mbrojtëse do të jenë prioritet i Partisë Demokratike.

- Zhvillimi Ekonomik dhe Liria e Tregut

Një nga vlerat kyçe që lidh Partinë Demokratike me Shtetet e Bashkuara është besimi i thellë në fuqinë e tregut të lirë dhe të konkurrencës, si motorë të zhvillimit ekonomik. Shqipëria, pas shkatërrimit ekonomik nga politikat e majta dhe monopoliste kryer vitet e fundit, ka nevojë për një partneritet të fortë për të krijuar mundësi të reja investimi dhe për të forcuar sektorët kyç si energjia, infrastruktura dhe teknologjia. SHBA-të mund të ofrojnë mbështetje për zhvillimin e një ekonomie më të larmishme, me fokus te energjitë e rinovueshme dhe teknologjitë moderne. Bashkëpunimi i ngushtë me kompanitë amerikane dhe investimet strategjike do të përmirësojnë konkurrueshmërinë e Shqipërisë dhe do të kontribuojnë në krijimin e vendeve të reja të punës, duke ofruar mundësi për rritje të qëndrueshme ekonomike.

- Integrimi në Strukturat Ndërkombëtare dhe Forcimi i Diplomacisë

Angazhimi i Shteteve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe Mbretërisë së Bashkuar për forcimin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit ka qenë një faktor i rëndësishëm në mbështetje të integritetit të Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë. Këto partneritete strategjike kanë qenë thelbësore për avancimin e Shqipërisë në proceset e integritetit në Bashkimin Evropian, një objektiv i pandashëm për Partinë Demokratike. Ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë dhe të marrim mbështetje të vazhdueshme për reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe përmirësimin e sundimit të ligjit, aspekte kyçe për të arritur standardet europiane. Ne jemi të vendosur të punojmë për forcimin e diplomacisë shqiptare dhe



angazhimin më të madh në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke krijuar mundësi të reja për Shqipërinë në arenën globale.

- Mbrojtja e Vlerave Demokratike dhe Liria Individuale

Partia Demokratike, si një forcë që ka lindur si kundërpeshë ndaj diktaturës dhe ka përqafuar idealet e lirisë dhe të drejtave të njeriut, është plotësisht në harmoni me SHBA-të dhe Bashkimin Europian në mbrojtjen e këtyre vlerave themelore. Shqipëria, në bashkëpunim me aleatët tanë do të duhet të forcojë institucionet demokratike dhe të mbrojtë liritë dhe të drejtat e individit. Ky është një angazhim për të siguruar një shoqëri të fortë dhe të lirë, ku qytetarët kanë mundësinë të shprehin veten dhe të zhvillojnë potencialin e tyre në një mjedis të sigurt dhe demokratik. Për Partinë Demokratike, ky partneritet është një mundësi për të thelluar reformat e brendshme që promovojnë një shtet ligjor të fortë dhe një sistem të drejtësisë të pavarur.

- Lufta Kundër Terrorizmit dhe Diktaturave

Në një botë të ndarë nga polarizime të thella politike dhe kërcënime që vijnë nga regjime autoritare dhe ekstremiste, partneriteti me aleatët është i domosdoshëm për të luftuar terrorizmin ndërkombëtar dhe për të promovuar vlerat e demokracisë përballë diktaturave. Shqipëria, si një pjesë e NATO-s dhe një vend pro-perëndimor, ka një rol të rëndësishëm në mbështetje të politikave ndërkombëtare që synojnë përballimin e kërcënimeve globale të sigurisë. Ne do të arrijmë detyrimin për shpenzime të mbrojtjes në 2% të Produktit të Brendshëm Bruto, dhe do të japim kontributin tonë brenda NATO në luftën kundër terrorizmit dhe radikalizmit dhe për të garantuar një paqe të qëndrueshme në rajon.

- Sfidat e Energjisë dhe Mjedisit: Sfidat e Reja të Kohës

Partia Demokratike është forca e cila realizoi ndërtimin e gazsjellësit TransAdriatik (TAP), duke ndihmuar në uljen e varësisë së kontinentit Europian ndaj gazit rus. Rritja e kërkesës për energji dhe mbrojtja e mjedisit janë dy sfida që prekin jo vetëm Shqipërinë, por gjithë globin. Shqipëria, si një vend me burime të pasura hidrike dhe potencial të madh për energji të rinovueshme, ka mundësi të shfrytëzojë këto burime për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm energjetik. Gjithashtu, pozita jonë gjeografike na jep mundësinë të luajmë një rol kyç në rritjen e sigurisë dhe energjisë për kontinentin Europian.

Gjithashtu, përpjekjet për mbrojtjen e mjedisit, përfshirë ruajtjen e burimeve natyrore dhe zhvillimin e politikave përkatëse për luftimin e ndotjes dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ujit, kërkojnë një angazhim të përbashkët me SHBA-të. Ky partneritet mund të ofrojë mundësi për implementimin e standardeve të larta mjedisore dhe për zhvillimin e iniciativave që promovojnë ekonominë e qëndrueshme dhe të gjelbra.

Si përfundim, Shqipëria do të koordinojë reagimet dhe qëndrimet e saj me Shtetet e Bashkuara përballë krizave dhe konflikteve ndërkombëtare, duke kontribuar në ofrimin e zgjidhjeve diplomatike dhe të drejta për të gjithë palët. Kjo përfshin:

- Përkushtimin për zgjidhjen paqësore të konflikteve, duke mbështetur fuqizimin e institucioneve ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), dhe përballimin e kërcënimeve të reja si ai i destabilizimit të rajonit.
- Mbështetje për forcimin e mekanizmave të drejtësisë ndërkombëtare për të ndëshkuar shkelësit e të drejtave të njeriut dhe për të mbrojtur vlerat e lirisë dhe drejtësisë për çdo individ.



- Votimin dhe mbështetjen e qëndrimeve të përbashkëta për çështje të sigurisë, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe ekuilibrit gjeopolitik.

3. Zgjerimi i bashkëpunimit rajonal

Nxitja e bashkëpunimit me vendet e Ballkanit Perëndimor: Shqipëria do të luajë një rol udhëheqës në nismat rajonale si Procesi i Berlinit, duke siguruar që bashkëpunimi ekonomik dhe politik të përparojë interesat kombëtare. Me politikat tona, ne do të rivendosim marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë bazuar në interesat e përbashkëta, dhe me interesin shqiptar si primarin, duke rikthyer faktorin shqiptar me rol kryesor në rajon.

Bashkëpunimi rajonal do të ketë si yllin e vetë polar forcimin e pozitave të shqiptarëve në rajon, duke koordinuar me qeverinë e Kosovës dhe forca të tjera politike shqiptare në rajon. Rritja e tregtisë me Kosovën, duke hequr barrën doganore, dhe duke garantuar lehtësira fiskale do të jetë prioriteti ynë që vitin e parë të qeverisjes.

Politika e fqinjësisë së mirë: Do të intensifikojmë marrëdhëniet me vendet fqinje duke promovuar paqe, stabilitet dhe integritet ekonomik. Do të mbështesim të drejtat e shqiptarëve në këto vende dhe do të luftojmë çdo lloj diskriminimi ndaj tyre. **Parimi i reciprocitetit do të jetë themelor në marrëdhëniet me qeveritë e vendeve fqinje.**

4. Diplomacia ekonomike dhe tregtare

Nxitja e investimeve të huaja: Për të pozicionuar Shqipërinë si lider të investimeve të huaja në Ballkan, do të zhvillojmë një strategji të fokusuar dhe konkrete, që përfshin një sërë masash për të tërhequr dhe mbajtur investitorë të huaj, duke konkurruar drejtpërdrejt me vendet e tjera të rajonit, si Serbia.

Për të pozicionuar Shqipërinë si lider të investimeve të huaja në Ballkan, qeveria do të angazhohet në krijimin e një mjedisi të favorshëm dhe të qëndrueshëm për investitorët ndërkombëtarë, duke implementuar masa konkrete që synojnë tërheqjen e investimeve në sektorë strategjikë si energjia e rinovueshme, teknologjia e informacionit, infrastruktura dhe bujqësia. Shqipëria do të zhvillojë **zona ekonomike të lira dhe parqe industriale**, të cilat ofrojnë kushte të veçanta për investitorët, duke përfshirë taksa të ulura dhe procedura administrative më të thjeshta. Kjo do të krijojë mundësi për zhvillimin e industrive të reja dhe për fuqizimin e sektorëve që kanë potencial të madh për rritje, veçanërisht në industri të pasur me burime natyrore si energjia dhe bujqësia.

Pjesë e këtij angazhimi është edhe **përmirësimi i infrastrukturës**, duke investuar në porte, hekurudha dhe rrugë që lidhin Shqipërinë me tregjet e tjera të rajonit dhe të BE-së, për të lehtësuar qarkullimin e mallrave dhe investimeve. Shqipëria do të përdorë gjithashtu marrëdhëniet e saj me Bashkimin Europian dhe Shtetet e Bashkuara për të **forcuar diplomacinë ekonomike**, duke nënshkruar marrëveshje bilaterale dhe multilaterale që lehtësojnë qasjen e investitorëve në tregun shqiptar. Në këtë kuadër, do të krijohet një strategji e qëndrueshme për **përmirësimin e imazhit të Shqipërisë** si një destinacion i besueshëm për investime, përmes reformave ligjore dhe përmirësimit të transparencës dhe besueshmërisë së administratës publike, si dhe luftës pa kompromis ndaj krimit të organizuar dhe kartele ndërkombëtare të drogës të cilat e kanë kthyer Shqipërinë në bazë të tyre.

Po ashtu, do të bëhen përpjekje për të **rivalizuar me vendet e tjera të rajonit**, duke ofruar kushte më konkurruese dhe mbështetje të fortë për investitorët që kërkojnë mundësi të reja biznesi. Për të rritur më tej aftësinë për të tërhequr investime të mëdha dhe për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë,



Shqipëria do të krijojë **platforma investimesh** që lehtësojnë qasjen për investitorët e huaj dhe për ata shqiptarë që jetojnë në diasporë, duke krijuar mundësi për projekte madhore në sektorë si **energji e rinovueshme** dhe **infrastrukturë e gjelbër**. Ky angazhim do të sjellë një rritje të dukshme të investimeve të huaja dhe do të pozicionojë Shqipërinë si një lider të qëndrueshëm të investimeve në Ballkan, duke krijuar një mjedis konkurrues dhe të favorshëm për zhvillimin e ekonomisë dhe për krijimin e mundësive të reja pune.

Zgjerimi i tregjeve shqiptare: Diplomacia shqiptare do të ketë për synim nënshkrimin e marrëveshjeve të reja tregtare me vende jashtë BE-së, përfshirë Britaninë e Madhe, SHBA-në, Japoninë dhe vendet e Gjirit, duke siguruar që eksportet shqiptare, për produktet tona të cilat do të jenë të certifikuar, të kenë qasje më të gjerë në tregjet globale.

5. Riorganizimi dhe modernizimi i diplomacisë shqiptare

Riorganizimi i shërbimit diplomatik: Rritja e profesionalizmit të diplomatëve shqiptarë është jetike për një politikë të suksesshme të jashtme. Qeveria do të reformojë Ministrinë e Jashtme, duke përfshirë më shumë ekspertë në fusha të rëndësishme dhe duke eliminuar emërimet politike.

Diplomacia digjitale: Shqipëria do të përqafojë diplomacinë digjitale për të promovuar imazhin e saj dhe për të ndikuar në çështjet ndërkombëtare përmes përdorimit të teknologjive moderne të komunikimit.

6. Politika e emigracionit dhe diaspora

Angazhimi i plotë me diasporën shqiptare: Diaspora jonë është një pasuri e madhe kombëtare, dhe qeveria do të rrisë komunikimin dhe mbështetjen për ta përfshirë atë më shumë në vendimmarrjen kombëtare. Do të krijohen platforma për të inkurajuar investimet e tyre në Shqipëri, **nëpërmjet Diaspora Bonds, apo mekanizma të ngjashme**.

Diplomacia ekonomike për mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve: Ambasadat shqiptare do të përqendrohen në mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve shqiptarë, veçanërisht në vendet e BE-së dhe SHBA, duke siguruar mbështetje të plotë ligjore dhe politike për ta.

7. Lufta kundër ndikimeve të huaja nga fuqi kundërshtare me Perëndimin

Zbutja e ndikimit rus dhe kinez: Përballimi i ndikimeve të Rusisë dhe Kinës: Shqipëria do të rrisë vigjilencën dhe mbikëqyrjen ndaj ndikimeve të mundshme dhe të padëshiruara nga Rusia dhe Kina, duke ndërmarrë hapa të qartë dhe konkretë për të siguruar sovranitetin dhe sigurinë e vendit. Kjo do të realizohet përmes:

- Përforcimit të ligjit dhe rregullave mbi investimet strategjike

Shqipëria do të zbatojë një politikë të qartë dhe të rreptë për kontrollin e investimeve që vijnë nga këto shtete në sektorët kyç, si energjia, teknologjia dhe infrastruktura kritike. Kjo përfshin krijimin e një sistemi të monitorimit dhe kontrollit të detajuar për çdo investim strategjik, si dhe rivlerësimin e marrjes së lejeve për projekte që mund të kenë implikime të sigurisë kombëtare.

- Mbikëqyrjes ndaj kompanive me kapital të huaj

Krijimi i mekanizmave të forta rregullatorë për mbikëqyrjen e kompanive që kanë lidhje me shtetet si Rusia dhe Kina, për të siguruar që ato të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregullat shqiptare dhe europiane,



dhe të mos përdoren për qëllime të pasinqerta politike apo ekonomike që mund të dëmtojnë interesat kombëtare.

- **Fuqizimit të bashkëpunimit me aleatët ndërkombëtarë**

Shqipëria do të intensifikojë bashkëpunimin me aleatët ndërkombëtarë, përfshirë në NATO dhe Bashkimin European, për të zhvilluar strategji të përbashkëta të mbrojtjes nga kërcënimet e mundshme të ndikimeve të huaja. Kjo përfshin angazhimin në shkëmbimin e informacionit të inteligjencës, mbështetje në politikat e sigurisë dhe përmirësimin e kapaciteteve mbrojtëse të Shqipërisë.

- **Diversifikimit të partnerëve ekonomikë dhe burimeve të investimeve**

Shqipëria do të përpiqet të diversifikojë burimet e investimeve dhe të zhvillojë marrëdhënie me vende dhe organizata që ndajnë vlera të përbashkëta demokratike dhe që respektojnë parimet e pavarësisë dhe sovranitetit të shtetit shqiptar. Kjo do të nxisë rritjen e mundësive për investime të qëndrueshme dhe të pastra nga partnerë të besueshëm.

- **Krijimit të një politike të mbrojtjes kombëtare të koordinuar**

Nëpërmjet përmirësimit të politikave të sigurisë dhe të mbrojtjes kombëtare, Shqipëria do të angazhohet për zhvillimin e kapaciteteve të saj mbrojtëse për të përballuar kërcënime të jashtme. Kjo do të përfshijë forcimin e ushtrisë dhe sistemit të sigurisë kombëtare, si dhe angazhimin në strategjitë e mbrojtjes të Bashkimit European dhe NATO-s.

- **Rritjes së transparencës dhe kontrollit publik**

Për të siguruar që çdo ndikim i mundshëm i huaj të ndodhi në përputhje me interesat kombëtare dhe vlerat demokratike, Shqipëria do të rrisë transparencën dhe do të forcojë mekanizmat e kontrollit publik mbi proceset e vendimmarrjes për investimet dhe marrëveshjet strategjike. Kjo do të përfshijë ndjekjen e çdo kontrate dhe marrëveshje të lidhur me shtete si Rusia dhe Kina për të parandaluar korrupsionin dhe abuzimin me pushtetin.

Partneritete të reja me vendet e Ballkanit dhe Mesdheut: Shqipëria do të synojë forcimin e partneriteteve të reja me vendet e Ballkanit dhe Mesdheut, duke krijuar mundësi bashkëpunimi në sektorë kyç si transporti, energjia e rinovueshme, dhe teknologjitë dixhitale. Kjo do të përfshijë krijimin e lidhjeve më të ngushta përmes një infrastrukture të integruar, që mundëson shkëmbime më efikase tregtare dhe rritjen e investimeve rajonale. Shqipëria do të angazhohet gjithashtu në zhvillimin e projekteve të përbashkëta që nxisin përdorimin e burimeve të energjisë të pastër dhe mbrojtjen e mjedisit, duke kontribuar në forcimin e pozicionit të rajonit në ekonominë globale dhe siguruar një zhvillim të qëndrueshëm për të gjitha vendet e përfshira.

Ne jemi të vetëdijshëm se aktualisht në rajon ka shumë ndikime të huaja nga forca destabilizuese dhe për këtë ne angazhohemi që Shqipëria të intensifikojë përpjekjet diplomatike për të krijuar një **platformë të përbashkët diplomatike rajonale**, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe të bashkërenduar mes shteteve të Ballkanit përballë çdo tentative të këtyre forcave për të destabilizuar rajonin.

Për të sfiduar këto forca destabilizuese, Shqipëria duhet të përqendrohet në forcimin e **bashkëpunimit me partnerët evropianë dhe perëndimorë për të ndërtuar barriera politike, ekonomike dhe të sigurisë** që minimizojnë ndikimin e fuqive të treta në rajon. Një hap i drejtpërdrejtë dhe konkret do të ishte **krijimi i**



një nisme të përbashkët evropiane për mbikëqyrjen dhe kontrollin e investimeve strategjike nga forcat e huaja destabilizuese duke e bërë më të vështirë për këto shtete të bëjnë investime që mund të kërcënojnë sigurinë ekonomike dhe politike të rajonit. Kjo nismë mund të përfshijë krijimin e një **agjencie të përbashkët monitorimi dhe vlerësimi të investimeve strategjike**, e cila do të mbikëqyrte çdo investim në sektorë të rëndësishëm, si infrastruktura, energjia dhe burimet natyrore, për të siguruar që ato të jenë të drejtuara nga interesa të përbashkëta dhe të ndihmojnë zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit, pa i dhënë mundësi këtyre influencave të krijojnë pushtet dhe të minojnë pavarësinë e shteteve të Ballkanit e Evropës Juglindore.

8. Përshpejtimi i Reformave për Sigurinë Kombëtare dhe BE

Shqipëria do të përkushtohet për të rritur kapacitetet e saj në këtë fushë, duke krijuar një infrastrukturë të fortë mbrojtëse kundër kërcënimeve kibernetike. Ky hap është thelbësor për mbrojtjen e të dhënave të ndjeshme, përfshirë ato të qytetarëve dhe institucioneve, dhe për garantimin e sigurisë në sektorët strategjikë, si ai i energjisë, financave dhe administratës publike.

Do të angazhohemi **në krijimin e një agjencie kombëtare të sigurisë kibernetike**, që do të bashkëpunojë ngushtë me agjencitë ndërkombëtare dhe do të implementojë protokolle të standardizuara të sigurisë për t'u përputhur me kërkesat e BE-së dhe NATO-s.

Në të njëjtën linjë, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit do të mbetet një prioritet i patjetërsueshëm. Pjesë e procesit të integrimit në Bashkimin Europian është përmbushja e kushteve të tij për forcimin e sundimit të ligjit dhe përmirësimin e sistemit të drejtësisë penale. Shqipëria do të angazhohet në një reformë të thellë të drejtësisë, e cila përfshin luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në çdo nivel të shtetit. Do të implementojmë një strategji kombëtare të integruar për luftën kundër krimit të organizuar, e cila do të përfshijë masa konkrete për të rritur bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër grupeve kriminale, duke krijuar një bazë të fuqishme për hetime ndërkufitare dhe operacione të përbashkëta me agjenci të tjera të sigurisë, si Europol dhe Interpol.

Një Horizont i Ri – Të Ndërtojmë Kontratën me Shqiptarët

Tani është koha për të vendosur drejtimin e Shqipërisë për dekadat e ardhshme. Ne mund të zgjedhim të vazhdojmë me politikat e së kaluarës që kanë dështuar, ose mund të zgjedhim një të ardhme të ndritur të ndërtuar mbi një vizion shpresëdhënës, optimist dhe realist, bazuar në vlerat konservatore dhe politikat që janë provuar se funksionojnë kudo dhe kurdo e që vlejnë për të gjithë Shqiptarët.